

Viti XVII. nr. 3




ISSN 0353/7110

ALTERNATIVA

Revistë për kulturë dhe shkencë



LUBLANA, 2007.



10 L3V, +40388

Alternativa - Revistë kulturore

ISSN 0323-7710

Akademik dr. Tom Berisha

Këshilli

botues

Akademik dr. Aleksander Stipčević

dr. Shaban Sinani

ALTERNATIVA

Revistë e SH.K.SH. "Migjeni"

për kulturë dhe shkencë

LUBLANË 2007

Viti XVII. Nr. 3



ISSN 0353-7110

Këshilli

Akademik dr. Tom Berisha

botues

Akademik dr. Aleksander Stipčević

dr. Shaban Sinani

dr. Skender H. Skenderi

Arben Xhaferi

Mr. Afrim Krasniqi

dr. Fadil Maloku

dr. Martin Berishaj

dr. Irena Šumi

dr. Hannah Starman

dr. Milazim Krasniqi

Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës: dr. Martin Berishaj

Adresa: SHKSH "Migjeni" Celovška 177, 1000 Ljubljana,

Email: kdamigjeni@volja.net

Dizajni i kopertinës: Albert Shaqiri

Redaksia:

Tahir MALIQAJ, Kryetar i SHKSH "MIGJENI"

Xhavit Shaqiri, Sekretar i SHKSH "MIGJENI"

Mr. Alma Bejtullahu,

Mr. Zef Ahmetaj

Mr. Albert Ramaj

Valentin Batalaku

Këtë botim e ndihmojë Ministria për kulturë e R. së Sllovenisë

Alternativa izhaja s finančno pomočjo Ministrstva za kulturo RS

E shtypur në 5.000 kopje ;

tiskano v 5.000 izvodih

PËRMBAJTJA

S'ka pavarësi të njëanshme, ekziston vetëm pavarësia.....	3
Shteti nacional në kapërcyell sociologjik.....	5
ballafaqimet dhe problemet në definimin e fushës sociologjike të shtetit nacional	5
shtetësia.....	9
formimi historik dhe llojet e shtetit nacional	12
shtetet nacionale të papërsosura.....	16
shteti (post)modern dhe etnosi	19
e ardhmja e shtetit nacional.....	20
Bota virtuale dhe mediumet globale	23
Fuqia-krijesë e hapave te vogla.....	23
Mbrojtja nga dezinformimet dhe sulmet informatike.....	30
Kriza në familje kosovare.....	36
Kështu thoshte Fishta	43
Rrëfanë e muzikologjisë shqiptare - Lorenc Antoni	64
gjurmimet etnomuzikologjike	67
ndikimi i folklorit në krijimtarinë e Antonit.....	71
komponimet e Lorenc Antonit	72
rëndësia e Lorenc Antonit në kulturën kosovare.....	78
At Zef Pllumi në prag të pavdeksisë	84
kurrjë më shumë se liria	87
Jup Kastratit - post mortum	94
kush është Jup Kastrati?	95
Identitet Arbanasa	102
prinos Arbanasa novoj domovini.....	119
Vetëshprehje poetike.....	125
Një vepër e panjohur për shpirtin shqiptar	131



Nuk mund ta trasosh ardhmërinë, pa e njohur të shkuarën..... 131
Ligjet e perandorisë nuk kanë kurrfarë vlere në Shqipëri134
Rruga për në Kosovë135
shqiptari s'e duron shkeljen e fjalës 138
kisha katolike dhe lëvizja kombëtare shqiptare..... 141
Shqipëria dhe Shqiptarët (Albania si Albanezii) 145



S'KA PAVARËSI TË NJËANSHME, EKZISTON VETËM PAVARËSIA

Na thanë se do të na e pavarsojn Kosovën!, një herë, dy herë, tri herë, shumë herë; E shpallën Kosovën, një herë, dy herë tri herë shumë herë! E ende nuk na »rehatuan«.

Thjesht, klasa politike kosovare gjendet para një sfide të re; ti ofrohet votuesit kosovarë, shtetasit të sajë edhe një herë se do të pavarësojnë Kosovën. Nga ana tjetër ata, devalvuan çdo gjë që munden të devalvojnë brenda kohës dhe hapësirës. Çdo gjë që kjo klasë politike nuk duhej të nëpërkëmbtë, e nëpërkëmben! E tani na frikësojnë se nuk guxojnë të shpallin pavarësinë e Kosovë njëanshëm!

Të shohim se kush e ka shpallur deri me tani në histori të mendimit politik dhe të shtetbërjes, pavarësinë DYANSHËM?

Pra, pavarësia shpallet dhe ajo mundë të shikohet si akt i njëanshëm vetëm nga kundërshtari i sajë. Kur po shpartallohej Jugosllavia, Sllovenisë i thanë; mos e shpallni pavarësinë se jemi për mos ndarje të Jugosllavisë! Sllovenet e shpallën atë dhe pas pak ajo u bë subjekt i të drejtës ndërkombëtare. Të njëjtën gjë i thanë, Kroacisë, Bosnjës, Maqedonisë dhe përfundimisht edhe Malit të Zi; por, ata duke u nisur nga bindja, nga e drejta e pakontestuar për vetëvendosje që i takon çdo kombi e bënë atë.

Po ne (kosovarëve), çka na thonë?

A na thonë mos e shpallni se... ! dhe ... kjo klasë politike e cila fatkeqësisht deri me tani nuk ka reagua si shtetformuese, po zvarritë këtë akt historik dhe po vonohet në rrjedha ashtu siç » e kemi ne zakon« . Edhe një herë shtetasit kosovarë po i shitet »dushk për

gogla«. Edhe një herë po ai shtetas/qytetarë i dëgjon pafundshmërinë e premtimeve boshe të cilat "do të duhej ta bindeshin atë" që tu japin votën atyre! Po, shtetasi kosovarë është ai i cili e din se çka donë, ai, pikësëpari dëshiron që përfundimisht në Kosovë të jetoj ashtu siç meriton. Ai dëshiron dhe është i bindur se e vetmja gjë që nuk është bastarduar, dhe degjenerua është vullneti kolektiv i kombit shqiptarë për të bërë shtet.

Prandaj, nuk ka pavarësi të njëanshme, por ekziston vetëm pavarësia, dhe si të tillë duhet shpallur e pastaj ashtu siç kanë bërë krejt shtetet që janë bërë shtete, duhet të kërkojnë pranimin, jo me gojë, siç po donë kjo klasë politike të na "mësojnë" por, ajo duhet titullua **me shkrim nga Parlamenti i Kosovës**, se, në fund të fundit procedura e pranimit të një shtetit, shteti tjetër duhet proceduar në parlament ku miratohet pranimi i atij shteti të ri, dhe atë vendim të miratuar në parlament, ia komunikon poashtu me shkrim parlamentit të atij shteti, (dhashë Zoti, të Kosovës). Kjo është rruga e drejtë për ta bërë Kosovën subjekt të drejtës ndërkombëtare.

Tahir Maliqaj

Kryetar i SHKSH "Migjeni"

SHTETI NACIONAL NË KAPËRCYELL SOCIOLOGJIK

Dr. Martin Berishaj

Vërshime debatesh dhe studimesh së ekspertëve më të mëdhenj në lemën e sociologjisë, por edhe të politologjisë, janë rreshtuar në dhjetëvjetëshin e fundit lidhur me fenomenin e shtetit nacional. Ky studim merret me definimin e shtetit nacional, me problemet që ndërlidhen me (jo) kompletshmërinë, traditat e shtetësisë dhe me dukurinë e drejtpeshimit aktiv të marrëdhënies në mes shtetit (post) modern dhe etnosit. Pavarësisht nga roli i tij tepër i rëndësishëm në shoqëri dhe jashtë sajë dhe përpos kësaj në rolin paraprakisht të siguruar në të ardhmen, shteti nacional do të duhet të përshtatet autonomizimit të entiteteve etnike/identiteteve në rajonin politik, në njërën anë, dhe në afirmimin e vlerave transnacionale si pasojë e globalizimit të ekonomisë, kulturës, ekologjisë, të drejtave njerëzore, në anën tjetër.

ballafaqimet dhe problemet në definimin e fushës sociologjike të shtetit nacional

Me çfarë bindje është e mundur që, me gjuhën e sociologjisë, të flitet dhe të mendohet për shtet nacional? Giddens (1985; 116) në studimin e tij i cili në përgjithësi merret me shtetin nacional, konstaton se sociologët dhe historianët në thelb nuk dinë të bëjnë dallim në mes nocioneve shtet nacional, popull, gjegjësisht komb dhe nacionalizëm

(Strassoldo:1991:171). Ndoshta më parë do të ishte mirë të parashtrohet pyetja, se, a merren sociologët në kontekstin e tashëm të situatës aktuale, në mënyrë të mjaftueshme dhe bindshëm me dukuritë shoqërore dhe fenomenet etnike në shoqëritë globale? Pyetje të ngjashme të cilat ndjellin pesimizëm do të mundeshim të parashtrojmë pafund. Mirëpo, assesi nuk mundë të anashkalojmë ligshatin (lexo rënien në peshë) të teorive sociologjike e pse jo dhe në përgjithësi shkencave shoqërore sa i përket kësaj çështje. Nga ana tjetër, është po ashtu një e vërtetë e madhe se sociologjia pas Luftës së Dytë Botërore, për dy dekada rresht, qëllimisht ka shmangur ato studime, kurse ne dy dekadat e fundit ka përparua në atë lami si në aspektin sasior po ashtu dhe atë cilësor.

Lidhur me studimet historike të fenomenit të shtetit nacional padyshim dalin në pah veprat e Hans Kohen (1944, 1967), Alfred Cobban (1945), Carlton Hayes (1931), B. C. Shafer (1955), Seton-Watson (1977), Eugen Lemberg (1964) dhe të tjerëve. Kurse sa u përket studimeve sociologjike dhe politologjike do të veçonim E. Kedourie (1966), K. R. Minogue (1967), Reinhard Bendix (1969), A. D. Smith (1971), Ernest Gellner (1983), Van den Berghej (1981), A. Giddens (1985) etj. Shumë nga këta autorë kanë luajtur rol të rëndësishëm në aftësimin e shkencave shoqërore për shpjegim substancial dhe sistematik të problemeve të ndryshme nacionale në shkenca shoqërore. Deri diku në mënyrë të drejtpërdrejtë me meritë të disa prej këtyre autorëve është arritur të zbulohen në traditën teorike shtesat analitike dhe

* "Nacionalizmi është shije e ushqimit të cilin e kemi ngrënë në fëmëni". Nëse me fjalën nacionalizëm kuptojmë "ndjenjën e përkatësisë" kurse me fjalë "shije ushqimi" eksperiencën tonë jetësore; rrjedhojë e kuptimit të kësaj thënie është se pjesa e njerëzimit dhe e botës në të cilën çdonjëri nga ne e ka në ndërdije të vet, implikon faktin se "këtë ndjenjë" e kemi përjetuar në vitet më të rëndësishme të jetës tonë.

konceptuale të cilat i kanë dhënë sociologjisë në dorë instrumente të reja për eksplikim profesional dhe ambicioz të dukurive, strukturave dhe proceseve që janë të lidhura me komb dhe dukuri të gjëra etnike. Këtu gjithsesi kemi në mend kontributin e sociologut francez Marcel Mauss (fatkeqësisht jo tepër të afirmuar dhe të njohur) si dhe dijetarin klasik të teorisë sociologjike Max Weber.

Marcel Mauss dhe Max Weber gjatë Luftës së Parë Botërore dhe pas shkatërrimit të tre perandorive të mëdha shumëkombëshe (Otomane, Habsburge dhe asaj Ruse) iu qasën problemit të identitetit nacional dhe shtetësisë nacionale nga aspekti dinamik, qëndrimi sociologjik voluntar (Tirvakian dhe Rogovvski, 1985: 60-67). Tiparet dhe shenjat sociologjike të shtetformësisë së kombit sipas Maussit evidentohen si bashkësi të integruara fizike dhe morale, pushtet stabël dhe i përhershëm qendror, pranim i kufirit, popullsi relativisht morale e homogjenizuar kulturologjikisht dhe shpirtërisht e cila e pranon shtetin dhe ligjet e tij. Për kombet është karakteristike shkalla dalluese e integritit. Në makronivel kontribuojnë kombet në shkallë të madhe të individualizimit civilizues kurse në mikronivel bënë homogjenizimin e banorëve të tij. Nëse këtë e përkthejmë në gjuhë sociologjike kjo do të thotë se integrimi në mes kombit dhe shtetasve të tij behet me ndërmjetësime më të ndryshme në mes tyre. Përpos këtij integrimi sociologjik ndodh edhe ai gjeopolitik i cili mënjanon dallimet e mëparshme në mes qyteteve, pjesëve të privileguara dhe jo të privileguara, si dhe atyre që është e trashëguar nga bota e hershme (feudale). “Kombi i kompletuar” bashkëkohor është shoqëri e vetkënaqëshme e integruar me pushtet qendror demokratik, me karakter nacional dhe me sistem të përbashkët normativ. Në botë këso lloj “Kombe të kompletuara” janë me shumë rastësi sesa rregull.

Mauss nuk është posaçërisht konçiz në dallimin e kombit dhe shtetit nacional. Në fakt ai flet më shumë për "komb të kompletuar" i cili siguron përparësitë ekonomike, juridike, morale, politike dhe kulturo-civilizuese. Weber nga aspekti analitik ishte shumë i kujdesshëm lidhur me autonominë e kompleksit kulturor. Kombi, pra, nuk nënkupton përkatësi ndaj shtetit, si vet përkatësia kundrejt bashkësisë gjuhësore vetvetiu nuk konstituon kombin politik. Në formësimin e shtetësisë nacionale strukturat sociale nuk marrin pjesë në mënyrë të njëtrajtshme, ndërkohë që duket se solidariteti etnik është mjaft homogjen. Weber dukshëm vlerëson faktin sociologjik duke konstatuar se, në mes nacionalistëve më radikalë janë personat që kanë burim të huaj etnik. Kombet në rend të parë përfaqësojnë bashkësi politike të njerëzve me gjuhë të përbashkët, religjion, doke dhe kujtesë politike.

Bashdizimi modern i këtyre shenjave etnike me pushtet politik është ai fakt që i jep shtetit nacional kualifikim historik të legjitimitetit. Në definicionin e shkurtër Weber e përcaktoi shtetin nacional si organizatë sekulare të pushtetit, e cila është në disponim të kombit. Në këtë traditë teorike, sikurse është e ditur Talcott Parsons me respektimin e komponenteve simbolikë, gjegjësisht kulturorë, zhvilloi teorinë e aksionit (Glazer in Movnihan; 1975, 53-83).

Në krahasim me shtetin i cili e përcjell njeriun diku rreth 7000 vite, kombi është produkt i zhvillimit më të ri historik. Tipologjitë sociologjike të shteteve nacionale (Tirvakian dhe Rogowski; 1985, 27-57) mbështetën para së gjithash në konstatimin e marrëdhënieve të pushtetit dhe marrëdhënieve në mes elementëve përbërës të shtetit nacional, edhe pse gjithherë duhet të llogaritet edhe në përcaktues të tjerë. Definicionet e Mauus dhe Weber mbi shtetin nacional kanë para sysh vetëm modelin "e vërtetë" të tij, të ashtuquajtur modeli

evroperëndimor, model i cili është imituar në shumë vende të botës duke dhënë rezultate pozitive. Van den Berghe (1981, 63-67) nuk është aspak frytdhënës në përcaktimin e formimit të shtetit nacional, të cilin e kupton si produkt i pushtimit të pushtetit qendrorë pavarësisht nga ajo, se zgjedhja demokratike apo vullneti i lirë ndikuan në formimin e tij. Autori i njëjtë parashtron pyetje, se pse studiuesit e ndryshëm merren me fenomenin e shtetit nacional, si me dimension vendimtarë të politikës në renesancë?

Me këtë këndvështrim ata kanë rrudhë dukshëm optikën sociologjike pasi e dimë se gati të gjitha shtetet në Evropë në dymijëvjeçarën e fundit janë formacione sekondare të cilat kanë lindur nga shtetet që funksiononin më parë. Shtetet janë paraqitur para popujve dhe pa ndihmën e tyre. Por, gjithashtu edhe popujt janë paraqitur jashtë shteteve, në shumicën e rasteve kundër vullnetit të tyre. Gjithsesi, ato ishin shtete të popujve apo etnive tjera (të huaja). Gjithë kjo rezulton me nevojë që, mendimi sociologjik elaboron identitetin si të shtetit ashtu edhe të popullit, para se u bë "martesa" e tyre. Në këtë skicë, vend të posaçëm zënë Franca, ku popullin e formon shteti. Pasuria e proceseve historike na bënë të akceptojmë këshillin e Gellnerit (1983, 7) dhe të përqendrohemi në definicionet rigorozë të cilat nuk mund të anashkalojnë sfidën e përgjithësimit të një gjendje antropologjike në llogari të njërit apo pranë tjetrit. Definicionet janë në përdorim për aq kohë përderisa jemi koshientë për kufizimet e tyre, në të kundërtën ato shkaktojnë më dëm sesa dobi.

shtetësia

Krahas problemit të definimit të shtetit nacional, si element relevant sociologjik paraqitet çështja e shtetësisë, ku po ashtu nuk mund të

shmangim mendimin idealtipik. Normat që përcaktojnë anëtarësimin e plotë politik dhe kulturor (shtetësinë) në shtetin nacional janë pak a shumë norma të trashëguara nga periudha klasike e shteteve evropiane nacionale. Brubaker (1988, 1) mendon se statusi i shtetësisë duhet të sigurojë këto gjashtë kushte apo norma, që janë: *anëtarësimi i plotë në shtetin nacional* (nuk mundë të jenë një e treta, dy të tretat etj.) ashtu siç e gëzojnë të gjithë anëtarët (shtetasit) e shtetit nacional; *hyjnizimi anëtarësor*, që nënkupton se anëtarët janë të gatshëm të mbrojnë shtetin e vet nacional edhe me jetë të tyre; *përkatësia politike* që ka si rrjedhojë dhe atë kulturore, pra përkatësin nacionale; *anëtarësimi bazohet në parimin demokratik*, në bashkëpjesëmarrjen në udhëheqje të shtetit dhe mundësitë për ata që jetojnë përkohësisht të bëhen të barasvlershëm me tjerët; *qenia vetëm anëtar i një shtetit*; *krahas obligimeve "hyjnore" shtetasve u takojnë po ashtu të drejtat e arritura*.

Disa nga këto norma janë shumë të vjetra dhe kanë përjetuar modifikime, varësisht nga marrëdhëniet shoqërore globale, gjegjësisht nga ndryshimet e mëdha me të cilat shtetet nacionale u ballafaquan në fund të shekullit XX.. Kështu sintagma "të flijohesh për atdhe", akceptohet në forma të ndryshme në shtete të ndryshme të botës. Kjo sintagmë assesi nuk e ka atë domethënie që e kishte para një gjysmë shekulli në pjesë të ndryshme të shteteve evropiane. Sociologjia, për fat të keq, me përjashtim të disa rasteve specifike (Dahrendorf, 1974), këtij problemi nuk i kushton ndonjë kujdes të veçantë. Mbrojtja fundamentaliste e shtetit nacional është anakronizëm, që në shumicën e rasteve i reziston rrjedhës së fortë të desakralizimit të shtetësisë në shumëzim të statuseve sociologjike të cilat anëtarësimin e plotë e ndërrojnë me përkatësinë parciale apo politike ndaj shtetit duke mos marrë me vete përkatësinë automatike të ndonjë kulture të

caktuar. Mbështetësit e multikulturalizmit u japin krahas formave të reja politike të përkatësisë që i shërbejnë mirë formimit të shoqërisë post nacionale.

Në rrafshin ndërkombëtar kemi gjatë kohë të bëjmë me tradita të ndryshme të shtetësisë nacionale (Brubaker, 1988, 6-7) dhe krahas saj me politika të hapura të shtetësisë. Tradita franceze i nënshtrohet kriterit unitarist dhe universal që e mbarësojnë shtetësinë politike. Kriteri i lartë është uniteti politik i cili së pari depërton në jetën e asimilimit kulturor (ku kanë rol kyç aparatet e shkollës dhe ushtrisë. Tradita gjermane nuk është mbështetur në popullin politik apo në mendësi abstrakte të shtetësisë, por në **Volksgemeinschaft** partikulare dhe organike. Elementi kryesor konstitutiv i shtetësisë në traditën gjermane është etnokultura dhe jo përkatësia politike. Të dy traditat, çka është e kuptueshme, kanë pasoja praktike të ndryshme në dhënien e shtetësisë. Përderisa pjesa më e madhe e imigracionit francez lehtësisht ka fitua shtetësinë, në ish Gjermaninë Perëndimore ka shumë pak shembuj të tillë. Vetëm në kohën e fundit në Gjermani është shfaqur "interesi publik" që brezi i dytë i emigrantëve të fitojë shtetësinë gjermane, pra për një politikë liberale dhe më pak restriktive në këtë lëmë. Kështu, në Francë, në anën tjetër edhe përkundër se është kundër "parimeve dhe traditës republikane" kanë filluar të fusin në jetë politikë restriktive në dhënien e shtetësisë. Përderisa modeli francez dhe ai gjerman i shtetësisë edhe përkundër dallimeve akordohet në kuptimin unitarë të shtetësisë nacionale, në modelin amerikan dhe zviceran ka më tepër hapësirë për heterogjeni. Shtetin nacional zviceran e përbëjnë blloqet vetërritëse etnike, gjuhësore dhe religjioze, të cilëve federata u ka mundësuar shkallën më të lartë të autonomisë kantonale dhe komunale. Ndarja e shtetësisë është privilegj për 3072 komuna (**Gemeindes**), kurse

rregullimi i lejes që qëndrimin në Zvicër pushteti federal ka hap dyert gjithë imigrantëve në vitet e gjashtëdhjeta. Shumica e të ardhurve kanë fituar me shtetësi dhe të drejtën të punojnë dhe të jetojnë në Zvicër edhe përkundër rrezikut të debalansit etnik në mes kantoneve dhe komunave, marrëdhënie e cila është ruajtur në Zvicër me xhelozë me shekuj. Në vitin 1980 tetë kantone kanë mbështetur propozimin që një e treta e krejt të huajve të lëshojnë Zvicrën, mirëpo, këto përbëjnë shumicën (26 kantone, gjegjësisht, 22 dhe katër gjysmë kantone). Nëse është e mundur në Zvicër të merret shtetësia në mënyrë me ndërmjetësim filluar nga njësia konstitutive e federatës, SHBA në këtë drejtim paraqesin asociacion vullnetarë i individëve. Për shkak të nevojës së madhe për imigrant, përpara ndarja e të drejtave qytetare ishte si rregull, dhe jo përjashtim[†].

formimi historik dhe llojet e shtetit nacional

Problemi sociologjik i shtetësisë implikon dallimin në mes kombit kulturor (**Kulturnation**) dhe atij politik (**Staatsnation**), për të cilat në gjuhë angleze dhe franceze nuk mundë të gjendet termin i barasvlershëm. Në literaturë të specializuar këto u futën në jetë duke u falënderuar historianit gjerman Friedrich Meineck (Alter; 1985, 19-23). Koncepti kombit politik buron nga ideja e vetëvendosjes kolektive dhe individuale, nga vullneti lirë i individit se i përket kombit. Shtetësia në

[†] Kriter për dhënie nuk ishte dimensionin unit/kulturor por, formula universale politike sipas vendit të lindjes (**jus soli**). Është interesant të ceket se indianet e Amerikës kanë fitua të drejtat për shtetësi me aktin e lindjes tek ne vitin 1924. Në vitin 1965 u ndërpreu kufizimet për ardhje të disa bashkësive nacionale apo racore.

atë kontekst lidhet me nacionalitet. Koncepti i kombit kulturor në shikim të parë është më objektive – mbështetet në shenja të qenies reale, siç janë gjuha e përbashkët, territori, religjioni, gjuha, doket, historia etj. Vetëdija për një mendësi të tillë dhe ndjenja e përkatësisë së përbashkët kanë ekzistuar dhe ekzistojnë pavarësisht nga shteti, shembull konkret është Gjermania dhe Italia para bashkimit apo shembulli i shpërndarjes territoriale të Polonisë në vitin 1772 dhe 1918. Për këtë shkak është e kuptueshme se ideologët e lëvizjeve për bashkim nacional në shekullin e kaluar kanë shikuar kombin si diçka që është para shtetit e që i bashkon historia e përbashkët dhe kultura. Koncepti i kombit politik historikisht u realizua në Evropën perëndimore kurse koncepti i kombit kulturorë është karakteristik për Evropën qendrore, Itali dhe me disa përjashtime për atë lindore. Shpesh këto dy këto koncepte janë përdorur varësisht nga interesat dhe llogaritë politike. Gjermanet i kanë përvetësuar në këtë mënyrë Alzasjanet, për shkak se kultura, gjuha, historia dhe ngjashmëria e gjuhës i rreshtojnë ata në kombin kulturorë gjerman, po ashtu i kanë përvetësuar edhe francezet sepse, Alzaciajnet pas revolucionit të 1789 janë deklaruar si shtetas francez. Shembulli në vijim është edhe më tepër jo parimorë; Para viti 1918 Gjermanet mazureve nga Prusia lindore të cilët kanë folur polonisht, me thirrje në parimin subjektiv apo politik u kanë marrë të drejtat qytetare. E kur është bërë fjalë për alzacian kanë përdorur kriterin tjetër objektiv, pra parimin kulturorë. Gjithsesi duhet të pohojmë se nacionalizmi si ideologji dhe lëvizje politike ka ditë që për atë arritur qëllimin e vet, - shtetin nacional, historikisht ta instrumentalizojnë në njërin anë identitetin kurse në anën tjetër vetë shtetin. Pas revolucionit francez të vitit 1789 i cili shtetin nacional e ka shpallur për zbulim epokal dhe paradigmë universale, nuk ishte më rrugë mbrapa apo rrugë tjetër alternative për

këtë lloj legjitimiteti politik. Napoloni i III ishte politiku i parë evropian i cili u rreshtua në anën e shtetit nacional. Kurse në mes ekonomisteve ishte Friedrich List ai që shtetit nacional i dedikoj përparësi të mëdha ekonomike, kurse në mes filozofëve ishte Hegeli ai i cili i paralajmëroj popujt të cilët nuk mundën të kanë shtetin e vet nacional, nuk do të mundën askurrë të hyjnë në histori. Historiani Leopold von Ranke në kombe ka zbuluar "tendencën, për tu bërë shtet", jurist liberal zviceran Johann Caspar Bluntschli e kishte çdo popull të thirrur të formojnë shtetin e vet. Masaryku formuesi i shtetit çekoslovak, në monarkinë habsburge ka vërejtur para së gjithash mohimin e shtetit bashkëkohor dhe idesë lirishtetëse në përgjithësi.

Shtetet nacionale janë formuar në tre harqe kohore të dhe në tre hapësira gjeografike ndryshme (Alter, 1985, 101-106). I pari u paraqit si lloj i shtetit nacional të Evropës perëndimore si produkt i historisë politike dhe pak a shumë të kapërcimit revolucionarë të gjendjes të cilin e kanë lënë pushtetmbajtësit absolut. Shteti i regjimit të vjetër është shndërruar në organ të shtetit e cila është mbështetur në qytetaret e politikisht të vetëdijesuar dhe në kombin politik. Bëhet fjalë për shtetet nacional si vijon: Anglinë, Holandën, Francën dhe Suedinë.

Lloji i dytë i shteteve nacionale mbështetet në kombin kulturorë i cili ka mbijetuar në hapësirë të Evropës qendrore dhe asaj jugore. Italia dhe Gjermania (Reich) e shekullit 19. paraqesin shembull tipik të numrit të madh të shteteve të vogla të cilat patën sukses që këto subjekte, disa nga to me një traditë të madhe relativisht të pavarur, ti fusin në ombrellë të shtetit nacional. Rolin e bërthamës lidhëse e morën përsipër dy shtete dinamike; Piemonti në Itali dhe Prusia në Gjermani. Si rrjedhojë e këtyre integritimeve, disa shtete në Itali janë shpartalluar apo u është ndërprerë pushteti i tyre qendrorë. Kurse në

Gjermani është bërë fjalë për zvogëlimin thelbësorë të sovranitetit të tyre, të cilët e kishin deri në fazën e integritit në një shtet të përbashkët. Kështu në rastin e Piemontit, poashtu edhe në Gjermani u imponua si shtet i "parë" në shtet "shtëpia pruse" me »Kaisertumom« e vet dhe e shpalli Prusinë si kryeqytet të Gjermanisë . Siç e dimë, përpjekja e Serbisë për të përsëritur një rol hegjemonie të tillë mbi popujt e Jugosllavisë nuk pati sukses.

Lloji i tretë i shtetit nacional i cili bazohet në kombin kulturorë, është paraqitur poashtu në shek. 19. dhe në fillim të shekullit 20. në Evropën qendrore, lindore dhe juglindore. Aty, popujt u shkëputën nga perandoritë shumënacionale; nga ajo otomane, habsburge dhe ruse. Këtu bëhet fjalë për popuj të cilët vetëdijesimin e tyre politik nuk kanë mundur të artikulojnë me formimin e shtetit të vet, por janë thirrur në specifikën e individualitetit gjuhësorë dhe bashkësinë etnike. Harku i shkëputjeve politike ka mbërrijë në cep veriorë evropianë nga Finlanda, duke vazhduar në shtetet baltike deri te Polonia dhe Çekosllovakia dhe në jug të Evropës nga Shqipëria, Rumunia dhe Greqia. Në vitin 1814 Norvegjia është shkëputur nga Suedia, në vitin 1831 Belgjika ka dalë nga Holanda e bashkuar, pjesa jugore e Irlandës është ndarë nga Britania kurse Islanda është pavarësuar nga Danimarka në vitin 1944.

Poashtu në këtë periudhë u bënë edhe bashkim: Polonia, e cila paraprakisht ishte e ndarë në tre shtete në vitin 1918n serish u bashkua. Në shkëputje, që nuk ka rezultuar gjithherë me shtet nacional të pavarur, tregon shembulli i Mbretërisë Serbo Kroate Sllovene, që janë bashkuar në një shtet të përbashkët pas Luftës së I. Botërore. Nga këndvështrimi i sotëm shihet qartë se, pas luftës së II. Botërore bëhej me shumë për fazë kalimtare sesa për vendim historik përfundimtarë. Shembulli i fundit ka devijuar nga trendi i përgjithshëm i formimit të shteteve nacionale në këtë shekull. Ishte si

rrjedhojë e modelit integruar të shekullit të kaluar apo shekujve të kaluar në Evropën perëndimore, e që në truallin tonë ka e vonuar shansin e vet historik. Kufiri paraqet problem të posaçëm për shtet nacional. Rrallë ndonjë nga shtetet nacionale në Evropë kanë të njëjtit kufij me ata që i kishin në kohë kur u formua, si shembull marrim; Belgjikën e vitit 1831 dhe Çekosllovakinë e vitit 1918. Italisë u deshën 60 vite të vijë në kufijtë që i ka sot.

Kjo pasqyre historike e ngërthyer shpjegon qartë se nacionalizmi është dukuri shoqërore e përshtatshme. Nacionalizmi gjegjësisht produkti i tij themelorë, shteti nacional nuk është kompatibel me një lloj të vetëm të shoqërisë apo shtetit. Në dy dekadat e fundit kemi pas rast të njihemi me modele të ndryshme të monarkisë, republikës dhe diktaturës së shtetit nacional, të cilat janë vendosur në strukturat e ndryshme sociale në rreth, filluar nga ai demokratik e deri të ai autoritar politik. Bazamentin simbolik i cili është i njëjtë për të gjithë, e ka shkruar prototipi i shtetit nacional francez me simboli të obligueshme nacionale: flamur, himn dhe forma të festimit të shtetit nacional

shtetet nacionale të papërsosura

Nëse serish kthehemi në fakte historike, mundë të konstatojmë se edhe në këtë shekull bëhet mohimi i qëndrimeve, se ka përfunduar "tregimi" mbi formimin e shteteve nacional në Evropë. Këtë lloj konstatimi do të mund të argumentojë formimi i numrit të madh të shteteve pas mbarimit të luftës së I. Botërore, nga Finlanda në veri e deri të Jugosllavia në jug të Evropës. Edhe në mes dy luftërave botërore ishte plotësisht e qartë se kemi të bëjmë me formimin e numrit të

madh të shteteve nacionale "me gabim", aty mundë të numërojmë Poloninë Çekoslllovakinë, dhe Jugosllavinë. Po ashtu edhe shtetet tjera nuk kanë mundë të lavdërohem me strukturë homogjene etnike. E edhe më pak me garantim të drejtave të pakicave etnike të cilat kanë jetuar brenda kornizave të tyre. Edhe shteti nacional polak nuk ishte homogjen. Kur "përfundimisht" i rregulluan kufijtë në vitin 1918-20, Poloni mbetën rreth 14% ukrainas, 3% bjellorus, 10% hebrenj, diku rreth 2 % gjerman dhe përafërsisht 3% nacionalitete tjera. Nga të gjitha këto shkaqe nuk funksionojë ideja e kombit politik duke i lënë hapësirën e vet njëlinguizmit dhe njëkulturalizmit ekskluziv.

Asnjë nga shtetet e porsaformuara në Evropën qendrore dhe atë lindore, nuk u ofrojë në truallin e vetë pakicave etnike autonomi kulturore apo nuk u dha elemente minimale federative. Atëherë në psikologjinë politike të strukturave udhëheqëse, ato pakica u ankoruan në formë stereotipash të "kolonës së pestë". Me ato lloj paragjykimesh establishmenti i atëhershëm politik arsyetonte asimilimin dhe presionin mbi pakica kombëtare.

Edhe pse në dukje të parë paraqitet paradigma e shtetit nacional si universale, ajo, në histori dhe në kohë të tashme është më parë përjashtim sesa rregull. Në vitin 1971 (nga ajo kohë të dhënat nuk janë ndryshuar dukshëm) Walker Connor ka gjetur në 132 shtete të ndryshme të botës ka gjetur 12 sosh të cilat kanë mundë të lavdërohen me përbërje etnike homogjene të popullsisë, çka dmth. 9% e numrit të përgjithshëm (Smith; 1981, 9-10). Rregull standarde sipas kësaj nuk është shteti nacional për pluralizmi etnik, i cili si i tillë nuk është lëkundë, e të cilin e kanë rreshtuar dhe në kartën e vendvendosjes së popujve si dhe në dokumente relevante ndërkombëtare. Edhe shtetet me "pedigre" të madhe demokratike parandalojnë me të gjitha "mjetet e lejuara" që dikton shteti juridik, pakicave kombëtare të

drejtën për autonomi më të madhe, me arsye se ajo "dridh themelet" e integritetit shtetërorë. Shembulli i Britanisë së Madhe, SHBA-ve, Spanjës e po ashtu dhe Francës tregojnë qartë se është rrezikuar blloku etnik dominant rreth të cilit në periudhë të caktuar historike u formua shteti nacional. Paradigma e kombit politik siç u zhvillua në shtete të caktuara në Evropën perëndimore nuk arriti përfundimisht të asimilojë të gjitha segmentet linguistike, kulturore dhe karakteristikat e veçanta të bashkësive të caktuara etnike. Ernest Renan në mënyrë të shkëlqyer kuptoj kompleksitetin dhe rrënjsimin e fenomenit komb, mirëpo e relativizoj në rast kur kohëzgjatjen e tyre e lidhi me kusht që të vërtetohet si përditshmëri e plebishitit. Koncepti politik i kombit e ka atë dobësi se mbështetet në faktor subjektiv me anë të cilit shikohet në popuj me prizmin e utilitarizmit dhe oportunitizmit.

Ideja e shtetit nacional mbështetet në fikcion. Ignaz Seipel, në vitin 1916 kur u bë kancelar i parë i republikës austriake, shtroj një tezë interesante; se shteti nacional është tepër i mirë deri sa ai nuk është i formuar, vazhdimësia e tij detyrimisht përfundohet në këtë apo atë formë të imperializmit etnik gjegjësisht në mohimin e të drejtës së popujve tjerë apo pakicave kombëtare. Përpos imperializmit manifestativ duhet të tërheqim vërejtjen për të ashq. "kolonializmin e brendshëm" në integrimin e dhunshëm të shpërndarjes së pluralizmit etnik. Ekzistenca e mëtutjeshme e shteteve nacionale në Evropë pavarësisht nga ajo se në të gjitha anë ato "shqepen", tregon faktin se kanë mbetur shumë kërkesa për shtetin nacional në retorikën pakashum nacionaliste. Mirëpo, nisur nga ky argument, nuk mundemi të konstatojmë se nacionalizmi në histori ka ditë gjithherë të legjitimohet si alet i shtresave të reja dhe ndryshimeve të obligueshme të tyre shoqërore. Shkotëve dhe Wallesit deri sot nuk kanë pas sukses të formojnë shtetin e tyre nacional, në këtë drejtim më të suksesshëm

ishin Irlandezet. Edhe përkundër përpjekjeve shekullore kjo çështje nuk u pati sukses as Katalonëve dhe Baskeve në Spanjë dhe Korzikanëve dhe Bretonve në Francë. Sot është vështirë të parashikohet se çfarë lloj zgjidhjesh do tu ofrojnë “dëshirave të paplotësuara” të nacionalizmave, të cilat u reduktojnë në zgjedhje “rajonalizim” duke u dobësuar forcën e tyre.

shteti (post)modern dhe etnosi

Me shtet nacional nuk mund të shterim rolin e shtetit postmodern si dukuri etnike. Në kohë të fundit ai ka marrë rol të caktuar të “rojtarit” të interesave jetik të grupeve marginale dhe në atë mënyrë ka socializuar disa nga funksionet kryesore të sajë. Marrëdhënia e re në mes shtetit dhe etnosit hap rrugë mirëpo, ende mund të skicohen gjeneraljet sociologjike. Shteti politik zbuloj se është e mundshme të bëhet relativisht pak për kategori aq abstrakte dhe shpesh vetëm kategori ideologjike siç janë; klasa shoqërore, klasa e mesme, mirëpo, diçka më tepër mund të “behet” për një bashkësi etnike apo për ndonjë tjetër. Elita politike sot, dinë politikisht të mobilizojnë segmente pluralë etnike dhe në atë mënyrë të forcojnë legjitimitetin e vet. Poashtu bashkësitë etnike në anën tjetër, janë vetëdijesuar se, për arritjen e kërkesave të tyre të përbashkëta, organizim dhe udhëheqje të mirë. Fenomeni etnik paraqet mundësi të cilën kanë ditë disa nga partitë politike të “instrumentalizojnë shumë mirë. Këtu mund të cekim dy raste; tërhiqja e frankofonisë etnike në partinë liberale kanadeze dhe ripërtëritja e partisë amerikane demokratike më mbështetje të bashkësive etnike.

e ardhmja e shtetit nacional

A ka dalë sot nga përdorimi ideja e shtetit nacional? A është anakronizëm i cili nuk garanton formë legjitime të organizimit politik? Në këtë pyetje përgjigjen me PO ata të cilët i kushtojnë vëmendje të madhe bashkëpunimit ndërshtetërore dhe ndërrajonal, kyçje dhe nënshtrim të shteteve në integritet. Mbas kthimit nga Amerika ku ishte në egzil historiani gjerman Hans Rotfels deri në vitin 1953 ishte i bindur se ishin dy luftërat botërore argument i bollshëm për krizë të idesë së shteteve nacionale, dhe se ideja mbi ta është "e tejkaluar, reaksionare dhe asesi nuk mundë të jenë qëllimi ynë". Në segmente të caktuara shteti nacional është në fakt anakronizëm i cili gradualisht shuhet, pra, në hegjemoninë e tij të plotë mbi individin, e cila ishte e kuptueshme në një periudhë të caktuar historike. Robert Dahl në studimin e tij mbi demokraci (1923, 4-16) në mes faktorëve të cilët hapin "absolutizmin" e shtetit nacional thekson në një anë kërkuesën për forma të drejtpërdrejta të demokracisë dhe në anën tjetër shkaqet që diktojnë sigurinë, zhvillimin, mbrojtjen mbinacionale të drejtave të njeriut dhe problemin planetarë ekologjik.

Paradigma e re politike e cila askurrku gati nuk zëvendëson shtetin nacional, do të duhej të ketë prirje ndaj koekzistencës dhe kohabitimit në mes popujve dhe pakicave kombëtare në Evropë. Proceset e konfederalizmit të Evropës me rritje të njëkohshme të autonomizmit së rajoneve dhe pakicave kombëtare do të ishin apo do të duheshin të paraqesin hapin e duhur në mënjanimin e drejtimit "të egër" klasik të pozicionit që kishin shtetet nacionale ndaj pakicave kombëtare në to. Edhe përkundër krejt kësaj që u tha në "korrozionin" e shtetit nacional i cili luan rol të posaçëm në jetën politike dhe atë shoqërore. Për individ

ajo paraqet kornizë referuese të zhvillimit shoqëroro-ekonomik i cili siguron qetësi dhe siguri sociale. Karl Deutsch në studimin e tij të famshëm **Nationalism and Social Communication** (1966) thotë se shteti nacional individit i mundëson dhe i ofron siguri psikologjike dhe fushë të gjerë të lirisë, të cilën familja dhe bashkësia lokale nuk mundë të sigurojnë. Alternativa me të cilën ballafaqohet bota e në veçanti Evropa nuk është – ose shteti nacional ose integrimet mbinacionale. Shteti nacional do të duhet gjithsesi të përshtatet proceseve të reja mbinacionale dhe të çoj dorë nga sovraniteti absolut mbi qytetarë të tij. Para këtyre kushteve nuk duhet të frikësohet, se nuk do të ruaj rëndësinë e vetë substanciale politike dhe në shekullin në vijim.

Referencat

- Alter P. 1985. *Nationalismus*. Frankfurt: Suhrkamp.
- Andreson B. 1983. *Imagined Communities*. London: Verso.
- Bell D. 1975. "Ethnicity and Social Change", v Glazer N. in Movnihan D. P. 1975. *Ethnicity, Theory and Experience*. Cambridge: Harvard U. P.
- Bendix R. 1969. *Nation-Building and Citizenship*. New York: Anchor Books.
- Breuilly J. 1982. *Nationalism and the State*. Manchesten Manchester Un?v. Press.
- Brubaker R. 1988. "Traditions of Nationhood and Politics of Citizenship". *States and Social structures Newsletter*.
- Citron S. 1987. *Le Mythe National*. Paris: Les Editions ouvrieres.
- Cobban A. 1969. *The Nation State and National Self-Determination*. Glasgow: Collins.

- Berishaj, M 2003. "Nga hapësira e trojeve në hapësirë të rrjedhave"
Ljubljana, Center za albanske studije ALBANICA
- Dahl R. in Tuft E. 1973. *Size and Democracy*. Stanford: Stanford Univ. Press.
- Dahrendorf R. 1974. "Citizenship and Beyond: The Social Dynamics of an Idea". *Social Research* 41: 672-701.
- Fougeyrollas P. 1987. *La Nation*. Paris: Fayard.
- Gellner E. 1983. *Nations and Nationalism*. Oxford: Basil Blackwell.
- Giddens A. 1985. *The Nation-State and Violence*. Los Angeles: University of California Press.
- Kedourie E. 1966. *Nationalism*. London: Hutchinson.
- Klinar P. 1989. "Nacionalno vprašanje v dobi (post) moderne". Ljubljana: *Družboslovne razprave* 8, 149-154.
- Kohn H. 1947. *The Idea of Nationalism*. New York: Macmillan; (1967): *Prelude to Nation-State* s. Princeton: Van Nostrand.
- Lefebvre E. 1988. *Le Nationalisme Contre les Nations*. Paris: Meridiens Kincksieck.
- Lipset S. M. 1960. *Political Man: The Social Bases of Politics*. New York: Doubleday.
- Maugue P. 1979. *Contre L'Etat-Nation*. Paris: Editions Denoel.
- Mauss M. 1969. "La Nation". V: "La Nation et Uinternationalisme". *Oeuvres*. Paris: Editions de Minuit, vol. 3: 573-639.
- Mayer T. 1986. *Prinzip Nation*. Opladen: Leske-Budrich.
- Rothschild J. 1981. *Ethnopolitics - A Conceptual Framevork*. New York: Columbia.Univer-sity Press.
- Rizman R. 1989. "Etnie e Stato post-moderno". *La Battana* 93-94:52-57.

BOTA VIRTUALE DHE MEDIUMET GLOBALE

Fuqia-krijesë e hapave te vogla

Akademik dr. Tom BERISHA

Fizikanet kur shpjegojnë "lëvizjet virtuale", "forcat virtuale" punën virtuale", atëherë fillojnë kështu:" Le të përfytyrojmë një numër të madh thërmijash që ndërmjet veti janë të lidhura me lidhëse të ngurta. kështu që lëvizja e një thërmije shkakton lëvizjen e thërmijave tjera"Ne vazhdim të këtij shpjegimi mund të thuhet kështu:me lëvizje të vogël të një thërmije mund të shkaktohet lëvizje të një sistemi pambarimisht të madhe të thërmijave. Ne se një kompjuter personal e marrim si një "thermi", nga eksperiencia e përdorimit të kompjuterëve e dimë që me kompjuterin tone mund të lidhemi me një numër praktikisht pambarimisht të madh të kompjuterëve-"thërmijave", ose thane pak ndryshe, me sistemin planetare të kompjuterëve-"thërmijave". Kjo lidhje, praktikisht realizohet me një here me të filluar të punës në kompjuterin tone, me lëvizje të vogla, me hapa të vogla, nëpërmjet "miut" dhe tastatures, që shkaktojnë aktivizimin e sistemit të lidhjeve kompjuterike dhe vete kompjuterët me të cilët ne dëshirojmë të komunikojmë, duke pasur në dispozicion një numër praktikisht pambarimisht të madhe të kompjuterëve. E dimë që kompjuterët mund të lidhen edhe me sistemet televizive. Sistemet televizive janë të lidhur me satelit. Ky sistem enorm i mjeteve të informimit elektronike ka gjithashtu lidhje të ngushta me mjetet e informimit të shkruara, kështu që këto

komponentë të informimit se bashku formojnë sistemin GLOBAL TE MEDIUMEVE. Lidhshmëria e këtyre mjeteve të informimit dhe koordinimi i veprimeve të tyre të përbashkëta përçon kah GLOBALIZIMI . Si çdo here në zhvillimin e njeriut çdo gjë e re e mire është percjellur me tendenca negative, kështu edhe kësaj here me GLOBALIZIMIN janë të dukshme tendenca të forta të MONOPOLIZIMIT.

Ky SISTEM GLOBAL i informimit që i referohet planetes TOKE është i zgjeruar dhe lidhet me anijet kozmike që fluturojnë në Sistemin Planetare Diellore. Pra qysh tash mund të flasim për SISTEMIN NDERPLANETARE DIELLORE TE MEDIUMEVE. Me aktivizimin e kompjuterëve, televizorëve, po edhe të gazetave të cilat tashti mund të lexojmë edhe në INTERNET. realizohet me një here, me lëvizje të vogla d. m. th. jemi në gjendje që me mjete të deritashme. nuk kanë mundur të paramendohen. Pra me lëvizje të vogël. në bëjmë punë të madhe për një kohë të shkurtër. Me fjale tjera realizojmë fuqi të madhe. Edhe një here mund të themi pak ndryshe: REALIZIMI I FUQISE SE MADHE ME HAPA TE VOGLA ose REALIZIMI I FUQISE VIRTUALE.

Nocionet që tash i ndigjojme, si "sistemi virtual", "shoqëria virtuale", "shteti virtual" "politika virtuale" si dhe shumë shprehje të ngjashme të aplikuara në lëmi të ndryshme, tregojnë një kahe të re të kohës së sotme. Ky nocion, jo vetëm që tregon realizimin e punës së madhe, fuqisë së madhe në pikëpamje fizike, por edhe i aplikuar në lëmit e ndryshme shoqërore, pra edhe në politike. ka kuptimin e aplikimit të hapave të vogla për të arritur rezultate të caktuara, të rëndësishme, vendimtare ose edhe të fuqishme

Për të bërë hapat e vogla (virtuale), p. sh. në politike duhet percjellur hapat virtuale të tjerëve për të cilët jemi të interesuar dhe të definojmë hapat tona për të realizuar interesin tonë duke mposhtur argumentet e kundërshtarit. Metoda e hapave të vogla nënkupton

programimin e tyre për veprim te pa ndërprere ne planin afatshkurta ose afatgjate. P. sh. a ekziston definimi i hapave te vogla dhe te përditshme për te shpëtuar Mitrovicën nga shkëputja e trupit te Kosovës, për te cilën gjë, nga ditët e para te vendosjes se miqve te Serbisë, ne rajonin e Mitrovicës, bashkë me Serbet ne mënyre sistematike, imponuese dhe insistuese, çdo dite behet nga ndonjë hape me qellim te ndarjes se Mitrovicës?

Serbet, me gjithë hallet e tyre gjejnë kohe për te menduar dhe punuar, sistematikisht me hapa te vogla për "djepin e tyre". Gjezdisja e nënkryetarit te Qeverise Serbe, rreth dhe neper Kosovën, duke organizuar Serbet për ndarjen e Kosovës, pa tjetër kërkon përgjigjen sistematike, te pa ndërprere, te përditshme, virtuale.

Kontakti me popullin gjithashtu kërkon angazhim te pa ndërpre, duke e mbajtur ne dijeni te ngjarjeve dhe duke e organizuar dhe mobilizuar ne aktivitete përkatëse qe duhet te hyjnë ne planin e aktiviteteve virtuale për te zhvlerësuar përpjekjet e imperializmit serbe. Kontakt pune dhe jo manifestime te tepruara. Partitë politike ne këtë moment duhet te jene te pranishme ne zgjidhjet e problemeve banesore jetësore dhe te varfërisë qe sot është e pranishme ne Kosove. Ne një mënyre duhet te jene bashkëvepruese aktive me pushtetin ne zgjidhjen e problemeve jetësore. Ky aktivitet është i pranishëm edhe ne kohëra normale, se pak janë probleme jetësore qe mund ti zgjidhin vet shteti, pa pjesëmarrjen aktive te organizatave te ndryshme te vendit.

Studentët kurrizi dhe boshti kryesore i ngjarjeve ne mase, ne rrugën e pavarësisë. duhet te kenë planin e vete te veprimtarisë virtuale. Prania e përditshme ne jetën politike te vendit, nuk duhet te mungoje as një dite. Reagime, komunikata, trajtimi i organizuar, studioz i problemeve. si te vendit asht edhe te jashtme sidomos ata qe kane

lidhje me problemet tona. Kujdesi i posaçëm i ngritjes se dijenisë dhe eksperiencës te stafit politik.

2. Virtualiteti i medimeve dhe globalizimi

"Virtual", "virtualiteti", janë fjale të shumë kuptimta që rrjedhin nga fjala latine "virtus" = guxim, fuqia, virtyti. Në aplikimin aktual, fjala "virtual", përpos atyre që u përmenden mund të ketë edhe këto kuptime: i fortë i afte për veprim por i fshehtë që nuk duket por mund të shfaqet, i mundshëm në të ardhmen, potencial, eventual, imagjinar, dhe kuptime të ngjashme. Rënia e murit të Berlinit dhe e ndarjes bipolare të botës si dhe revolucioni tekniko-teknologjike i medimeve në vitet e fundit, ka mundur ekspandimin e teknologjive të reja informatike dhe të telekomunikacionit në të gjitha kontinente. Pasoje e këtij ekspandimi të hovshëm është ndërrimi i rregullave të komunikimit publik. Përdorimi i shumte i teknikes digjitale, shfaqja e cyberspace-it (lidhja totale nëpërmjet të rrjetës kompjuterike-internetit, pa kufizime largësie gjeografike) mund të shkaktojë shpërdorimin e medimeve për interesa të fitimit, duke vepruar në krijimin e "te vërtetës virtuale", sipas dëshirës, qëllimit, ideologjisë dhe interesit të pronave të medimeve. Senzacionalizmi dhe prezantimi i tepërte i njerëzve negative që nxite kureshtjen e njerëzve në tregun informatike jepen shpesh here profit më të madhe se prezantimi i njerëzve me vepra humane. si p. sh e ndjera Nena TEREZE, ose trashëgueset e saj që në valët elektronike globale gjejnë pake vend.

Kjo gjendje e mjeteve të informimit ka favorizuar krijimin e organizatave globale, kur mediumet e mëdha të shtypit kanë filluar të

blejnë dhe te zhvillojnë stacione televizive. Tendence e forte e bashkimi të ndërmarrjeve nacionale të telekomunikacionit në ndërmarrje të përbashkëta globale ndërnacionale, e që dikur kanë qene konkurrencte, hapen mundësitë e monopolizimit dhe hiperfitimit. Kjo tendence, ky globalizim, është posaçërisht prezent në ndërmarrjet franceze, gjermane dhe të SHBA-es.

Pasaniket e mëdhenj arabe kanë arritur që në Lindjen e mesme të emitojnë me dhjetëra programe në gjuhën arabe, franceze dhe anglishte që janë prone e tyre dhe që sigurojnë fitim të madh. Gjithashtu, vetëm gjuha turke mund të ndijohet që nga rajoni i Adriatikut deri të muri kineze. Nga pikëpamja e informimit këto ndodhje janë të mirëseardhura. Mjerisht, koncentrimi i fuqisë së informimit elektronike, në duar të pakta favorizon jo vetëm monopolizimin material të mjeteve të informimit por edhe monopolizimin e informatave. Në këto kushte të krijuara, mund të krijohet "realiteti" dhe "e vërteta" e ngjarjeve sipas interesit të pronarëve pra, krijohet "e vërteta virtuale".

Fuqizimi i organizatave të mëdha që po i quajmë organizata globale të medimeve zmadhon apetitet e tyre dhe bëhen promotor të idesë së shoqërisë globale informatike, të cilën ata e kuptojnë si shoqëri në të cilën nuk do të ketë shtete nacionale, nuk do të ketë kufij, kështu që një shoqëri e tillë do të jetë maksimalisht e hapur, maksimalisht civile, e cila detyrimisht, me zhvillimin e mëtejshëm të teknologjisë përçon të modeli i ri shoqërore. Në këtë shoqëri të re që, po themi, e dëshirojnë protagonistët e globalizimit informatikë, njerëzit, që në përgjithësi nuk do të kenë kurrfarë ndikimi në përmbajtjen e medimeve, do të kuptojnë mediumet si hapësirë të pa ndare të qenies së tyre dhe gjithnjë me paktë si mjete përdorimi. Nëse, kjo tendence, po themi ashtu, "legalizohet", mediumet, dhe ata që i

kontrollojnë do të jene ne gjendje të krijojnë "te vërtetën virtuale", e cila si po dele nga qëllimet e "shoqërisë informatike globale" do të sundoj mendimin e njeriut dhe do të jete ne gjendje që qysh përpara të programoj të ardhmen të cilën do ta realizojnë njerëzit nën dirigjimin e krijueseve të "vërtetës virtuale(imagjinare)". Kësaj të "vërtetës virtuale" duhet kundërshtuar me të vërtetën e njeriut cili mund të gjendet në rrezik të eliminimit si faktorë krijuese i shoqërisë, po për shkakë të "bombardimit" të gjithanshëm me informata nga të gjitha llojet e mjeteve të informimit. Ky "bombardim" krijon rrezikun që njeriu i mbushur me informata dhe i ngushtuar për shkakë të angazhimit për sigurimin e jetesës së tij dhe të familjes, nuk gjene kohe të bëjë vështirë me të nevojshme të informatave, të bëhet viktime e këtyre sulmeve pa shpirte dhe anti njerëzore. Një nga mënyrat e manipulimit me informata, mund të jete kjo:

Me mjetet e reja të telekomunikacionit, me pajisjet personale satelitore, me mundësitë e cyberspace-it, në gjendje lufte, reporterët ushtarake, mund të jene në një pozite tëjet të ndryshme. Përpara, rezultatet e reporterëve të luftës janë varur nga lidhjet e mira që kanë pas me eporet ushtarak dhe mundësitë që ata u kanë ofruar për të kryer detyrat e reporterit ushtarak. Në kushte të reja ndërrohet pozita e tyre dhe nuk varen më nga eporet ushtarake. Pala që nuk ka mjete moderne të telekomunikacionit bënë kontrakte me mediumet, që janë të pajisur me mjete të sofistifikuara të cilët mund të preferojnë interesin financiarë karshi interesave nacionale dhe civilizuese.

Prandaj, me gjithë tendencat pozitive të globalizimit në përgjithësi. jo vetëm në lëmin e mjeteve të informimit, përpjekja për ruajtjen e individualitetit, pavarësisht shtetërore si në pikëpamje të punëve të brendshme ashtu edhe të jashtme është condotio sine qua non për ekzistimin e njeriut si qenie që mendon dhe krijon.

3. Sundimi eventual i medimeve globale, e kaluarja dhe e ardhmja

Prania e gjithëmbarshme e medimeve mund të shkaktojë një tip të ri të varësisë së njeriut e cila i shlyen kujtimet dhe eksperiencat e deritashme kurse natyrën dhe botën gjithnjë e më tepër i përjeton si një bashkësi (sistem) informatash të koduara. E kaluara, historia, mund të mendohet si rezervar i informatave nga i cili informatat e nxjerrura mund të radhiten dhe interpretohen sipas qëllimeve momentale. Veprim dhe metodë e tillë do të ishte interesant p. sh. në lufte për dezorientimin e armikut, por nëse kjo merret masa të përgjithshme-globale kishte me pas efektin e largës-zbrastjes së trurit dhe zëvendësimin e dijenisë dhe eksperiencës së njeriut me të "vërtetën virtuale" të rrejshme dhe imagjinare.

Sipas protagonistëve të Globalizimit të medimeve, që synojnë për sundimin global, e ardhmja nuk interpretohet si bashkësi e ngjarjeve që do të ndodhin varur nga koha dhe kushtet që ajo kohë i ofron, por si krijese e programit për realizimin e nevojave të realitetit ekzistuese virtuale. Kujtimet tradicionale si p. sh. "gjasë" dhe "domosdoshmëria", zëvendësohen me kujtime të reja si "zgjedhja" dhe "skenari" d. m. th. zgjedhja e "vërtetës virtuale" me qëllime të caktuara që zëvendëson gjasën, dhe realizimi nëpërmjet të skenarit që zëvendëson ligjshmerin, domosdoshmëri e ndodhjes së ngjarjeve. Fjala "ngjarje e mundshme" (aleatoare)", zëvendësohet me ngjarje të sigurt që planifikohet. Fuqizimi i medimeve si nga pikëpamja teknologjike por edhe organizative si dhe financiare, kur këto tendenca negative të përmendura, në kohën e sotme, në realitetin e ekzistimit të shteteve nacionale, të vetëdijes dhe ndjenjës nacionale,

tejkalojnë përvojat historike, ndjeshmëria e shoqërisë njerëzore behet edhe me e ndjeshme kundrejt një manipulimi informatike të mundeshe, të shumëfishte dhe antihumane. Historia ushtarake, betejat e mëdha gjate historisë së luftërave, situata dhe përjetimet politike, kulturore, ekonomike në historinë e kombeve, popujve. do të mbeten ngjarje të pa evitueshme në edukimin e gjeneratave të reja. Trashëgimi i këtyre përvojave nuk guxon të shlyhet. Kjo është një përvojë historike e tërë njerëzimit.

Trashëgimi i përvojave historike, në kushte të reja të sotme të revolucionit tekniko-teknologjike në sferën e telekomunikacionit dhe të informatikës, begatojnë dijeninë e njeriut për zhvillimin e njerëzimit gjithnjë më të humanizuar dhe kundër gjitha tendencave që pretendojnë uzurpimin e arritjeve të njeriut dhe robërimin e tij.

Mbrojtja nga dezinformimet dhe sulmet informatike

Shtetet që disponojnë me prodhime të reja të telekomunikacionit dhe të informatikës e sidomos edhe nëse i prodhojnë, kanë përparësi në aplikimin e tyre për të sulmuar dhe sunduar hapësirën informatike të organizatave të ndryshme shoqërore duke nënkuptuar edhe shtetet. Sulmet mund të drejtohen edhe kundër individëve. Këto sulme, me mjete të reja tekniko-teknologjike, me qëllim sundimi të sistemit informativ të kundërshtarit, p. sh. ushtarak, ose konkurrentit komercial, ose rivalit politike, ndërron mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe vendosjes së ekuilibrit ndërmjet shoqërive dhe shteteve. Për shkak të pa mundësisë të parashikimit të mënyrës së aplikimit si dhe rezultatit të sulmit informatike me mjete të reja, vendosja e sistemit efikase të mbrojtjes nga sulmi informativ është

detyre jo vetëm e shtetit dhe institucioneve të tije, por edhe të gjithë organizatave shoqërore që në çfarëdo mënyre marrin pjesë në marrëdhënie me organizatat e huaja, qofshin ushtarake, ekonomike politike dhe etj. E vërteta është se qëndrim i tillë për mbrojtjen nga sulmi informatike ende nuk ka baze të gjera të atyre që i dalin zotë kësaj kërkesë, ende është i pamjaftueshëm numri i atyre që e kuptojnë rëndësinë e këtij problemi, por aq më tepër është nevoja që faktorët që merren me problemin e sigurimit nacional të merren me të edhe me seriozisht duke formuar kushtet e një mbrojtje të përparuar. Kanosja e sulmeve informatike, për shoqëri, janë të ngjashme rreziqeve të kriminalitetit të llojeve të ndryshme. Era informatike janë me vete llojet e reja të rreziqeve që kërkojnë konceptonin e reja dhe largpamjen në zhvillimin e të gjitha sferave të veprimit shoqërore dhe mbrojtjen e tyre. Shoqëritë që në këto sfida nuk do të jenë në gjendje të japin përgjigje, do të rrezikojnë progresin civilizues dhe të mirëqenies së anëtarëve të shoqërisë. Lidhur me këtë, analistët prijës në këtë problem janë të një mendimi që teknologjitë informatike gjithnjë e më tepër kanë ndikim me të madhe në realizimin e mirëqenies kombëtare në të gjitha sferat e veprimit shoqërore. Këtë e vërteton ngritja e shpejta ekonomike, në dhjetëvjetorin e fundit, si dhe në të gjitha lëmi tjera, të shteteve që janë me të zhvilluara në pikëpamje të informatikës. Mbrojtja nga sulmet informative është parakusht për përhapjen e aplikimit të teknologjisë informatike në lëmi të ndryshme të veprimit të njeriut. Zhvillimi i strategjisë efektive kombëtare kundër vënies së sulmeve informatike është një nga detyrat më të rëndësishme të sistemit të Sigurisë kombëtare dhe shtetërore. Ky sistem nënkupton edhe formimin e sistemit të ruajtjes së informatikës dhe informatave vitale si dhe mbledhjen e informatave.

Rëndësia e luftës kundër sulmit informativ ka te njëjtën karakter sikurse lufta kundër rreziqeve te ndryshme shoqërore si p. sh. lufta kundër kriminalitetit, drogës, sëmundjeve ngjitëse dhe etj. Për shkak te efektit qe krijojnë. lufta kundër këtyre rreziqeve, praktikisht, behet ne mënyre dhe metoda te ngjashme. Sëpari, është e nevojshme angazhimi i një numri te madh te institucioneve shtetërore, organizata joshtetore dhe individë, çka ka për pasoje angazhim te madh te mjeteve financiare. Me gjithë se, sipas eksperiencës se deritashme, pasojat e sulmeve informatike nuk janë aq te mëdha si ato te rreziqeve shoqërore qe u përmenden si kriminaliteti, droga, sëmundjet ngjitëse, etj. , shumëzimi i mjeteve informatike si dhe ngritja e përditshme e informatizimit te çdo veprimi te njeriut detyrimisht përçojnë kah krijimi i sistemeve te sulmeve informatike me veprime afatgjate, strategjike dhe te përhershme. Një gjendje e tille mund te konstatohet edhe ne këto ditët e sotme ne vendet informatikisht me te zhvilluara, ku p. sh. një sulm i suksesshëm ne objektet personale ose publike te bazave informatike te dhënave, mund te shkaktonte pasoja te mëdha ne përdorimin dhe aplikimin e tre. Ne shtypin e përditshëm ka pasur informata p. sh. mbi depërtimin e "hacker-ve" ne bazat e rëndësishme te dhënave. Kjo edhe disa ndodhje te ngjashme kane qene loje fëmijësh, por, ato tregojnë kahen e mundësive te mjeteve te reja te komunikimit.

Pasojat e sulmeve informatike mund te jene te shumëfishte: zvogëlimi i efikasitetit politik, ekonomik dhe ushtarak te shtetit. Këto sulme (strategjike) janë te drejtuara kah sistemet për vëzhgimin dhe dirigjimin e mjeteve për rrënime ne mase, për pengimin e sistemeve te komunikacionit etj. Rreziqe me karakter potenciale strategjike godasin objektet e infrastrukturës nacionale si: sigurimin publike, sistemin financiar, energjetik, te komunikacionit, qarkullimin

monetare. Këto objekte të përmendura në një moment mund të kenë edhe karaktere strategjike.

Shembuj konkret të sulmeve të mundshme informatike:

- me sulmet hacker-iste depërtohet në sistemin kompjuterik shpesh herë në formë loje, dhe jo të motivuara me qëllime financiare ose strategjike. Vete fakti që kompjuterët në bote mund të komunikojnë, është e "hapur" dera e depërtimit në brendinë e kompjuterit, në softuerin e tij, në bazën e të dhënave të tij.

Nga ana tjetër shumë procese teknologjike, financiare, administrative, shtetërore, të komunikacionit, të telekomunikacionit, të shëndetësisë, të ekonomisë, të energjetikës, të organizmave dhe të njësive të mbrojtjes dhe praktikisht në shumë shtete të gjitha sferat e veprimit të shoqërisë janë të dirigjuara me sistemet përkatëse të softuerëve që përmbajnë zemrën e kompjuterit. Me gjithë se shumica e këtyre sulmeve deri më sot, si për shembull shkëputja e lidhjeve, vjedhja e të dhënave, ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes, nuk janë për tu nënçmuar sepse mund të shndërrohen në sulme serioze dhe nëse janë të planifikuara mirë mund të rezultojnë me pasoja të mëdha. Mënyra kaotike e sulmeve hacker-iste që nuk mund të parashihen shkakton probleme në parashikimin e rezultateve përfundimtarë jo vetëm për të sulmuarit por edhe për sulmuesit.

P. sh. le që sulmi hacker-ist është drejtuar në një elektrane, d. m. th. në një objekt të infrastrukturës. Megjithatë sulmi është drejtuar vetëm në një elektrane, por mbasi që kjo elektrane është pjesë e sistemit të gjere elektroenergjetike, sulmi shkakton një numër të madh pasojash në elektrana tjera që nuk janë drejtpërdrejtë të sulmuara, pra shkakton dëme që nuk janë prite në fillime kur është vërejtur sulmi.

-sulm shume i rrezikshëm është ai kur drejtohet ne disa objekte infrastrukturale qe mund te planifikohen ne ketë mënyre: sulmet janë aq te forta, vetëm sa për te "shqetësuar" një numër te konsiderueshëm te objekteve infrastrukturale, qe vazhdojnë gjithnjë te funksionojnë por me kapacitet te reduktuar. Pasoje e këtij lloj sulmi është një seri te çrregullimeve qe p. sh. ne sistemin energjetike rezulton me dëme me te mëdha se sa shuma e dëmeve individuale te objekteve. Nuk është vështire te përfytyrohet se çfarë kaosi, rregullimi do te shkaktonte p. sh. depërtimi ne sistemin monetare dhe bankare te një shteti. ose ne 'shpëlarje-te memories se një sistemi informatike te sistemit te sigurisë te shtetit.

efikasitetit politike, ekonomike, ushtarake te shtetit. Këto mundësi te sulmit informatike kërkojnë së pari marrjen e masave preventive te mbrojtjes kundër sulmit informative. Kjo nënkupton njohurin e medimeve ne rrethinën nga e cila mund te ndodh sulmi eventual dhe nga e cila varet sistemi i jone i mbrojtjes. Pa njohur mënyrën e veprimit dhe rrezikun qe na kanoset me sulmin informatikë te kundërshtarit te cilin duhet te jemi ne gjendje ta identifikojmë gjate "përleshjeve" informatike, nuk është e mundur te zhvillohet çdo fare mbrojtje efikase. Pas njohjes se sulmuesit duhet zhvilluar masat alternative te veprimit kundrejt rreziqeve qe mund te na kanosen e sidomos ne raste te veprimit te njëkohshëm te disa sulmeve.

Rreziqet mund te jene: me karaktere strategjike, me karaktere potenciale strategjike dhe te përditshme qe kane pake te bëjnë me ato strategjike.

Rreziqet qe sulmuesi i planifikon me karakter te shqetësimit te përditshëm janë me te numerta dhe me pasoja me te lehta. Rreziqet strategjike, me numër te vogël, por me pasoja qe mund te kenë përmasa katastrofike janë ne vëmendje me rigoroze te sistemit te

mbrojtjes nacionale. Zhvillimi i mjeteve informatike dhe te telekomunikacionit mbanë ne vete shpresën e zhdukjes se luftës se armatosur. Pasi qe interesat e ndryshme te shteteve, ka mundësi te realizohen me sulme informatike pa intervenimin ushtarak dhe pa humbje njerëzish ne te dy palët, lufta klasike e armatosur humbe kuptimin e deritashëm. Me gjithë atë, sidomos shtetet e varfër, si dhe ato qe ne përgjithësi nuk janë ne gjendje te prodhojnë dhe te kenë mjete te sofistikuara te informatikës dhe te telekomunikacionit, popujt te cilët luftojnë për lirinë dhe pavarësinë e vete, ne një lufte te ashtu quajtur "asimetrike" nuk do te hezitojnë te përdorin mjete dhe mënyra luftarake. Popujt e varfër, kane ne dispozicion mjete te lira dhe efikase. Gjithashtu, grupe te ndryshme tororiste qe ekzistojnë dhe qe mund te lindin do te kenë ne dispozicion një numër shume te vogël te mjeteve te telekomunikacionit, dhe mjet kryesor i tyre do te jete arma klasike. Po edhe për shtetet e zhvilluara, kushedi deri ku është kufiri i luftës informatike dhe a vjen dhe kur vjen detyrimisht shndërrimi i luftës informatike ne atë te armatosur.

KRIZA NË FAMILJE KOSOVARE

Valentin BATALAKU

Në familjet kosovare tashmë ka filluar një krizë e hapur, ka ndodhur një çoroditje e jetës sociale, e cila është e panatyrshme dhe abnormale. Dyndja e njerëzve në qytete, varësia nga ndihmat humanitare, braktisja e punës në bujqësi dhe blegtori, ka krijuar një krizë morale të familjeve, ku konflikti i akumuluar brenda përbrenda martesave shpërtheu fill pas lufte dhe si pasojë e gjithë kësaj kemi shkurorëzimet që janë duke u shkallëzuar vit pas viti.

Shoqëria kosovare është shëndruar në shoqëri konsumuese, ku gruaja është bërë simbol dhe protagoniste e këtij mentaliteti konsumues. Janë paraqitur disa dukuri artificiale, trende, si për shembull, problemi i pamjes së vijës së trupit, bukurisë, lirisë seksuale, famës, modelit bashkëkohor të femrës. Shumë gra shpresat e tyre i kanë përqëndruar në pamjen fizike dhe tërheqjen seksuale, duke i vizituar "sallonet e bukurisë" nëpër qendra të qyteteve. Energjia e tyre po përqëndrohet në imitim të "vlerave kulturore" të shteteve perëndimore. Fëmijët po i përjetojnë mosmarrëveshjet ndërmjet prindërve, në të shumtën e rasteve bëhen dëshmitar të grindjeve të prindërve të tyre. Mbretëron një pasiguri dhe ankth familjar. Rezultati: paraqitja e konflikteve martesore-shkurorëzimeve në shoqërinë kosovare!

Lidhur me shkurorëzimet dhe ndarjet në këto rrethana parashtrohen

disa pyetje që duhet përgjigjur: Cilët janë faktorët apo arsyet e ndarjes së çifteve? Kush ngritë padinë për shkurorëzim, gruaja apo burri? Pas ndarjes, kujt i besohen fëmijët për përkujdesje të mëtutjeshme, nënës apo babait? Në favor të kujt bëhet ndarja e pasurisë së çifteve? Në rastet kur fëmijët i besohen nënave, cili është arsyetimi i organeve kompetente nëpër gjykata dhe Qendrat për mbrojtjen sociale? Nëse fëmijët i besohen nënës, a ju realizohet atyre e drejta e alimentacionit? Cilat janë arsyetimet më të shpeshta të organeve kompetente për mos ndarjen e alimentacionit? Gjatë procesit të shkurorëzimit, nga kush bëhet përfaqësimi ligjor për gruan?

Është një dukuri shumë e përhapur, se po të tregohet afekt ndaj gruas mund të perceptohet si "tradhëti" ndaj prindërve. Prindërit dëshirojnë ta "kenë" të birin në çdo mënyrë dhe pa kurrfarë kushti, me një dashuri tepër "posesive", e cila e kufizon pozitën dhe lirinë e gruas në familje. Sa familje janë shkatërruar për këtë arsye, sepse prindërit nuk e durojnë nusen dhe ndikojnë në fëmijën e tyre, se nusja nuk vlen pesë pare, nuk është për te dhe është shkak i grindjeve familjare.

Në rrethin familjar krijohet një rivalitet absurd në mes të nënës dhe gruas. Nëna "befasohet" se si e "huaja" t'ia marrë djalin, ajo të mos jetë më qendër e dashurisë së tij, pra e ka sjellur deri te gjendja që të ndahet edhe prej nënës. Bashkëshortja, në anën tjetër, mbetet e vetmuar, e tensionuar, e grindur, e pasigurtë dhe paperspektivë. Kjo është sindromi i familjes patriarkale, që fatkeqësisht ende është prezentë në shoqërinë kosovare.

Vitet e pasluftës në Kosovë kanë shënuar një rritje marramendëse të numrit të shkurorëzimeve. Shkak kryesor i konflikteve martesore

është prezenca e dhunës psikike dhe fizike në jetën bashkëshortore. Viktimat në të shumtën e rasteve janë gratë, të cilat zakonisht e heshtin dhunën për shkak të traditës dhe paragjytimeve të vjetra, se "problemet jashta shtëpisë nuk guxojnë të dalin", bindja e viktimave se nëse zbulohet dhuna ekzistuese brenda familjes njolloset familja dhe zbehet imazhi i familjes së shëndoshë.

Frika nga ushtruesit e dhunës se do t'iu hakmirren dhe se dhuna do të merr përmasa edhe më të mëdha është një nga faktorët e heshtjes. Edukimi tradicional se gruaja në familje të burrit duhet të punojtë duroj dhe se nuk ka të drejtë të marrë pjesë në vendimmarje ndikon në heshtje. Shumica e grave viktimave nuk gjejnë përkrahje për të drejtat e tyre as nga familjet e tyre në gjini.

Në momentin kur si pasojë e ushtrimit të dhunës së vazhdueshme paraqesin padi për shkurorëzim, ose kërkojnë ndarje ato duhet të llogarsin se fëmijët sipas traditës i takojnë familjes së burrit, dhe se fëmijët e tyre edhe në gjini nuk iu pranohen dhe janë të padëshirueshëm "si gjak i huaj". Duke marrë parasysh mungesën e infrastrukturës ligjore në Kosovë, edhe nëse arrijnë gratë të marrin fëmijët me vete, e kanë të pa rregulluar dhe të pa definuar çështjen e ndarjes fizike të pronës dhe çështjen e strehimit. Shumica e grave janë të papunësuar dhe me nivel të ulët të shkollimit dhe perspektiva e tyre është e zymtë. Kur iu bashkangjiten këtyre faktorëve edhe implementimi jo i drejtë i ligjeve në fuqi mund të kuptohet lehtë edhe heshtja e viktimave dhe hezitimi i tyre për të kërkuar drejtësi.

Faktorët kryesor që shkaktojnë çrregullime në jetën bashkëshortore janë: pozita favorizuese e burrit në familje në proceset e

vendimmarjes, epërsia e burrit në menaxhimin e buxhetit familjar, primati i burrit dhe familjes së tij në rregullimin e jetës së përditshme të anëtarëve të tjerë të familjes, mungesa e të drejtës së graus në planifikimin familjar, ndërhyrja arbitrare e anëtarëve të familjes së burrit në jetën e çifteve qoftë atyre që jetojnë në bashkësi familjare apo edhe të atyre që jetojnë ndaras nga bashkësia familjare, ndërhyrja e anëtarëve të familjes së burrit në edukimin e fëmijëve, konsiderimi i gruas dhe të fëmijëve si pronë private e burrit-pronë kjo me të cilën ka "të drejtë" të bëjë çka të dojë, pamundësia e komunikimit të ndërsjellë, gjendja psikofizike jostabile e bashkëshortit-es, papjekuria e çifteve për jetë martesore, mungesa e dëshirës për bashkëjetesë, sindromi posttraumatik si pasojë e luftës, mungesa e dëshirës për të pasur marrëdhënie seksuale, tradhtia ndërbashkëshortore etj.

Fenomeni i trekëndëshit të famshëm, bashkëshorti-bashkëshortja-i/e dashura(i) është shumë aktual në shoqërinë kosovare. Me ardhjen e ndërkombëtarve, bashkë me institucionin e martesës është zhvilluar paralelisht gjatë këtyre viteve edhe tendenca për cenimin e besnikërisë. Shkaqet janë të shumta, duke nisur nga nevoja për një komunikim të thellë deri tek mërzia e jetës në çift. Tradhëtia zakonisht zbulohet, por shpesh mbetet e fshehtë nga vetë karakteri intim dhe tepër konfidencial që kanë marrëdhënie të tilla. Gruaja ose burri që tradhëtohet, ndijhen të vetmuar dhe të lënë mënjanë, të pavlerësuar dhe të pakonsideruar. Pra, çdo braktisje shkakton një lëndim të imazhit tonë që ndodhet tek secili prej nesh, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në vetëvlerësim të çifteve martesore. Mirëpo, përkitazi me femrat ato e mbajnë më të fshehtë lidhjen me personin e tretë.

Në këto rethana jeta bashkëshortore bëhet e padurueshme dhe si pasojë lind konflikti martesor, ku në të shumtën e rasteve manifestohet si degradim i personalitetit të çifteve, humbja e kontrollit, vetëbesimit, perspektivës, sigurisë, depersonalizimi, çrregullimet psikosomatike, viktimizimi në hallkë të dhunës dhe përcjella e gjendjes së elektrizuar tek fëmijët. Fatëkeqësisht, në familjet ku mbretërojnë këso farë lloj raportesh zakonisht çiftet zgjedhin rrugën më të lehtë, duke futur në jetën e tyre personin e tretë-dashnorin ose dashnoren. Këtu, pra, fillon mllafi dhe erupcioni i urrejtjes të bashkëshortëve! Natyrisht, vendet më të frekventuara të çifteve bëhen avokatët, qendrat sociale, gjykatat dhe stacionet policore.

Në Kosovë është paraqitur një dukuri specifike- shkurorëzimi me marrëveshje për shkaqe ekonomike, kur meshkujt emigrojnë në botën e jashtme dhe lidhin kurorë me gra të huaja, vetëm e vetëm për të siguruar vizën. Me gjithëse ndarjet janë me marrëveshje, e ardhmja e grave dhe fëmijëve është për tu brengosur. Burrat e tyre nuk lajmërohn pas largimit të tyre nga Kosova. Barra në përkujdesjen e fëmijëve mbetet në nënën pa kurrfarë të ardhurash financiare.

Shkurorëzimet tashmë kanë kaluar në kompetencat e Gjykatave të Qarkut, ndërsa veprimtaria i Qendrave për Punë Sociale është fokusuar kryesisht në punën që lidhet me parapërfundimin e shkurorëzimit si organ i kujdestarisë për të dhënë mendimin lidhur me mundësinë e parë të pajtimit të çifteve dhe të besimit të fëmijëve nëse arrihet deri te shkurorëzimi. Ndarja dallon nga shkurorëzimi në faktin se kjo lidhet kryekëput me QPS-të dhe gjykatat nuk kanë kurrfarë kompetence.

Është interesante se procedura e ndarjes së çifteve pa kurorë fillon dhe mbaron nëpër këto qendra. Ndërsa, ndarja e pasurisë së çifteve hudhet në përgjegjësinë e Gjykatave Komunale.

Shpjegimet e gjykatave kosovare për shkurorëzimet janë: se këto paraqiten për shkak të dhunës familjare, posedimit të karaktereve të ndryshme të çifteve bashkëshortore dhe për shkak të kushteve ekonomike. Kërkesat për shkurorëzim parashtrohen nga të dy palët. Megjithatë, ka një dallim në baza gjinore. Vetëm një e treta e kërkesave për shkurorëzim parashtrohet nga gratë. Gjykatësit janë më analitik në besimin e fëmijës. Këta deklarojnë se kjo varet nga rrethanat, kushtet e jetesës dhe vet kërkesave të fëmijës mbi moshën 10 vjeç, por përgjegjësinë e hudhin në shportën e qendrave sociale, sepse këto e kanë detyrën e përcelljes së kushteve të jetesës dhe të kualitetit emocional të prindit për fëmijën. Ndarja nga fëmija bëhet edhe me marrëveshje që quhet një "braktisje me marrëveshje" nga nëna.

Sa i përket respektimit të vendimit për ndarje të alimentacionit, palët nuk e respektojnë, e quajnë "një copë letër", e cila në të shumtën e rasteve vështirë aplikohet. Pala që nuk respekton këtë, janë burrat. Përfaqësimin ligjor të gruas gjatë procedurës së shkurorëzimit e bëjnë vetëm avokatët zyrtar. Në gjyqësinë kosovare nuk përzihet procedura e shkurorëzimit me procedurën e trashëgimisë. Kohëve të fundit padinë për shkurorëzim po e ngrisin gratë. Alimentacioni është çështje e kushtëzuar me gjendjen materiale të bashkëshortit të ndarë. Varfëria e madhe është duke cunguar të drejtën në alimentacion, e me këtë rast edhe cungon të drejtën e besimit të fëmijës tek nëna.

Duke marrë parasysh atë që është theksuar më lartë, a ia vlen të flasin bashkëshortët me njëri-tjetrin? Problemi qëndron të falin apo jo?! Marrëdhënia bashkëshortore është tepër e rëndësishme, duhet ushqyer vazhdimisht, dhe kur nuk është fjala për një tardhëti të përsëritur, falja është nderi më i madh që mund t'i bëjnë çiftet lidhjes bashkëshortore. Përndryshe, bashkëshortët do të përballen me drejtësinë, e cila është e ngadalshme por goditjen e ka të fuqishme!

KËSHTU THOSHTË FISHTA ...

Dr. Aurel PLASARI

Ne kulturën shqiptare të dhjetëvjeçareve të parë të shek. XX mendimi teorik-estetik njih hopin e parë cilësor, që do të bëhet i ndjeshëm sidomos në periudhën mes dy Luftërash botërore. Si në shumë kultura me fat të ngjashëm, edhe në atë shqiptare zhvillimi i këtij mendimi shfaqet me karakteristikë të parë ndërthurjen, që duket si e përhershme, mes kritikës letrare dhe asaj të artit, mes historisë (përkatësisht teorisë) së dukurisë artistike dhe analizave që i brendashkruhen estetikës si disiplinë e specializuar.

Faktorët që e kushtëzojnë përhapjen e ideve estetike, si dhe imponimin e tyre, në kulturën shqiptare të këtyre dhjetëvjeçareve, janë të shumtë dhe të ndërlikuar, në mos edhe të implikuar me elemente kontradiktore që mund të ndikojnë si në përhapjen, ashtu në zgjerimin e këtyre ideve. Duke pasur për sfond zhvillimin e vetëdijes për misionin e artit në jetën shoqërore dhe kulturore, në letërsinë (më shumë se në artet) shqiptare të asaj periudhe nisin të lulëzojnë dhe të bëhen të njohura krijime madhore, të kultivuara, si dhe gojore. Duke iu përgjigjur nevojave shpirtërore të shoqërisë shqiptare, por, siç është e natyrshme, edhe duke i nxitur e madje provokuar ato, krijimtaria letrare-artistike e periudhës mesdyluftore në Shqipëri vjen duke i shtuar kërkesat estetike, si dhe duke u sinkronizuar gjithnjë më mirë me stadin e ngritur të konceptit artistik modern evropian. Nga ana tjetër, është i ndjeshëm në të njëjtën periudhë edhe një mjedis artistik periferik, pa kritere e kërkesa estetike, që fut në perimetrin e

krijimtarisë letrare tonalitete të rrëguara, sentimentalizma të vjetruara, tanimë edhe një barrë keqkuptimesh lidhur me "vlerat" e asaj letërsie që quhet "e rilindjes kombëtare". Formësohet atëherë një éventail perspektivash që ndihmojnë në mënyrë të ndjeshme në mëvetësimin e fushës së estetikës, duke çelur para mendimtarëve shqiptarë një vis të dendur problemesh, gjithë pretendime, vështirësi, të papritura.

Historikisht i bie të jetë Faik Konica (1876-1942) i pari teoricien shqiptar që do t'i japë shtytje vështrimit kritik të punëve në letërsinë shqipe, duke u përpjekur t'i kthjellojë ato, t'i nxjerrë në rrafshin e vetëdijes kritike dhe, sidomos, t'u japë një status sa më aktiv, më konstruktiv, në përputhje me nevojat konkrete, me dinamikën e kulturës shqiptare të kohës. Konica do të jetë (historikisht) edhe i pari mendimtar shqiptar që përhap ide estetike bashkëkohore në kulturë përgjithësisht. E kam fjalën jo aq për shkrime deri diku të njohura, si Kohëtore e letrave shqipe (1906), i cili mbahet për dokument i themelimit të kritikës letrare shqiptare, Letërsia shqiptare, Shënim për metafizikën e bektashinjve apo për kritikë të llojit utilitar, si ato recensione për libra të ndryshëm të botuara gjithnjë në Albanian e tij, por për shkrime si Skicë e një metode për t'u duartrokitur prej borgjezëve (1903), Sprovë mbi gjuhët natyrore dhe gjuhët artificiale (1904), Mistifikimi më i madh në historinë e gjinisë njerëzore (1904) etj. Një një pjesë e përfillshme e mendimit estetik të Konicës ose nuk pati ndonjë rezonim të veçantë në kulturën shqiptare, ose në të nuk u receiptua aspak. Atëherë, fill mbas tij, duke filluar prej viteve '10 të këtij shekulli, do të jetë një tjetër personalitet proteik i kulturës shqiptare, Gjergj Fishta (1871-1940), ai që do të imponohet në këtë kulturë jo vetëm si shkrimtar (poet, dramaturg, prozator etj.), por edhe si kritik, historian i letërsisë e, posaçërisht, estet.

Fillimet e mendimit estetik të Fishtës mund të llogariten me Parathānen e shkruar prej tij për përmbledhjen Visari komtaar. Kāngë popullore gegnishte (Sarajevë 1911) të V. Prennushit. Mund të thuhet se me këtë shkrim nis një periudhë e parë në mendimin teorik-estetik të tij, e cila do të lidhet më drejtpërsëdrejti me themelimin prej tij të njërit nga organet më të rëndësishme të kulturës shqiptare, së parës revistë kulturore në Shqipëri, Hylli i Dritës, në vitin 1913. Duke filluar prej nr. 2 të vitit të parë të kësaj reviste, me shkrimin polemik (me vijime) A janë të zott shqyptarët me u majtë shtet n'vedi, përvijohet në mënyrë të qëndrueshmë, si tipar kryesor i shkrimeve të tij teoriko-estetike të kësaj periudhe, shtysa polemike.

I shqetësuar jo thjesht nga libri-paskuil i një ish-kryeministri serb (V. Gjeorgjeviç), por nga një propagandë e tërë gazetash të huaja të kohës për "mbrapambetjen" e popullit shqiptar, "nivele e ulët" të zhvillimit të tij, "barbarinë" e tij dhe, sidomos, "paaftësinë" e tij për të ndërtuar një shtet të vetin e për jetuar në të, Fishta i kundërvë kësaj propagande tezat e veta. Kryeteza ndër to është se niveli i zhvillimit të një populli matet me nivelin e poezisë së tij, të ligjeve dhe të kodit dokesor të tij, shkurt: me parametra të sferës psikike të atij populli. Për të vërtetuar këtë, ai shtie në punë edhe argumente mirëfilli të rendit estetik: shqyrton (dhe përpiqet ta përkufizojë) të bukurën (pulchrum), duke e ballafaquar atë me të mirën (bonum); introdukton në mendimin teorik-estetik shqiptar parimet e harmonisë, të përkryerjes, të rrëgullit t'shestimit (ordo); shpjegon çështjen e "këndelljes" (diçka mes delectatio dhe voluptas), duke vënë në pah kështu komponenten hedonike që e shoqëron detyrimisht artin; rifunksionalizon kategorinë e moçme të "dritës", ndoshta të përpunuar prej caritas-it të Shën Tomës s'Akuinit apo prej splendorit të skolastikëve; duke folur për një aftësi të posaçme në të përkapurit estetik, sado kalimthi, fshik një nga

trajtat e teorisë relativiste të shijes të përpunuar prej traditës empiriste (angleze) dhe këtu koncepti i tij i "synit të mendjes" nuk mund mos të përkujtojë "shqisën morale", "syrin e brendshëm" të kontit Shaftesbury apo "shqisën e së bukurës" të F. Hutcheson-it etj. Argumente të të njëjtit rend janë shtënë në punë, për të mbrojtur identitetin kulturor dhe nivelin e zhvillimit qytetërimor të popullit shqiptar, në Parāthanen e Visarit (1911), si dhe do të përdoren në tekstin Shqyptarët e të drejtat e tyre, shkruar nga Fishta në Paris (1919) për t'u ligjëruar prej Imz. L. Bumçit në Universitetin e atij qyteti.

Po në këtë periudhë zë fill edhe kontributi i tij në fushën e kritikës letrare, me shkrime recensionale te Hylli i Dritës (një ndërkohë dyvjeçare edhe te Posta e Shqypnks) për vepra të ndryshme, kryesisht të letërsisë shqipe. I përftuar me një strukturë klasike, në fushën e kritikës letrare ai fillon të sqarojë, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, një sërë konceptesh themelore, duke theksuar dukshëm përpjekjen për integrimin e letërsisë, të kritikës dhe të historisë së letërsisë shqipe në sitemin e vlerave universale.

Periudha e dytë, që përvijohet përfarësisht në vitet '20, e ka edhe ajo të ndjeshme "shtysën polemike", por tanimë për këtë shtysë mund të thuhet se funksionon së brendshmi. Kjo periudhë fillon me shkrime, si Perlindja e Shpirteneve (1921), Kisha katolike ka trajtue kulturën okcidentale (1923) etj. Mund të karakterizohet si periudhë e zgjerimit të bazës së interesave estetikë të Fishtës, që na e dëshmon, për shembull, si shkrimi Federata "Vatra" dhe muzika (1923), ashtu edhe skica e pambaruar Përmi pesë rende t'arkitekturës mbarë (vitet '20). Duke tejkaluar çështjet e estetikës së përgjithshme, në të dyja Fishta studion përfitim e dukurisë konkrete të arteve, duke e shndërruar shqyrtimin e saj në një studimi mbi format, mbi teknikën dhe mbi

përmbajtjen shpirtërore të krijimit e të kundrimit, në kuadrin specifik qoftë të muzikës, qoftë të arkitekturës.

Në këtë periudhë të dytë interesat artistikë të Fishtës hapen edhe në veprimtarinë praktike. Duke qenë i vetëdijshëm se ekzistimi kombëtar i një vendi lidhet drejtpërsëdrejti me ekzistimin artistik të tij, ai u vihet personalisht organizmit teatror (si regjisor), projekteve dhe realizimeve arkitekturore, deri edhe pjesëmarrjes në ekspozita pikturë.

Një periudhë e tretë, që do të emërtohej "e viteve '30", nis po ashtu me shkrime të konceptuara polemikisht. Por tani ky konceptim ngjan hapur me një "shkas". I kthjellët për faktin që në Shqipëri krijimi artistik (posaçërisht ai letrar) ka mbërritur në një stad që kërkon një sqarim parimor dhe një nxitje të domethënies së koordinatave specifike të veprës së artit, Fishta i vihet punës për të ofruar modelin e një optike më të nuancuar, më të eptueshme në gjykimin e vlerës estetike. Këtë synon ai të realizojë përmjet polemikash, si Nji atentat shurdhë (1930), Hijeve të Parnasit (1932), Vjerrsha heroike shqyptare (1935) etj., me anë parathëniesh, si ato për Poetët e mëdhej t'Italkës (1932) apo Kanuni i Lekë Dukagjinit (1933), por edhe shkrimesh të ndryshme, ndër të cilat shënon kulmin Në rasë të Qindvjetit të dekës së Wolfangut Goethe (1932). Të kërkosh parimin estetik do të thotë tani për të: të ballafaqosh kryeveprat duke nxjerrë prej tyre ligjësitë për krijimet e ardhshme.

Duke punuar për t'i dhënë aktit të vlerësimit të veprës letrare (dhe asaj artistike) kuptueshmëri, stërhollësi dhe rreptësi, me shkrimet e tij teorike të kësaj periudhe ai bëhet shëmbulldhënës. Simbas normave të retorikës klasike, me tekstet e tij estetike (dhe kritike) njofton të

vërteta thelbësore tanimë në formula të papritura. Ka mundësi që një aftësi oratorike e lindur, ose e stërvitur prej profesionit të predikatorit, ta ketë prirë atë drejt konstruksionesh me një rregullsi të përkryer, të përkapshme në nivelin më të thellë, të komunikimit të ideve. Kësi konstruksionesh funksionojnë si kanune stilistike (që të bëjnë për vete me trillin dhe gjallërinë) për të mbërthyer vëmendjen e auditorit/lexuesit përmjet digresimesh, figurash plastike, metaforash, asociacionesh etj., të cilat dëshmojnë një lëvizshmëri (të frikshme) mendore dhe një ngarkesë (të madhe) kulturore, me referime të hapura nga fusha e arteve. Ka pohime të tijat, të kësaj periudhe, të cilave mund t'u bëhen verejtje; por kemi të drejtë të mendojmë edhe që Fishta t'i ketë konceptuar "predikimet" e veta estetike (dhe kritike) në mënyrë sentencioze, pa ngulmuar gjithmonë në shpjegimin e të gjitha mendimeve pikërisht me qëllimin për të nxitur diskutimin, madje ridiskutimin e vlerave nga një perspektivë vetjake, përmjet një akti kritik vetjak. Duke qenë prirja e "klasikut" të formulojë fjali, shprehja e tij ndodh të bëhet apoftegmatike; atëherë jo e vërteta ka rëndësi, por fjalia. (Kjo mund të jetë e vështirë për t'u përkapur nga lexues të sotëm, për të cilët një propositio nuk është më, si në kohën e traditës retorike latine, "fjali" në gramatikë dhe, njëherësh, "premisë silogjizmi" në filozofi.) Në shkrime të kësaj periudhe, si dhe te ndonjë i mëparshëm apo i mëmbasshëm, ai që shkruan duket i kapluar nga një frymë ludike, nga një endirë spekulative që të rrëmben. Por është një lojë që do kuptuar në nivelin më të lartë, atë klasicist, e cila ka të bëjë me shprehjen e paformular ndonjëherë më parë, provokuese, me asociacione që shtyhen deri në pikën e nxitjes së reagimeve.

Në këtë periudhë edhe krijimtaria e tij kritike, pavarësisht formës së saj, vjen e ngarkohet me peshë filozofike. Eseja magjistrale Në rasë të

Qindvjetit të dekës të Wolfgangut Goethe (1935) mund të shërbejë si ilustrim i goditur për një kësi ngarkese. Duke i veçuar tanimë me saktësi fushat, pa i vënë vetes detyrë ta shndërrojë kritikën në estetikë, Fishta nuk ngurron të përdorë koncepte të afërta me filozofinë kur bën fjalë për krijim, liri, inventim, imitim, ndjenjë, shije etj. Në këtë pikë, marrëdhëniet kritikë/estetikë shtrojnë, në rastin e Fishtës, një problem që ndoshta kurrë më nuk do të vijë hera të shtrohet në historinë e kulturës shqiptare: "filozofia dhe kritika" apo "filozofia e kritikut"? Fishta paraqitet në këtë kulturë si arketip i artistit për të cilin kritika është filozofi. Ngjan sikur pikërisht për të ta ketë formuluar Croce-ja parimin se kritiku, në mbarim të hulumtimit të tij, duhet të orvatet ta përmbledhë gjykimin e vet në "një formulë", e cila të mbetet gjithnjë e hapur, për sa kohë nuk përjashtohet kurrë një proces i mëtutjeshëm analize që ndikon mbi vetë formulën dhe e modifikon atë. Thuajse në asnjë rast Fishta nuk synon t'u imponojë lexuesve një "kanun", një model të ngulët për t'u ndjekur me bindje e rreptësi.

Në këtë mënyrë, Fishta zë në historinë e letërsisë shqiptare vendin e njërit nga më të parët kritikë që e kupton se, për shembull, edhe figura është një ndjenjë. Atëherë, duke u ngritur përmbi vlerësimin empirik, ligjërimi i tij kritik merr edhe vlerë shkencore në vetvete. "Formulat" e tij, ndonëse përfaqësojnë një opinion individual dhe jo një dije universale, bëhen sinteza e një shijeje ngaqë kritiku punon për t'i vënë themel shkencor opinioit të tij. Interesi i hulumtimit të tij qëndron tani jo tek opinioni, por te themeli. Që Fishta e gjen Faustin jo protagonist të veprës dhe kryeveprën e Goethe-s pa unitet organik etj., kjo pak rëndësi ka; rëndësi ka themeli që ai këtyre gjykimeve u vë.

Kështu Fishta kritik bëhet edhe filozof i veprës së artit; por jo vetëm filozof, bëhet edhe filolog i saj, edhe historian, edhe psikolog i saj. Të

kujtohet se, veçanërisht në vitet '10 dhe '20, kritiku shqiptar kufizohej duke bërë historinë e poetit dhe të veprës së tij, duke vendosur lidhjet mes artistit dhe veprës së tij, ose duke u endur nëpër krahasime leksikore, çfarë nuk e dallonte shumë nga hulumtuesi historik e filologjik në përgjithësi. Pak ndryshim kishte, në një rast të tillë, nëse zgjidhej për për subjekt një poezi apo një regjistër famullie. Me përçapjen e vet, Fishta ofron jo vetëm një shembull të aktit krijues të quajtur kritikë - histori letërsie - komparatistikë, si anë të të njëtit proces rekuperimi të vlerave domethënëse të letërsisë, por edhe një mësim mbi lirinë sovranë të shpirtit të artistit, mbi aftësitë e tij për shkapërciminin e kufijve të të menduarit konvencional.

Realizimin më të rëndësishëm në këtë fushë, jo vetëm për këtë periudhë, por për krejt mendimin teorik-estetik të Fishtës dhe, ndoshta, edhe për traditën e mendimit estetik shqiptar, e përbën Shenime estetike. Mbi natyrë t'artit (1933), botuar me dy vijime në Hyllin e Dritës dhe ndërprerë. Rrafshi i përgjithshëm i një sipërmarrjeje të tillë teorike, me pretendimet e një traktati estetik, synon tani drejt një shkepjeje të plotë të dukurisë estetike prej sferave të tjera të përfaqëta shpirtërore; është fjala për një rrokje të specifikës së kësaj dukurie dhe, në të njëjtën kohë, normëzimin (nëpërmjet aktit kritik) të krijimit artistik e letrar. Nevojën e shkepjeje të tillë të dukurisë estetike prej një konglomerati dukurish heterogjene duket se, para Fishtës, e kishte kuptuar vetëm Koniza, ndërkohë që për të nuk ka qenë aspak i vetëdijshtëm De Rada tek ato që ai i ka quajtur Parime të estetikës (1861).

Fati i veprës Shenime estetike në historinë e mendimit estetik shqiptar të përkujton çuditërisht fatin e një traktati të famshëm në historinë e

mendimit estetik botëror: të ashtuquajturit "Longin i rremë". Quajmë kështu në historinë e këtij mendim veprën Mbi ngritjen (Peri hypsous), e përkthyer nga romakët si Mbi të madhërishmen (De sublimitate), të cilin ia kanë atribuar gabimisht filozofit helen Longin (rreth 210-273). Edhe mbasi është vërtetuar që traktati nuk i përket Longinit, autori tij i vërtetë, me gjasë ndonjë hebrë i diaporës aleksandrine, ka mbetur pa u zbuluar. Shenimet estetike të Fishtës, të nënshkuara me inicialin A., kanë mbetur për mjaft kohë pa u përmendur si të tijat. Deri edhe në tekstin e tij Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983 (Prishtinë 1983, Tiranë 1996), duke përshkruar Shenimet estetike të botuara te Hylli i Dritës, I. Rugova nuk e paskësh identifikuar autorin e tyre (f. 365-366). Madje dy faqe më tej, duke përshkruar një artikull të vitit 1941 të K. Prelës po te Hylli, I. Rugova shkruan: "Na jepet të mendojmë se ky autor, Kolë Prela, mund të jetë autor edhe i artikullit "Shenime estetike", që e vështruam më lart e që e nënshkruante me "A". Këtë e themi duke u mbështetur në gjuhën dhe terminologjinë e njëjtë të këtyre dy punimeve" (f. 370). Një konstatim befasues, përderisa në bibliografinë "zyrtare" Vepra letrare e At Gjergj Fishtës, të hartuar prej sivëllait (franceskan) të shkrimtarit, At B. Demës dhe të botuar në organin kulturor të franceskanëve (Hylli i Dritës) njoftohet shkoqur si vepër e Fishtës Shenime estetike. Mbi natyrë t'artit (1933). Të hamendosh që Rugova të mos e ketë njohur këtë bibliografi? Nuk mundesh, mbasi bibliografinë në fjalë, të botuar në përmbledhjen At Gjergj Fishta 1871-1940, vetë Rugova e përshkruan në veprën e tij shtjellimisht në f. 350 të të njëjtit punim: "37. At Benedikt Dema: Vepra letrare e At Gjergj Fishtës". A është i njëjti Rugovë ai që ka shkruar faqet 348-350 me atë që ka shkruar faqet 365-370? Sa kohë nuk do ta shpjegojë ai vetë, lidhur me veprën e Fishtës do të mbetet edhe ky një mister më shumë. Kalimthi kujtoj se një estet si J. Mato, kur vendos të

shprehet për mendimin estetik të Fishtës (më 1996), identifikimin e autorësisë së Shenimeve estetike nuk e ka të vështirë.

Traktati i Longinit, i shkruar me gjasë në shek I (të e. r.), parqitet sot si një tekst i ardhur nga një dorëshkrim i shek. X, me mangësi dhe i pambaruar. Teksti i Shenimeve estetike, i filluar prej autorit dy herë (më 1932 dhe më 1933), vjen gjithashtu i pambaruar. Nuk dimë nëse ai nuk është mbaruar së shkruari apo ka mbetur pa u botuar i gjithi dhe pjesa tjetër e dorëshkrimit nuk gjendet. Historikisht dimë vetëm se, prej atij viti (1933), autorit do t'i duhet të largohet nga Shqipëria për shkak të "sherrit" me shtetin shqiptar: nën variantin e mbylljes së "shkollave private" françeskanëve u kishin mbyllur liceun zulmëmadh të drejtuar prej vetë Fishtës!

Hebent sua fata libelli, thoshin latinët: Çdo libër ka fatin e vet. Mund vetëm të shprehësh keqardhjen që një "fat" i tillë i paskësh qëlluar edhe një vepre si Shenimet estetike. Botimi i parë që njohim i traktatit të "Longinit" është ai latin i vitit 1554. Prej tij kanë kaluar dy mijë vjet dhe kush e lexon atë sot mahnitesh prej frymës së gjallë që ai sjell. Është, pra, një vepër dymijë vetsh e vjetër, të cilës nuk i ndihet aspak myku i skolastikës apo i bibliotekave. Më shumë se gjashtëdhjetë vjet kanë kaluar nga botimi i traktatit estetik të Fishtës, ndërkohë që me rishfaqjen e tij sot nuk mund të mos befasoresh prej freskisë së mendimit, origjinalitetit. Shfaqja e helenit të panjohur në shek. I mund të quhet një mrekulli, aq përmbi kohën e tij ka qëndruar "Longini". Mirëpo, edhe botimi i parë që prej tij njohim (1554) ka kaluar thuajse pa rënë në sy. Mendimi i tij, prandaj, është quajtur një "shkëndijë që nuk ndezi askund". Diç e përafërt mund të thuhet edhe për traktatin e Fishtës dhe rolin e tij në kulturën shqiptare. Që dikur Antikiteti të paskësh bërë komplotin e heshtjes kundër "Longinit", është një nga simptomat më të qarta të bjerjes së fuqisë intelektuale të asaj epoke

në sosje e sipër. Po kështu kultura shqiptare, në hipostazat e trazuara që kalonte në vitet '30-'40 dhe sidomos mbas vitit 1945, duke refuzuar ta dëgjojë Fishtë, i ka shkaktuar mendimit të vet filozofik një nga dëmet më të pandreqshme. Nëse "Longini" pati qenë viktimë e traditës së mediokritetit antik, viktimë e një tradite të pashkatërrueshme mediokriteti, që ende valavit ngjadhënjimtar flamurin e rreckosur në sa e sa beteja, ka rënë në Shqipëri edhe mendimi teorik-estetik i Fishtës.

Duke mos qenë vendi për t'u ndalur në shkaqet se përse është shkruar aq pak mbi kontributin estetik (dhe kritik) të Fishtës, kujtoj vetëm një të vërtetë: që mendimi teorik-estetik i tij nuk ka gëzuar, dhe vijon të mos gëzojë, simpatinë (apo kuptimin) e shkrimtarëve dhe artistëve shqiptarë. Guximi, kthjelltësia, niveli i përparuar, madje edhe origjinaliteti i metodave të tij të punës, si dhe në përgjithësi larmia e problemeve që ai diskuton dhe vë në diskutim, dëshmojnë pa dyshim për një fuqi krijuese që del jashtë së zakonshmes. Nuk është e vështirë të kuptohet se përse fuqi të tilla gjallin adersion, nganjëherë edhe ndër personalitete në zë të një kulture. Madje, vini re: vetë fakti që adersioni antiFishtë shpallet zhurmshëm, me furi të tepruar, të bën të dyshosh edhe për një kompleks faji të detraktorët... Nuk zmadhoj nëse them se nuk kam takuar veçse një ose dy intelektualë mbi të 40-at që të shfaqin njëfarë interesi për mendimin filozofik të Fishtës. Pohoj, gjithashtu, se kam takuar shumë të rinj që "të mburren" se nuk e kuptojnë, nuk e marrin vesh ose thjesht nuk e pranojnë mendimin në fjalë. Nga ana tjetër, duhet thënë edhe se mendimi teorik-estetik i Fishtës numëron admirues mes atyre që ndeshen rrallë në botën kulturore shqiptare; L. Poradeci, që ia dhuronte veprën e vet me përkushtim: "Poetit militans et medicans", është vetëm njëri syresh. Një ngrohtësi e kuptueshme, një aderim thuajse pa rezerva, një

gatishmëri e veçantë për të depërtuar thellë në këtë mendim, i bëjnë këta admirues për t'u patur zili.

Për kulturën shqiptare, përgjithësisht, nuk mund veçse të quhet fatkeqësi fakti që një pjesë e mirë e mendimit estetik (dhe kritik) të Fishtës, ashtu si pjesa më e mirë e atij të Konicës, nuk patën rezonime të veçanta, u receiptuan pak ose aspak dhe, sidomos, u shkëputën përdhunshëm nga rrjedhat normale të mendimit filozofik shqiptar. Ta pranojmë se në filozofi vonesat janë katastrofike, ndërsa shkëputjet - një rrënim i vërtetë.

Po ta krahasosh gjendjen e sotme të mendimit filozofik me traditën që ky mendim është detyruar të braktisë, llogaritë e rrënitit nuk dalin të lehta. Për të sjellë ndonjë shembull, kujtoj se shkrime si Skicë e një metode për t'u duartrokitur prej borgjezëve (1903), Sprovë mbi gjuhët natyrore dhe gjuhët artificiale (1904), Mistifikimi më i madh në historinë e gjinisë njerëzore (1904) etj. të Konicës ruajnë ende origjinalitet mendimi dhe madje aktualitet edhe në një kulturë si francezja. Te Mistifikimi, fjala vjen, duke mohuar karakterin "gjuhësor" të gjuhëve orientale si të tilla dhe duke shtjelluar karakterin e tyre kriptografik, duke e trajtuar gramatikën e tyre si një "traktat pornografik", madje duke vënë në dyshim vlerën dekodifikuese të versionit biblik të "Të shtëdhjetëve" (Septuaginta) etj., përtej bizarive të kuptueshme për kohën, Konica introdukton një nga teoritë më interesante në këtë fushë, atë të strukturave gjuhësore-estetike në orientalistikë. Po kështu, te Skica trajton një subjekt të mirëfilltë estetik. Në vijim të tezave të ngritura me Sprovën, duke iu përgjigjur partizanëve të esperantos, gjuhë ndërkombëtare artificiale, Konica i jep rëndësi lexuesit, nisur nga trinia: vepër letrare- autor- lexues

"Është e pamohueshme - vëren ai - që individi me formim artistik mesatar (médiocre) dhe për më tepër i mbushur paragjykime, pra borgjezi mes të gjithëve, duartroket më shumë domethënien morale sesa bukurinë e një vepre". Me ngulmimin e tij mbi rolin e instancës receptuese në vlerësimin e krijimit artistik, Konica bëhet një nga pararendësit e asaj që sot quhet "estetikë e receptimit" etj.

Të kuptosh një mendimtar, si dhe një sistem të menduari, do të thotë zakonisht të vendosësh lidhje të tij me mendimtarë të tjerë, si dhe me sisteme të tjera të menduari, të dyshuara si të përafërta. Një procedim i tillë rrallë del huq. Fjala vjen, J. Mato ka menduar se është "brenda" duke e vendosur lidhjen mes mendimit estetik të Fishtës dhe "filozofisë kristiane": "Ai përqendrohet në disa teza të përgjithshme të filozofisë kristiane..." (Krijime, 118) "Tezat e pikëpamjet janë shtjelluar në mënyrë origjinale, në bazë të filozofisë kristiane..." (po aty, 122). Të mos jetë në dijeni për atë që quhet "estetikë kristiane" gjatë Mesjetës dhe, më tej, "romantizëm kristian" në estetikë?! Madje edhe për rastin kur Fishta analizon trajtat e parme (primordialis) të sendeve, të krijuara nga "Shkasi i Parë", për estetin e sotëm këtë e bën "nisur nga filozofia kristiane" (f. 118). Të mos e dijë, vallë, esteti i sotëm se parimi i "Shkasit të Parë" (prima causa) njihet në filozofi si parim mirëfilli platonik, vetëm sa i rimarrë nga filozofia mesjetare dhe, më mbas, nga idealizmi gjerman?! Në rastin e Fishtës, për shembull, vërehet lehtë se si, qysh në shkrimin e 1913-s, duke ndarë "nivelet" e zhvillimit qytetërimor të popujve simbas përkatësisë në pesë periudhat e zhvillimit të arteve të tyre (I. poezia e hebrejve; II. poezia e indianëve dhe e egjiptianëve; III. klasicizmi në Greqinë e vjetër etj.), ai i bën një nga zhvillimet origjinale teorisë së Hegel-it mbi evoluimin dialektik të artit në historinë e kulturës njerëzore. Ndërkohë, në shkrime të tjera

mund të dallosh një zotërim të tezave të njërit prej kundërshtarëve "formalistë" të Hegel-it, si J. F. Herbart. Në polemikat kulturore me "fletoret e Francës", duke vënë në dukje lidhjet mes tragjedisë greke, mitologjisë greke dhe riteve fetare, nga njëra anë, shkrimet e Fishtës të përkujtojnë teori që do të përpunohen pak a shumë në po atë kohë prej filozofësh si Jane Harrison nën ndikimin e teorive të Sir Frazer-it. Nga ana tjetër, me vënien në diskutim të të dhënave patologjike, fiziologjike e kranimetrike, me refuzimin e tyre dhe, njëherësh, me implikimet e qarta kulturore-antropologjike përgjatë argumentimit, Fishta shfaqet si pararendës në përpjekjet për përpunimin e një teorie të përgjithme të kulturës njerëzore ("antropologji kulturore"), e cila do të realizohet në vitet '20-'30 nga E. Cassirer-ja si teori e neokantine e "formave të mëdha simbolike" më kulturë.

Të gjykuarit historik na është bërë aq i natyrshëm dhe duket, në të shumtën e herëve, aq i drejtë, sa nuk ngurojmë ta vëmë në punë rast e pa rast. Mirëpo, në rastin e mendimit teorik-estetik të Fishtës, si dhe të sistemit të tij, nuk besoj se mund të delet, nëpër këtë rrugë, në ndonjë rezultat me vlerë. I veçanësuar në hulumtime, edhe si objekt edhe si metodë, vendosja e lidhjeve të Fishtës mendimtar bëhet e vështirë. A thua se përafrimet, në vend që ta afrojnë, e largojnë, duke ia huajtuar gjithë sa në mendimin e tij mund të ketë origjinale, pra të papërafrueshme. Sikurse mësohet tërthorazi, prej një letre të vetë Fishtës drejtuar njërit prej detraktorëve të tij politikë, më 1922 ai ia ka dërguar një nga tezat e veta një filozofi anglez, të specializuar për estetikë dhe etikë në Universitetin e Cambridgeit. Në përgjigjen e tij, anglezi shprehet se teoria estetike e Fishtës e ka mbushur me "një entuziazëm shpirtëror të vërtetë", e cilëson këtë "të re dhe krejt

originale", ndërsa Fishtën e përshëndet si "themeluesin e një shkolle filozofike shqiptare". Për cilën teori (a tezë) të ketë qënë fjala, vallë?

"Zonat" origjinale më mendimin teorik-estetik të Fishtës nuk janë të pakta. Mjafton të lexosh Shenime Estetike. Mbi natyrë t'artit (1933) dhe ja ku të mbetet në mend, në pikëprerje të filozofisë me psikologjinë e krijimit, teoria e "dy rruzullimeve". Në mendjen e njeriut, simbas kësaj teorie, ekzistojnë dy rruzullime: i dukshmi ose real dhe ideali, i krijuar prej vetë mendjes përmjet fuqisë së imagjinatës. Me anë të të pamit dhe shqisave të tjera, mendja përkap dhe njeh rruzullimin e dukshëm, me çfarë përmbledh ai brenda vetes; me anë të imagjinatës, mendja grumbullon imazhet e rruzullimit të dukshëm, me të gjitha mbresimet që objektet kanë mundur të lënë mbi të. Në këtë mënyrë mendja, shkallë-shkallë, krijon brenda vetes rruzullimin tjetër, atë ideal. Për Fishtën, ky rruzullim ideal është më i hapur dhe më i madh se rruzullimi real, mbasi me anë të imagjinatës mendja e njeriut mund të ndajë ose të bashkojë pjesët e një objekti me ato të një objekti tjetër dhe të përftojë kështu një individuum të ri në rruzullimin e vet; një përftim i tillë është, për Fishtën, hipogrifi (kali me fletë) që në rruzullimin real nuk ekziston. Duke përshkruar rruzullimin ideal të artistit, ai vë në dukje se mendja e artistit ka aftësi më të mëdha se të tjerët, për nga intuita dhe imagjinata, dhe se rruzullimi ideal i tij është më i madh e më i bukur nga ai i të tjerëve.

Ose, ja një tezë tjetër interesante, po nga Shenimet estetike: "Dikush pat pvetë një herë Rafaelin, tue i thanë se kah aj e nxierte at bukurq aq të bindshme të "Madonne-vet" të veta: "Da una certa idea", i pergjegjet Rafaeli. Pra jo prej ndonji ideje të zakonshme të sendevet si gjinden në natyrë, por prej një ideje të perftueme neper intuicjon në

mendje t'artistit mbk sendin, si ky gjindet i smadhuem në fantazk. Prandej gabojnë ata q thonë se arti është një nderndjeksim a imitacion i natyrës; si mundet me u vertetue puna edhe prej fotografijet, e cilla sugurisht paraqet natyren më besnikisht se ç'do artist në nam e në zā, e me gjith kta ajo nuk është art. Mā teper shifet se madhnikn e idēs s'objektit të vepres artstike e sendergjon geni, a se shpirti, substancë individuale, e fjeshtë e arsyetuese - të thonë shka të thonë idealistat e materjalistat e ksohohshem, pak a shum nipa e sternipa majmunash, jo aq pse shum nder ta e mbajn vehten se janë rodit të majmunit, sa per punë qi të gjith -po thue se si majmuni - imitojnë teorjt e straplakne të kohvet të kalueme..."

Kur lexon këtë "shenim" plot thellësi kritike, pyet veten nëse shumë kritikë arti shqiptarë, që shqetësohen për "teorinë e pasqyrimit" dhe rreken për "redefinimin e çështjes së pasqyrimit", nga vitet '60 e këndeje, madje duke u mburrur për meritën e se e paskëshin "zgjeruar" këtë teori edhe me "elementin e krijimit" dhe paskëshin shpikur "pasyrimin e transformuar" etj. etj., a sjellin vërtet ndonjë gjë të re në krahasim me atë që dinte dhe shkruante Fishta në vitet '30? Apo me mënyrën si e parashtronte Fishta teorinë e vet? Me pohimin e tij "rebel" se teoria e imitimit (mimesis) nuk qenkësh veçse një "teori e straplakne"?

Pranimi që në filozofi vonesat janë katastrofike, ndërsa shkëputjet - rrënim i vërtetë, do bërë jo për të ndjellë keq, por për të pranuar burrisht një gjendje dhe për të gjetur rrugët për ta ndryshuar atë; ose, së paku, për ta përmirësuar.

Për një student të sotëm të letrave, Fishta do të përfaqësonte një dukuri sintezë: sintezë e një morali, e një bote klasike ("Asnjë art nuk mund të jetë më i bukur se klasiku", Hegel) dhe njëherësh moderne, e një mitologjie të tërë në kulturën shqiptare. Përmjet Fishtës realizohet te ne sinteza e spekulimeve (spaeculatio) mbi artin, sinteza e rragatjeve të pasionuara mbi gjuhën letrare, sinteza e një mendimi estetik (dhe kritik) të një breznie të tërë e, sidomos, një sintezë befasuese prirjesh metafizike dhe pozitiviste të kohës. Studimi i mendimit të tij, krahas studimit të veprës së tij fikcionale, do të jepte në dorë instrumentet mendore jo thjesht për të plotësuar mësimdhënien, por për t'i dhënë një kah transmetimit të dijeve shkencore letrare. Fakti që Fishta është konstituuar si një "univers" dijesh, për kohën e tij nuk ishte diçka e jashtëzakonshme. Shkollat klasike, të cilat sot i quajmë "klerikale", lavronin traditën e moçme që fëmijët, qysh në moshën tetëvjeçare, fillonin të nxenin, për shembull, retorikë. Nuk kishte gjë për t'u habitur që një çunak si Zefi i Ndokës (Gjergj Fishta), në moshën trembëdhjetëvjeçare, të dinte përmendsh Enejdën e Virgjilit, njësoj si seminaristi nxënës i Fishtës të dinte përmendsh Lahutën e tij. Për sistemin formues të atyre shkollave, të nxënët, të studiuarit bëhej natyrë e dytë, shndërrohej në mënyrë të ekzistuari.

Asgjë për t'u habitur, pra, po që se në "universin" e një mendimtari si Fishta, të formuar kësi mënyre, rigjallohen mendimtarë të të gjitha kohëve, duke filluar nga ata të Antikitetit, si Demosten, Platon dhe Aristotel, Ciceron, tek ata të Kohës së mesme, si Averroes, Shën Augustin dhe Albert i Madh, Shën Toma i Akvinit dhe Shën Bonaventura, tek ata të Kohës së re, si Skot, Bossuet, enciklopedistë francezë e racionalistë gjermanë, Rousseau, Taine, Benjamin, Rueb,

Herder, Cantu, Müller, Fornari, Lowth etj.; pa harruar antropologë, si Wirkov, Pittard etj., albanologë, si G. Mayer, G. Schim, N. Jokl, A. Schmaus. Një yjësi e tërë veprash dhe autorësh vërtitet marramendthi në një "univers" të tillë, nga poezia e asiro-babilonasve të Mahabharata dhe Ramayana, nga Shah-Nameja e Firdusiut të poezia e egjiptianëve dhe ajo e hebrejve, nga Kënga e Nibelungëve të Fingali, nga Bibla të Titanomakia e Hesiodit, Ilijada dhe Odisea e Homerit, lirika e Pindarit, tragjeditë e Eskilit dhe ato të Sofokliut, komeditë e Euripidit dhe ato të Aristofanit, idilet e Teokritit, elegjitë e Ovidit, Epistulat e Horacit, Enejda dhe Bukoliket e Virgjilit, Komedia Hyjnore e Dante-s, Libri i këngëve i Petrarca-s, Jerusalemi i liruar i Tasso-s, Satirat e Ariosto-s, epika e sllavëve të jugut, Don Kishoti i Cervantes-it, teatri i Shakespeare-it dhe ai i Calderon-it, Osmani i Gundolicit, Parëzi i bjerun i Milton-it, komeditë e Moliere-it dhe ato të Goldoni-t, esetë e Metastasio-s, Parcivali i Eschilbach-ut, Fausti i Goethe-s, tragjeditë e Monti-t, Homazh për artet e bukura i Schiller-it, Atalaja e Chateaubriand-it, Adelchi dhe Himnet e Shenjta të Manzoni-t, poemat e Lord Byron-it, Përrallë dimri e Heine-s, Kënga e Gjineshtrës e Leopardi-t, Shën Françesku i Ugheti-t, këngët e kleftëve grekë etj. Por edhe vepra të artit e artistë të mëdhenj botërore, nga Akropoli dhe Partenoni të Fori romak, nga Koloseu i Flavit të Shën Pjetri në Vatikan, nga Afërdita e Fidias tek Apoloni i Belvederes i Rafaelit, Katedralja e Reimsit dhe ajo e Këlnit, Notre-Dame-i Parisit dhe Westminster Abbaye e Londrës, Kisha e Shën Palit dhe Duomo i Milanos, Madonnat e Morillo-s dhe harkadat e Bruneleschi-t, skulpturat e Da Vinci-t dhe veprat e Bramante-s, Misererja e Palestrina-s dhe Introitet e Bach-ut, Requiemet e Mozart-it, Meshët e Vaidana-s dhe ato të Heyden-it, Stabat Materi i Rosssini-t, Passioni i Beethoven-it, Parcivali i Wagner-it, I verbëri i Parzanese-s etj. etj., a thua për të në ngulitur në mendje

përftyrimin se krijimet e Artit qenkëshin dyzet ditët e jetës së lumnueshme të Natyrës!

Deri edhe letërkëmbimi i një mendimitari të tillë, prej të cilit kemi trashëguar (deri sot) vetëm atë tufbëz ruajtur xhelozisht në arkivin e fshehtë të mikut të tij intim At P. Dodaj, paraqitet i endur në tituj veprash e emra autorësh, me komente e gjykime, vërejtje e vlerësime, madje me një shpirtë që të vizllon parasysht befasisht: "Bonifaci VIII është kenë papë, por me gjith kta i duhet me ndejë në Férr, s'pakut der ditën e gjygjës, per deri si aty e ka denue perendija i vogel Dante Allighieri"; "Kam pasë dy rasa me e ndie Gentile-n n'nji të pershëm kohe prej dy vjetsh. Thonte pa prā njat send se njat send, qaty se qaty. Nuk di se si, por ia mëshonte mendimit tue zdrypë n'spirale, si me turjelë (a travello), a thue se kje tue birue në mende. Pra, e din nji send, e thue pa prā, deri si aj persritet vetë"; "Ktū në New-York kam ndie tuj ri vjolinist Arturin Kreisler, prej Wienet, sod me sod mā i madhi vjolinist i botës. Kujtoj se i bite tetë herë mā mirë se aj Frati i Planit në vjetë 1918..." etj.

Përqendrimi i një mase të pamatë informacionesh nga fushat e artit dhe të letërsisë, si dhe nga mendimi teorik-estetik botëror, mund të ngjajë sot vështirësisht i përftyrueshëm për një shkrimtar ose artist të formuar në shkollat bashkëkohore. Po të përpiqemi t'i krahasojmë njohuritë e Fishtës me njohuritë e secilit prej nesh, ai mund të na duket si përbindsh. Mund të thuhet me siguri se, për kohën e tij, ai dinte gjithçka ose thuajse gjithçka nga fushat e artit dhe të letërsisë. Ai anglezi (i sipërpërmendur) duhej të kishte nuhatur diçka, kur i shkruante: "Ndoshta Shqipëria e vogël, që deri dje ka pasë mbetur

jashtë "mullirit" të qytetërimit modern, do të arrijë t'ia mësojë Europës rrugën e dijes së vërtetë..."

Është edhe kjo një arsye për të cilën më është dukur e papranueshme, dhe do të vijojë të më duket e tillë, që në strukturat e kurseve të një fakulteti të letrave (a të filozofisë) të mungojnë studimet fishteane. Një kurs i tillë, i studimeve fishteane, do të funksiononte si shtyllë kurrizore në një sistem shkollor me drejtim humanist. Studimet fishteane janë një objekt që nxit, që provokon. Mendimi teorik-estetik i Fishtës të qet probleme që mund t'i kesh kapur me intuitë, por të cilave nuk u ke dhënë dot emër. Zgjidhjet e tij ecin nëpër atë ravë kulturhistorike (ravë kristiane, po deshi kush), nëpër të cilën vijon të çajë kultura moderne europiane. Mendimi estetik (si dhe ai kritik) i përmbledhur në këtë antologji paraqitet kështu si një nga dëshmitë magjepsëse të atij mendimtari të madh shqiptar, njërit prej më të mëdhenjve që kultura jonë ndonjëherë ka pasur.

Botimi (dhe ribotimi) i këtij mendimi bëhet sot kusht i domosdoshëm për rishtënien në dorë të vlerave të fshehura ose të huajsuara prej kulturës sonë. Në këtë kuptim, në mjedisin tonë kulturor, ku për çdo botim a ribotim libreci flitet si për "ngjarje të rëndësishme", botimi i këtij mendimi do ta përbëjë, më së paku, një ngjarje. Nuk e di cili është intervali i botimit dhe ribotimit të veprave të mira, ngase ato të tjerat ribotohen papra ("q'aty se q'aty"), derisa përsëriten vetiu.

GJURMË KULTURORE

RRËFANË E MUZIKOLOGJISË SHQIPTARE - LORENC ANTONI

Mr. Alma BEJTULLAHU

Sivjet mbushen pesëmbëdhjetë vite nga vdejka e njërit ndër themeluesit e muzikës artistike në Kosovë, Lorenc Antonit (1909–1991). Me veprimtarinë tij që përfshin pedagogjinë muzikore, dirigjimin, komponimin dhe gjurmimet e mbledhjen e folklorit muzikor në trojet shqiptare, ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në muzikën dhe kulturën shqiptare në Jugosllavinë e dikurshme dhe njëkohësisht ka lënë ndikim në brezat e muzicentëve që vijuan.

Jetëshkrimi

Lorenc Antoni u lind në Shkup, më 23. shtator 1909 në një familje zejtarësh (arpunues), që shquhej me praktikë muzikore. I ati i tij Gjoni luante në klarinet dhe përcillte këndimet familjare; kështu Lorenci i pati kontaktet e para me muzikën pikërisht në gjirin familjar, duke mësuar shumë këngë edhe nga e ëma e tij, Lezja. Këto fille muzikore, siç do të shohim edhe në vazhdim, e vulosën krijimtarinë e tij të mëvonshme.

Në Shkup Antoni ndoqi shkollën fillore dhe gjimnazin. Gjatë viteve rinore u kyç në aktivitetet që zhvilloheshin pranë të Kishës katolike në Shkup. Përveç shkollës fillore në gjuhën shqipe (që u hap më 1919 në ndërtesën e Kishës katolike në Shkup) vepronte edhe shoqëria kulturore, të cilës pas një kohe iu bashkangjit edhe kori i gjimnazistëve gjegjësisht kori i përzier. Udhëheqja e koreve iu besua Lorencit, i cili e

kreu detyrën e dirigjentit derisa pushteti në Jugosllavinë e paraluftës nuk e ndaloi përdorimin publik të gjuhës shqipe dhe maqedone rreth vitetve 1929–1930 (Antoni 1984: 1).

Gjatë viteve të tridhjeta të shekullit të kaluar, Lorenc Antoni udhëhoqi disa trupa instrumentale: orkestrën e tamburinave të shkollës së mesme teknike në Shkup si dhe orkestrën e madolinave të shoqërisë së skautëve, e pos këtyrë për një kohë të shkurtër e udhëhoqi edhe korin e meshkujve të organizatës sindikale.

Fillimi i luftës së dytë botërore e gjeti Lorencin dhe familjen e tij në Shkup. Së shpejti (më 1941) kaloi në Ferizaj, ku punoi një vit si drejtor në shkollën fillore në Ferizaj dhe e udhëhoqi korin e shkollës. Më pas punoi si mësimdhënës për një semestër në gjimnazin e Prishtinës. Më 1942 kaloi në Prizren, ku punoi në liceun e Prizrenit si dhe e udhëhoqi korin e përzier të qytetit të Prizrenit. Në këtë qytet, »padyshim, qytet i muzikës« (si shprehej shpesh Lorenci) mbeti edhe pas përfundimit të luftës së dytë botërore dhe u kyç në organizimin e jetës kulturore të qytetit. Një ndër periudhat më intensive i kaloi me shoqërinë »Agimi«, ku u angazhua si dirigjent. Fillet e shoqërisë datojnë nga fundviti 1944, më 1945 Lorenc Antoni e merr përsipër programin muzikor të shoqërisë. Pos veprimtarisë së »Agimit«, u angazhua edhe në fushën e pedagogjisë si mësimdhënës i lëndëve muzikore. Kështu pas luftës së dytë botërore (më 1948) punoi për themelimin e shkollës së muzikës, së pari në nivelin fillor e pastaj, më 1949 e themeloi edhe shkollën e mesme të muzikës (Antoni 1984:17). Që të dyjat kanë luajtur një rol kyç në krijimin e kuadrove të reja muzikore, të cilat përndryshe mungonin shumë në Kosovën e pasluftës. Ekzistenca e një shkolle të tillë e ngriti dukshëm nivelin e muzikës dhe profesionalizmit muzikor dhe hapi rrugë për projekte të tjera të rëndësishme. Pikërisht me këtë shkollë, e

cila sot mban emrin e Lorenc Antonit, filloi të zhvillohet edhe muzika artistike në Kosovë.

Deri në vitin 1956, Antoni punoi intenzivisht me korin e »Agimit«, duke mbajtur prova të përditshme dhe njëkohësisht duke krijuar edhe vepra korale për nevoja të korit. Kori ka arritur suksese të mëdha, ngase mori pjesë në koncerte të shumta[†] dhe çfaqje jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë saj (Antoni 1984:2). Pos kësaj Antoni ishte aktiv në shkollën e muzikës, ku për vite të tëra ishte drejtor i shkollës, mësimdhënës e poashtu edhe dirigjent i korit të shkollës.

Më 1956, kur Radio Kosova u bart në Prishtinë, Antoni mori detyrën e redaktorit të muzikës popullore e përveç kësaj e udhëhoqi korin e radio Prishtinës për disa vite me rradhë. Në Prishtinë komponoi disa nga veprat e fazës së pjekur, këngë korale si dhe vepra për orkestrin simfonik. Pos kësaj ka mbledhur në terren edhe muzikën popullore të viseve të ndryshme në Kosovë dhe më gjerë.

Antoni vazhdoi të punojë në Radio Prishtinë deri sa nuk u pensionua në fillim të viteve të tetëdhjeta. Njëkohësisht vazhdoi të punojë si kopozitor, me ç'rast publikoi komponime të shumta për kor dhe orkestër; poashtu edhe vazhdojë të gjurmojë folklorin muzikore shqiptar, duke publikuar veprën voluminoze Folklori muzikor shqiptar (në shtatë blej) si dhe artikuj të shumtë shkencor etnomuzikologjik.

Pas pensionimit, gjatë viteve të tetëdhjeta u tërhoq gradualisht nga jeta publike muzikore dhe iu përkushtua rregullimit të dokumentacioneve të tij. Deri në fund të jetës qëndroi në Prishtinë, ku edhe vdiq më 21. tetor 1991, në moshën 82 vjeçare.

[†] Antoni përmend se prej 1945 e deri më 1956 janë dhënë rreth 420 koncerte (Antoni 1984:3)

gjurmimet etnomuzikologjike

Interesimi i Antonit për folklorin muzikor është i dyfishtë. Së pari, folklori ishte njëra nga mënyrat e shprehjes së krijimtarisë muzikore. Në veprat e tij muzika burimore shqipe është gjithnjë e pranishme si një burim prej nga kompozitori ka nxjerrë material muzikor, qoftë në formë të temave muzikore, qoftë në mënyrën e strukturimit të komponimit. Së dyti, Antoni iu përkushtua gjurmimit të folklorit edhe profesionalisht, duke mbledhur material muzikor në viset e ndryshme të ish-Jugosllavisë, ku jetonin shqiptarët.

Antoni filloi të mbledhë folklorin muzikor në vitet e dyzeta të shekullit të kaluar dhe kjo veprimtari shënon fillet e vjeljes sistematike të folklorit muzikor në Kosovë dhe vendet ku jetonin shqiptarët. Analizat dhe shqyrtimet e para të këtij materiali i botoi në periodikën kulturore-shkencore si *Jeta e re*, Buletini i Muzeut të Kosovës dhe *Përparimi*.

Pas disa viteve, më 1956, e botoi përmbledhjen e parë të transkribcioneve të këngëve popullore me titull *Folklori muzikor shqiptar*, ku i ka përfshirë 105 këngë popullore nga Shkupi, Ferizaji, Prizreni dhe Gjakova me rrethinë. Përmbledhja është pajisur me parathënie dhe analiza të ndryshme të materialit të vjelur. Kjo përmbledhje qe përmbledhja e parë sistematike me folklorin muzikor shqiptar nga ish-Jugosllavia pas të cilës pasuan edhe gjashtë përmbledhje të tjera. Bleni i dytë i kësaj serie u botua më 1961 dhe përfshinte 106 këngë, shumica syresh të vjelura gjatë ekspeditës hulumtuese në Opojë të Kosovës dhe Ulqin (Mal i Zi). Blejt e mëtejshëm kanë vazhduar të sjellin këngë popullore nga të gjitha viset e banuar me shqiptarë, të mbledhura për decenie me rradhë. Bleni i

tretë (1964) solli 110 këngë, pjesa më e madhe e të cilave ishin të vjelura në Maqedoni (në Shkup, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër, Strugë, Prespë, Kumanovë). Bleni i katërt u botua më 1970 dhe solli 112 këngë të mbledhura gjatë periudhave të ndryshme, shumica prej tyre nga rrethi i Kamenicës së atëhershme; ndërkaq bleni i ardhshëm, ai i pesti (1972), përmbledh 122 këngë të periudhave dhe viseve të ndryshme. Dy blejt e fundit u botuan më 1974 dhe 1977. Në mesin e 122 këngëve të blenit të gjashtë u gjendën edhe disa këngë shumëzërëshe, këngë heterofonike, këngë dyzërëshe (bifonike). Bleni i shtatë solli 93 këngë të viseve të ndryshme me strukturë të ngjashme me blenin paraprak[§].

Të gjitha blenet sjellin, përveç transkribimeve të këngëve në nota, të dhënat e autorit për punën në teren, analizat e këngëve sipas parametrave melodikë, metrik dhe gjeografik, e poashtu edhe disa nga konkluzat e e tij shkencore, të cilat i ka zgjeruar edhe në punimet e ndryshme të botuara në disa revista shkencore (shih bibliografinë në fund të artikullit). Në blejt e fundit ka shtuar edhe vërejtjet e veta mbi strukturën e këngëve dhe ndikimin që bie në sy në këngë.

Teknika e punës në teren, të cilën e përdori Antoni bazohej në të kënduarit e informatorit dhe transkribimit në bazë të këndimit (bleni i parë) si dhe metodën e inçizimit të këngëve në shirit magnetofoni dhe transkribimin në bazë të inçizimeve (të gjithë blejt tjerë). Në disa raste Antoni i ka vizituar vetë terrenet në fjalë, por mjaft shpesh edhe i ka inçizuar këngëtarët që vinin në Prishtinë, e me të cilët kishte rënë në

[§] Sipas dëshimsë së Antonit, pas botimit të blenit të shtatë të »Folklorit muzikor shqiptar«, kishte filluar të përgadisë materialin për botimin e blenit të tetë. Ndërkaq shtëpia botuese »Rilindja« e refuzoi këtë propozim, me arsyetimin se nuk merret me botime muzikore, duke mos marrë parasyh vlerën antologjike kulturore dhe kombëtare të përmbledhjes. Materiali mbet i pabotuar dhe tani konsiderohet i zhdukur.

kontakt rastësisht. Inçizimet e bëra (të ruajtura asokohe në arkivën e ish-Radio Prishtinës dhe në arkivën personale të autorit) deri më sot nuk janë publikuara në formë të fonogramit (si kasetë apo CD) dhe vendndodhja e tyre tash nuk dihet.

Artikujt shkencorë etnomuzikologjikë të Antonit sheshojnë disa tema: muzikën vokale, veglat muzikore popullore dhe vallet popullore.

Analiza e muzikës popullore vokale zë vendin kryesor të interesimit shkencor të Antonit. Një pjesë e këtyre artikujve merret me mënyrat specifike të të kënduarit (teknika vokale), karakteristike për disa zona gjeografike, ku autori paraqet tezën se në këto zona – për shkak të konfiguracionit të terrenit – janë ruajtur mënyrat e vjetra të këndimit dhe shpreh angazhimin për ruajtjen e këtyre këngëve, duke cekur zonën e jugut të Kosovës dhe Maqedonisë jugpërendimore². Pos kësaj është marrë edhe me klasifikimin e repertoarit në baza të gjinisë, pra e analizon repertoarin tipik të grave apo të burrave.

Veglat muzikore të popullit janë poashtu temë e artikujve të Antonit, qoftë si pasqyrë e përgjithshme e instrumenteve (Antoni 1950–1951) qoftë si studim i një instrumenti, si psh. çiftelia apo lahuta (Antoni 1961). Mendimi themelore në analizën e instrumenteve është hipoteza mbi historinë dhe lashtësinë e këtyre instrumenteve.

Artikulli mbi vallen popullore të familjet katolike të Prizrenit, të quajtur *kalagjojne*, merret me përshkrimin e kësaj valle të vjetër dasmore, duke përfshirë figurat e valles me renditje, shtrirjen gjeografike dhe përcjelljen muzikore (Antoni 1958).

² Pas Antonit, hulumtimet e terrenit në Maqedoni ishin shumë të pakta, ngase bashkëpunëtorët e Instituti Albanologjik, për shkaqe të ndryshme, nuk mundën t'a vazhdojnë vjeljen në terren.

Të gjitha këto na bëjnë me dije se Antoni si etnomuzikolog është angazhuar për gjetjen e formave të vjetra të muzikës popullore shqiptare. Kjo qasje është e përhapur tek etnomuzikologët evropianë që e studiojnë muzikën e tyre popullore dhe ka për motiv kryesor ruajtjen e mënyrave sa më të vjetra të muzikimit popullor. Në këtë aspekt, Antoni ka punuar shumë: ka inçizuar dhe dokumentuar shumë këngë, ndërkaq vjeljen e ka bërë në mënyrë ekstensive, me ç'rast ka fituar shembuj të nduarnduarshëm të zonave të ndryshme. Pos kësaj ka luajtur rol të rëndësishëm në konservimin e këngëve më të rralla të viseve të padepërtueshme, duke pasur parasyh se pas një kohë ato mund të zhduken. Kjo vlen sidomos për zonat ku kultivohen trajtat rudimentare të shumëzëshmërisë, si këndimet heterofonike nga Opoja dhe këndimet bifonike (nga Tetova, Kërçova e Gostivari). Pos kësaj Antoni i ka analizuar edhe çfaqjet e reja në folklorin muzikor si zgjerimin e këndimit njëzërësh, apo pakësimin e të luajturit në lahutë dhe shtimin e të luajturit në çifteli.

Në bazë të këngëve të mbledhura, Antoni ka përdorë analizën si pjesë të pandashme të punës së tij kërkimore-shkencore. Muzikën e ka analizuar në bazë të parametrave të strukturës muzikore si melodika dhe moduset tonale, metrumi dhe ritmi e tempo, me anë të të cilëve i ka përcaktuar disa karakteristika kryesore të muzikës popullore. Midis tjerash, në këtë mënyrë e përcakton kronologjinë e shkallëve tonale nga më i vjetri – i patemperuar e moduset e deri te shkallët orientale. Pos kësaj shpesh i ka adresuar edhe rrethant shoqërore që kanë ndikuar në krijimin apo interpretimin e këngës popullore. Midis të tjerash e ka lidhur çështjen e migrimit me lidhjen e këngëve funksionale (të gurbetit) apo, në rastin tjetër, këndimin e malësorëve në regjistra të lartë (këngë majekrahi) si funksion signalizimi.

Lidhja e muzikës popullore me kushtet që janë pjesë e jetës së njeriut – këngëtarit popullor në punimet e Antonit kanë hapur rrugë për hulumtime të gjera, të cilat ende vazhdojnë nga pasardhësit e tij.

ndikimi i folklorit në krijimtarinë e Antonit^{††}

Ndikimi i folklorit muzikor në veprat e Lorenc Antonit mund të vërehet në mënyra të ndryshme. Nëse analizohet struktura muzikore në komponimet e tij, vërehet mbizotërimi i melodikës popullore. Përveç parametrin melodik, ndikimi i folklorit është i pranishëm edhe në shtresimin e shumëzëshmërisë, harmonisë dhe ritmit.

Elementi melodik, i cili mbizotëron, është tregues i filozofisë së kompozitorit. Melodia – qoftë e popullit, qoftë e autorit – është mjete vendimtar muzikor, i cili e kushtëzon formën muzikore.

Në shumicën e rasteve melodia nuk mbetet e ngurtësuar. Antoni i përdorë motivet nga melodia për zhvillimin muzikor. Kompozitori e bazon ndërtimin muzikor në tensionet midis tonalitetëve të ndryshme, shpesh edhe të kundërta, duke u bazuar në analizat e përfituara nga studimi i folklorit muzikor. Pikërisht me këtë qasje ai ka tentuar edhe t'ia afrojë muzikën publikut, i cili, i mësuar me muzikën popullore, ishte në gjendje t'a pranojë këtë formë të muzikës artistike. Sa i përket zërave që e përcjellin melodinë, kompozitori i përpunon ata në mënyrë të pavarur me anë të teknikave të ndryshme.

^{††} Ky kapitull, si dhe kapitulli i ardhshëm »Komponimet e Lorenc Antonit«, bazohet në rezultatet e analizës së paraqitur në punimin e diplomës »Transpozicija folklornega gradiva v vokalnih in instrumentalnih skladbah Lorenca Antonija« (Transpozicioni i materialit folklorik në komponimet vokale dhe instrumentale të Lorenc Antonit).

Puna me motive është e thjeshtë, ndryshimet në motiv janë të vogla, kryesisht ndryshohet ritmi apo intervalet e motivit. Kjo lidhet me faktin se as muzika popullore nuk e njih punën motivike në atë masë sa muzika artistike (klasike). Përderisa në muzikën korale Antoni krijon edhe kontramelodi në zërat përcjellës në krahasim me vijën melodike, në muzikën orkestrale mbizotëron përcjellja homofonike kundrejt melodisë.

komponimet e Lorenc Antonit

Komponimet e para të Antonit janë të lidhura me punën e tij si dirigjent. Përkitazi me këtë, ai shpesh pohonte se filloi të kompononte pikërisht për shkak të mungesës së literaturës së përshtatshme për kore dhe ansamble instrumentale, të cilat i udhëhiqte.

Si komponimi i tij i parë njihet kënga »Në breg të liqenit« (në fillim të janarit 1927) në tekst të Hil Mosit. Sikurse ndodh shpesh, fillet e krijimtarisë qenë rezultat i rrethanave të rastësishme, midis tyre ishte edhe vrulli rinor i Lorencit (atëherë 16-17 vjeç), aktivitetet e korit dhe zëri i bukur i Gonxhes, kushërirës së tij[#]. Kështu edhe lindi ky komponim, të cilin e kënduan motrat Gonxhe (Nëna Terezë) dhe Age Bojaxhiu në një çfaqje bëmirëse të Kishës katolike në Shkup më 25. mars 1928 dhe pastaj edhe më 8. prill po të njëjtin vit (Antoni 1984:5).

Si u përmend, komponimet e para janë këngë vokale, që datojnë nga fundi i viteve të njëzeta të shekullit të kaluar. Gjatë kësaj faze fillestare që zgjati deri në themelimin e shoqërisë »Agimi«, Antoni komponoi

[#] Motrat Bojaxhiu kishin farefisni me familjen Antoni: Nikolla (babai i tyre) e kishte motrën e quajtur Maria, e cila ishte gjyshja e Lorencit. Lorenci shpesh e ka përmendur angazhimet e pamohueshme të Gonxhes së re në aktivitete e rinisë katolike në Shkup.

disa këngë njëzërëshe, të cilat i interpretonin në çfaqjet e rinisë katolike në Shkup. Pos këtyre harmonizoi edhe disa këngë popullore, të cilat i interpretonin koret në shkup si dhe koret në Ferizaj dhe Prizren gjatë luftës së dytë botërore, si dhe pjesë instrumentale, nga të cilat përmenden »Andante mallëngjimi« për orkestrën e tamburinave dhe harmonizimi i një vepre të Nerudës.

Antoni pohonte se me krijimin e korit të shoqërisë »Agimi« edhe krijimtaria e tij mori hov të madh. Në të vërtetë, fillimin e fazës kryesore të Antonit, e shënojnë komponimet korale. Pikënisje e procesit krijues ishin meloditë e dhe trajtat dhe harmonitë e këngëve popullore. Autori e spjegonte motivin e tij për një qasje të tillë me faktin se midis muzikës së begatshme të popullit, që mbizotëronte në Kosovë dhe traditës së muzikës klasike botërore, të cilën e synonte me korin, ishte një dallim i madh. Prandaj mendonte se muzikën artistike duhet afruar popullit në mënyrë sa më graduale. Kështu Antoni filloi të shkruante vepra në frymën e muzikës popullore, të cilat më vonë gradualisht do t'i afroreshin muzikës klasike.

Gjatë viteve 1945-1960 Antoni krijoi vepra korale, kryesisht për kor të përzier. Pas një kohe filloi edhe t'i botojë dhe kështu dolën dy përmbledhjet e para autoriale të tij, »Koret shqiptare« (1957) dhe »Jehona të zemrës« (1958)⁶⁶.

Përmbledhja me këngë korale »Kore shqiptare« i përfshin katër komponime për kor katërzërësh të përzier: »Mirë mbrama«, »Kënga e Rexhës«, »Shkojti çika« dhe »Hajde dalim kah pazari«. Shumica e

⁶⁶ Komponimet janë boatuar nga botues të ndryshëm si p.sh. Lidhja Krahinore e Shoqërive Muzikore (Prishtinë), Lidhja e Kompozitorëve të Serbisë (Beograd), më vonë edhe kori Collegium Cantorum (Prishtinë) dhe Shoqata e Kompozitorëve të Kosovës.

këtyre komponimeve bazohen në vijën melodike, e cila paraqet bazohet në melodinë popullore. Kjo melodi përdoret e pandryshuar.

Ndërkaq në veprën »Shkojti çika« autori është larguar nga përdorimi i pandryshuar i vijës melodike. Duke u nisur nga vetëm disa motive popullore ka përdorë punë motivike dhe e ka strukturuar komponimin në mënyrë të avansuar.

Në këtë përmbledhje vlen të përmendet edhe »Kënga e Rexhës«, këngë e bazuar në këngën popullore të vajtimit. Komponimi bazohet në modusin eolik, pra autori këtu largohet nga shkalla orientale, ndërkaq fuqia e komponimit qëndron në gradacionin muzikor: me hyrjen graduale të secilit zë dhe me shtimin e toneve kromatike. Kështu krijohen treqinguj (akorde) që e mjegullojnë tonalitetin mol. Si pasojë, kompozitori e rrit shqetësimin dhe e thekson karakterim vajtues të tekstit.

Edhe komponimi »Hajde dalim kah pazari« paraqet inovacionin e kompozitorit, i cili eksperimenton me bimodalitetin, gjë që është – në krahasim me komponimet tjera – një përparim në aspekt të kërkimit të tonalitetit.

Ca vite pas largimit nga Prizreni u botua edhe përmbledhja e dytë »Jehona të zemrës«, e cila përfshin gjashtë komponime për kor katërzërësh të përzier: »Çorapët e burrit«, »Hasimja trime«, »Lan vasha«, »Na ka dalë nusja e mirë«, »Po vijnë krushqit maleve« dhe »Ç'janë këta krushq që vijnë«.

»Çorapët e burrit« është njëri ndër komponimet më të popullarizuara të Lorenc Antonit, i cili gjendet shpesh në repertoaret korale shqiptare. Ky komponim nuk bazohet në ndonjë melodi definitive popullore, por e përdorë tekstin popullor në mënyrë të lirë dhe në bazë të tij sajton melodi të komponuar. Komponimi sjell invencione në punën motivike,

ku autori përdorë mënyra të ndryshme (inverzionin, shumëzshmërinë etj.) duke sajuar një komponim me kontrastime bafasuese të tempos. Pesë komponimet tjera, me disa shtesa apo ndryshime sjellin melodinë popullore, të cilën autori e përpunon në mënyra të ndryshme. Midis tyre veçohet komponimi (për kor dhe dy soliste, sopran dhe tenor) »Hasimja trime«, i cili bazohet në këngën e njohur popullore mbi një ngjarje të vërtetë në Kosovë, të lidhur me gjakmarrjen dhe besnikërinë e motrës. Veçori e komponimit, është përdorimi i mjeteve muzikore (motivet ostinante, efektet e disonancës) me të cilin kompozitori e thekson tematikën tragjike të tekstit.

Gjatë viteve të gjashtëdhjeta, Lorenc Antoni ka publikuar edhe disa përmbledhje. Më 1961 doli në dritë suita korale »Opojanja« me pesë komponime për kor të përzier: »Sugare«, »Piki molla e kuqe«, »E morën Fatimen«, »Gji ma paske ballin« dhe »Ka ra dilli«. Këto komponime janë të lidhura në formë suite ashtu që koda (pjesa përfundimtare) e njërit komponim lidhet me fillin e komponimit tjetër. Tonalitete e komponimeve bazohen në shkallë të ndryshme (nga ajo eolike e deri te makami hixhas) në melodi dhe poashtu krijojnë bimodalitet në strukturën harmonike. Kësaj i përgjigjet edhe kombinimi i metrumit nga 2/4 (si metrum i thjeshtë popullor) në 7/8 (metrumi karakteristik për meloditë popullore në makam). Suita shënon edhe një hap të mëtejshëm në zhvillimin e kompozitorit, pasi që nga tema melodike tani fokusohet në shtjellimin e motiveve në zërat e ndryshme duke përdorur elementet e heterofonisë ashtu si i përdorë populli në Opojë. Këto elemente të dyzëshmërisë i ka zgjeruar në formacionin katërzërësh. Në rastin kur e shtjellon materialin në mënyrë lineare, mbështetet në heterofoni dhe procedura të polifonisë si dhe në bimodalitet (të vijave melodike). Më 1971 doli në dritë edhe një

përmbledhje e Lorenc Antonit me këngë korale për kor katërzërësh femëror me titull »Tri këngë nga Opoja«. Mirëpo ka gjasa që këto komponime të jenë krijuar më herët. Këto vepra bazohen në këngët nga Opoja prej nga edhe i kanë marrë respektivisht titujt »Ani çilma derën«, »Oj lulija jonë« dhe »O lum e lum«. Autori melodisë së cituar i ka shtuar përcjellje të zërave duke u bazuar në harmonitë popullore. Në mesin e komponimeve korale hyjnë edhe komponimet për kor të fëmijëve, të cilat Antoni i ka komponuar që nga vitet e dyzeta në tekste të ndryshme humoristike. Këto janë botuar në formë përmbledhjesh »Trumcakët e Kosovës« dhe »Një gafore defatore«. Pos këtyre veprave, Antoni ka komponuar gjatë viteve të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar edhe njëzet e pesë këngë korale kishtare, të cilat atëbotë i nënshkroi me pseudonimet C. I., Nercol Panivoda, Jeronim Gustoni (Gashi 1994). Këto këngë i krijoi me nismën e Don Zef Gashit, atëherë famullitar në Prishtinë. Këto këngë i mbajnë tekste e autorëve të ndryshëm: don Simon Filipaj, don Lush Gjergji, P. Hil Kabashi, Don Zef Gashi e Engjël Kengji apo edhe tekste nga meshari. Përmbledhja e këtyre këngëve të Lorencit së bashku me ato të kompozitorit Viçenc Gjinit u botuan më 1994 me titullin »Libër këngësh korale kishtare«. Në mesin e tyre mbizotërojnë kryesisht këngët katërzërëshe (disa nga ato i ka harmonizuar Vinçenc Gjini) apo edhe njëzërëshe me përcjellje të orgjeve.

Përveç veprave kryekëput korale, Antoni ka shkruar edhe komponime vokale-instrumentale apo instrumentale. Shumë prej komponimeve vokale-instrumentale janë inçizuar dhe emituar në valët e radios. Disa nga ato komponime janë edhe sot të popullarizuar, posaçërisht »Nën një mal« dhe »Valle e këngë dasme« të cilat i interpreton solistja e mirënjohur Nexhmije Pagarsuha apo »bilbili i Kosovës«.

Në mesin e veprave instrumentale janë Rapsodia shqiptare nr. 1, »Malësorja«, »Në Prizrenin e vjetër«, »Na ka dalë nusja e mirë«, »Valle e këngë dasme« (e cila siç u përmend ka edhe pjesë vokale për kor dhe sopran solo), »Në Prizrenin e bukur« (këto pesë komponime janë botuar në përmbledhjen »Pesë vepra muzikore«) si dhe shumë vepra për grupe më të vogla vokale-instrumentale (për orkestra mandolinash apo tamburinash dhe kore), të botuara në formë ekstraktesh, në mesin e të cilëve numërohen edhe Rapsodia shqiptare nr. 2, nr. 3 e nr. 4 për orkestër tamburinash.

Rapsodia shqiptare nr. 1 është komponim për orkestër kamertal dhe daton nga viti 1961. Vepra, si thotë edhe vetë emri është rapsodí, pra përbëhet nga pjesë të shumta, të cilat nuk janë motivisht të lidhura në mes veti. Secila nga dhjetë pjesët e kësaj rapsodie, karakterizohet me tempo, tonalitet apo me karakter të veçantë. Ky komponim është karakteristik edhe për shkak të përdorimit të instrumenteve klasike muzikore në mënyrë që të tingëllojnë sikur instrumentet popullore çifteli e gajde, pos kësaj partitura përfshin edhe përdorimin e defit, dhe tarabukës.

Përmbledhja »Pesë vepra muzikore« e cila u botua më 1975, përfshin pesë komponime të krijuara gjatë viteve pesëdhjetë dhe gjashtëdhjetë të shekullit të njëzetë dhe paraqesin tablo nga jeta kosovare.

Ndër këto komponime veçohet pjesa »Në Prizrenin e vjetër«, me të cilin autori e portreton atmosferën e qytetit të Prizrenit. Komponimi shquhet me vijën solistike të klarinetit në shkallën orientale dhe ritëm të sinkopuar, gjë që i jep komponimit një karakter të posaçëm. Ky është njëri ndër komponimet më të njohura orkestrale të Antonit, i cili është koreografuar dhe interpretuar gjatë viteve të tetëdhjeta edhe nga trupa e baletit pranë Teatrit të Prishtinës.

rëndësia e Lorenc Antonit në kulturën kosovare

Si u përmend edhe më parë, Antoni (ndonëse ishte autdidakt dhe nuk ka kryer ndonjë akademi të muzikës) ishte njëri ndër personat përgjegjës që e themeluan sistemin e shkollimit muzikore në Kosovë, poashtu edhe sistemin e shoqërive gjysmëprofesionale muzikore si dhe arkivimin e folklorit muzikor shqiptar. Rezultate e punës vetëm e vërtetojnë faktin se ai ishte një profesionist i mirëfilltë i muzikës. Ai i zhvilloi aktivitetet e tij në një periudhë të vështirë, mënjëherë pas përfundimit të luftës së dytë botërore në Kosovën tejet të varfëruar. Këto të arritura të Lorenc Antonit janë, mu për shkak të rrethanave të tilla, shumë të rëndësishme dhe po të mos ishin ndërmarrë këto hapa në atë kohë, shqiptarët do të duhej të pritnin ndoshta shumë më gjatë për themelimin e institucioneve kryesore kulturore (mos të harrojmë periudhën negative për shqiptarët, e cila u çfaq viteve të pesëdhjeta dhe në fillim të viteve të gjashtëdhjeta në Kosovë).

Kontributi i Antonit në shkencën etnomuzikologjike, e cila me të i filloi hapat e parë, është poashtu shumë i madh. Kësisoj ai i vuri themelet e transkribimit të këngëve popullore, si dhe i vuri bazat e metodave të hulumtimit në terren. Me mbledhjen e parë të folklorit që nga vitet e dyzeta e edhe më herët, i siguroi etnomuzikologjisë kosovare një punë të pandërprere dhe një vend të denjë në mesin e popujve evropianë. Puna e tij në blejt e «Folklorit muzikor shqiptar» ende nuk është kryer dhe pret të vazhdohet edhe nga gjeneratat pasardhëse të etnomuzikologëve në formë të përmbledhjeve të këngëve dhe muzikës popullore.

SHTOJCË

Veprat e Lorenc Antonit

Sipas një evidence të vetë Lorenc Antonit, ai ka komponuar komponimet si vijon:

Pesë Rapsodi, një suitë, 11 valle simfonike dhe pjesë tjera, një vepër vokale-instrumentale, pesëdhjetë stilizime dhe përpunime këngësh për solistë, kore dhe orkestra kamertale si dhe njëzet e pesë këngë e valle në frymën popullore (Antoni 1984:8).

Vepra vokale:

Kore shqiptare (1957), përfshin komponimet për kor të përzier »Mirë mbrama«, »Kënga e Rexhës«, »Shkojti çika« dhe »Hajde dalim kah pazari«.

Jehonat e zemrës (1959), përfshin komponimet për kor të përzier »Lan vasha«, »Çorapet e burrit«, »Hasimja trime«, »Na ka dalë nusja e mirë«, »Po vijnë krushqit« dhe »Ç'janë këta krushq që po vijnë«.

Oj sugare, (1961), përfshin komponimet për kor të përzier »Piki molla prej kalajes«, »E morën Fatimen«, »Gji ma paske ballin«, »Ka ra dilli zid m'zid«.

Tri kangë nga Opoja (1971), suitë korale për kor femrash, përfshin komponimet »Ani çilma derën«, »Oj lulija jonë« dhe »Oj, lum e lum«.

Në shendin Ulqinak (1980), përfshin komponimet për kor të përzier »Tramabilat plot me krushq«, »Of, Xhemile, Xhemile, moj«, »Sheg' e ambël«, »Ti m'nj fik-e« dhe »Ku m'je nis' ku don me shkue«.

»Skënderbeu ngadhnjimtari« (1971), për kor të përzier, teksti Enver Gjerqeku.

Trumcakët e Kosovës (1971), njëzet këngë për kor fëmijësh një, dy apo trezërësh.

Një gafore defatore (1974), pesë këngë për kor fëmijësh katërzërësh.

Vepra orkestrale:

»Rapsodi shqiptare« Nr. 1 (1961), për orkestër simfonik.

»Rapsodi shqiptare« Nr. 2 (1965), për orkestër tamburinash.

»Rapsodi shqiptare« Nr. 3 (?), për orkestër tamburinash.

»Rapsodi shqiptare« Nr. 4 (viti 1973), për orkestër tamburinash.

Pesë vepra muzikore (1975), përfshin pesë komponime instrumentale dhe vokale-instrumentale: »Malësorja«, »Në Prizrenin e vjetër«, »Na ka dalë nusja e mirë«, »Valle e këngë dasme«, »Në Prizrenin e bukur«.

Vepra për kor dhe orkestër:

Pesë këngë popullore (1966), përfshijnë komponime për kor të përzier dhe orkestër të vogël: »Of, Xhemile«, »Oj Sugare«, »Ti me një fik«, »Rreth e rreth në gurit« dhe »Edhe të këndojmë«.

»Xhamadanin me shirita« (196?), komponim për kor të përzier dhe orkestër.

»Hajde Xhylynaze« (196?), për kor të përzier dhe orkestër

»Nën një mal« (?), komponim për sopran (solo), tenor (solo), bas (solo), kor të përzier dhe orkestër

Bibliografia:

Foklori muzikor shqiptar, bleni 1, Shtëpia Botuese Milladin Popoviq, Prishtinë, 1956.

Foklori muzikor shqiptar, bleni 2, Rilindja, Prishtinë, 1961.

- Foklori muzikor shqiptar, bleni 3, Rilindja, Prishtinë, 1964.
Foklori muzikor shqiptar, bleni 4, Rilindja, Prishtinë, 1970.
Foklori muzikor shqiptar, bleni 5, Rilindja, Prishtinë, 1972.
Foklori muzikor shqiptar, bleni 6, Rilindja, Prishtinë, 1974.
Foklori muzikor shqiptar, bleni 7, Rilindja, Prishtinë, 1977.

Artikujt shkencorë:

- Foklori muzikuer në Kosovë e Metohi, Jeta e re, I* (1949) nr. 1, fq. 20–24 .
Format dhe veglat muzikore të popullit shqiptar, Jeta e re, II (1950) nr. 5–6, str. 351–357;
Format dhe veglat muzikore të popullit shqiptar II, Jeta e re, III (1951) nr.1–2, str. 44–47.
O šaljivoj lirskoj poeziji kod Šiptara na Kosovu i Metohiji, Glasnik Muzeja Kosova, I (1956) fq. 301–309.
Kaladojne, Glasnik Muzeja Kosova, III (1958) fq. 245–267.
Këndimi populluer, Përparimi, V (1959) nr. 9, fq. 596–608 dhe me titullin *Narodno pevanje kod Šiptara, Zvuk, 56* (1960), nr. 8 – 19.
Çitelija, Përparimi, VII (1961) nr. 10, fq. 696–705.
Dy mënyra të vjetra të kënduemit populluer të shqiptarëve në Mal të Zi, Përparimi, VII (1961) nr. 7–8, fq. 532–535.
Metrički oblici u Šiptarskoj narodnoj muzici, Zvuk 59 (1963), fq. 481–493.
Osnovne karakterstike šiptarskog muzičkog folklora v Kosovu i Metohiji, Rad XIV Kongresa Saveza folklorista Jugoslavije u Prizrenu 1967, Beograd 1974, fq. 109–122.
Trajtat polifonike të muzikës vokale të gegëve në Jugosllavi, Elementet polifonike në muzikën popullore të Opojës, Gjurmime albanologjike – Folklor dhe etnologji II (1972), Prishtinë, 1973, fq. 121–130 in 131–134.
Artikujt janë botuar më titullin e përbashkët *Polifoni oblici u*

vokalnoj muzici Albanaca Gegë u Jugoslaviji, në *Zvuk* (1975) 1, fq. 20–34.

Mbi disa dukuri dhe mënyra të kënduarit të këngëve popullore të përfshira në blejt I–VI të »Folklorit muzikor shqiptar«, **Gjurmime albanologjike – Folklor dhe etnologji**, V (1975), Prishtinë, 1975, fq. 119–143.

LITERATURA:

Antoni, Lorenc, *Me rastin e 75 vjetorit të lindjes*, dorëshkrim, Prishtinë, 1984.

Bejtullahu, Alma, *Transpozicija folklornega gradiva v vokalnih in instrumentalnih skladbah loranca Antonija (1909–1991)*, punim diplome, Lublanë, 1998.

Gashi, Don Zef, redaktor, *Libër këngësh korale kishtare*, Qendra »Don Bosko«, Shkodër, 1994.

Povzetek

Tema pričujočega prispevka je življenje in delo Lorenca Antonija (1909–1991). Antoni je ključna oseba v glasbenem ustvarjalnem in poustvarjalnem delu Kosova ob polovici prejšnjega stoletja. Svoje glasbeno delo je začel v Makedoniji in nato nadaljeval na Kosovu, kjer je prispeval k ustvarjanju kulturnih in glasbenih ustanov. Antoni je znan kot prvi kosovski dirigent in soustanovitelj prvih pevskih zborov, ravno tako je tudi utemeljitelj kosovske glasbene pedagogike. Istočasno je prvi albanski skladatelj, ki je pisal številne skladbe za zbor in različne inštrumentalne sestave. Del njegove glasbene dediščine je tudi izčrpno

etnomuzikološko delo, med katerimi izstopajo sedmi zvezki albanskih ljudskih napevov, ki so rezultat večdesetletnega zbiranja ljudskih napevov na terenu.

AT ZEF PLLUMI NË PRAG TË PAVDEKSISË^{*}**

Në vjeshtë të vitit 2003, në një ditë dielli me dhëmbë, u takuam me At Zef Pllumin në Fshatin e Paqes në Shkodër. Zbriste një të tatëpjete dhe fundi i gjerë i zhgunit të murrme i bënte erë. Ndali tek rrethi i njerëzve që kishin zënë rrezen e diellit, lidhi nga pas duart kryq dhe iu drejtua një gruaje në moshë, një francezeje që kish ardhur në atë takim të përkthyesve të huaj të shqipes: Mos ke ftohtë Odilë? Hidhe xhaketën në shpinë. Ç'ishin aty, rendën të bënin nga një foto me At Zefin. Para tij kishe ndjesinë se po takoje historinë. Prandaj mora guximin t'i kërkoja një ide për të hapur në shtyp një cikël shkrimesh për klerikët e persekutuar të dijes. Kisha pasur në dorë deri atëherë vetëm vëllimin e parë të "Rrno vetëm për me tregue", aty ku ai nis e tregon edhe për këto fakte. Dy të tjerët i gjeta më vonë tek një vitrinë bukinistësh në trotuar. Kur gruaja që i shiste i nxori nga bodrumi i pallatit buzë rruge, pyeti: A je nga ato anë ti që blen librat e padres? Je katolike? Jo, jam myslimane, nga Berati. Librat e pater Zefit nuk kishin marrë këtë popullaritet që kanë 10 vjet pas botimit, madje atëherë qarkullonin fjalë se dikujt i interesonte që "Rrno për me tregue" të mos e gjendej nëpër librari.

Aty tek ajo rrezja e diellit në Fshatin e Paqes, biseda rrodhi dhe ati françeskan që siç do ta kishte zakon vitet e fundit në takimet e rralla me orë të gjata, duke e kaluar bisedën degë më degë ndërtonte një

^{***} Intervista e botuar në "Shekulli" më 4 gusht 2007

gjenealogji bashkëbisede dhe ti shihje se ai ishte kthyer prapë atje ku e kish nisur, tregoi për një antropolog amerikan që kish ardhur në veri të Shqipërisë aty nga vitet tridhjetë, dhe kish marrë për kampion matjesh kryet e magjypëve të kësaj ane, pikërisht aty ku po tregonte këtë histori. Ishte në natyrën e tij gjuha parabolike si në rastin e kësaj rrëfenje për keqkuptimin banal të racës shqiptare nga një amerikan, si kur e sillte biseda për lumturinë, gruan dhe burrin, komunizmin, besimin. Parabolat e tij kishin për çudi një nëntekst të hapur që dëgjuesi mund ta interpretonte mesazhin e fratit si të donte, por ama nga kumti që kishe marrë varej vazhdimësia ose e jo e takimeve me të.

Një mbrëmje të vitit 2005 kur një tufë njerëzish ishin mbledhur për librin e tij të ri "Fрати françeskan i Bushatllinjve", vajza e një përkthyesi të njohur u ngrit me qetësi dhe i tha se babai i saj, po, ishte komunist me bindje, por aspak ashtu, njeri materialist, siç e kish përshkruar frati tek kujtimet "Rrno vetëm për e tregue". Nuk e kundërshtoi gruan. Të nesërmen u takuam në shtëpinë e nipërve të tij, pranë kishës françeskane në Tiranë, aty ku në ditët e para të demokracisë, pa shtëpi e katandi, ishte kthyer për të bërë pagëzimet e para. Unë do të diktoj një letër dhe t'i do ta shkruash, më tha, se nuk mundem nga sytë. Në tryezë kishte lupën e stërmadhe dhe një tufë letrash me shkrim dore. Më diktoi përgjatë një ore letrën ku i kthente përgjigje gruas që e kishte kundërshtuar hapur në sy të njerëzve. Pak a shumë thelbi i letrës ishte ky: pavarësisht kontributeve që i kanë dhënë këtij vendi të gjithë ata intelektualë që në vitet 30-40 u kthyen nga Evropa në atdhe me idetë komuniste, ata që nuk e ngritën zërin kundër deformimit që patën idetë e tyre menjëherë pas vendosjes së regjimit të Enver Hoxhës, mbajnë përgjegjësi për çfarë ndodhi pas vitit 1945.

Tërhoqa një nga letrat mbi tryezë. Nga Amerika Petro Zheji i shkruante që kishte vënë në rrugë të mbarë përkthimin e tre vëllimeve "Rrno vetëm për me tregue", porse ishte shumë e vështirë të gjendej në atë vend të madh një botues për këtë libër që do mund t'i tregonte botës ferrin e "Shqipërisë sonë të dashur".

U takuam për herë të fundit më 1 gusht në kthinën e tij të ngushtë në Kuvendin Françeskan të Gjuhadolit. Prapë tha se ndihej si plak. E kishte gjetur këtë gjoja batutën për të hequr qafe pyetjet e kota si je me shëndet, si e ke zemrën e trupin e të tjera si këto. Më tha se njeriu nuk duhet ta tronditë jetën e vetë nga fatkeqësitë e njerëzve të dashur, se çdo njeri ka fatin e tij, dhe kërkoi t'i mbushë me verë gotën e vogël të ujit. Nuk kam pirë kurrë më përpara në jetën time. Kur dola prej burgut një njeri më tha t'i qetoj therjet në zemër me një gotë raki.

Kur sa isha penduar për fjalinë "Kam frikë se s'do takohemi më", ai shtoi një "Po" qetësisht pranuese, të përgatitur, që mezi priste ta nxirte jashtë fytit. Po kam frikë se s'do mundem dot ta mbaroj "Sagën e feminisë". A do të ketë njeri që do ta botojë? Pyeti me dyshim sikur të ishte një fillestar në kësi punësh dhe sikur të mos i kish takuar atij dhe të mos e kish merituar gjithë jehonë që pati ribotimi i kujtimeve një vit para.

Tregoi aty se Saga niste me lindjen e tij në pyll. Kaq. Disa javë më vonë u shtrua në spitalin "Gemelli" në Romë ku mbylli sytë më 25 shtator. Dorëshkrimi duhet të jetë akoma në tavolinën e vogël, në qoshe të kthinës, nën dritaren e drurit që rrinte e mbyllur ato ditë të nxehta ngushti, ngaqë ai kishte ftohtë. Këtu Pater Zef Pllumi dha intervistën e fundit që mbyllet me fjalët për Sagën e feminisë. Ky njeri ishte

shkëputur nga trupi i nënës me një të rënë të sëpatës mbi kordonin e kërthizës. Dhe pastaj të dy dilnin përmes pyllit.

Me At Zef Pllumin në kuvendin françeskan ku prej më shumë se një muaji ndihet i sëmurë. Një bisedë për ndjesën, besimin, fatin, guximin, politikën dhe femrën.

kurrgjë më shumë se liria

Në kuvendin françeskan të Gjuhadolit në Shkodër. Verandën e ndërtesës njëkatëshe ku ndodhet administrata, biblioteka dhe kthinat e fretërve françeskanë, megjithë pemët në oborr, e rreh dielli fund e krye. Pater Zef Pllumi ndodhet në kthinën në fund të korridorit. U bë kohë i sëmurë. E kanë lënë këmbët që një kohe bridhnin kryq e tërthor Dukagjinin. I mban mbështetur në tokë me gjithë bastun që e ngre herë pas herë dhe shtyn derën gjysmë hapi larg poltronit. Njerëzit që e vizitojnë e lënë dhe hapur.

Si je me shëndet pater Zef?

Dje mbret, sot ruajna Zot.

Tre fëmijë i kthejnë faqen. Përshëndetja e ditës. Vijnë prapë nesër.

Kthina ka pak gjurmë françeskani. Shtrati i ngushtë nuk ka gjurmë gjumi. Pas dere xhaketa e zezë e rëndë. Në jakë duket kryqi gri. Duket që ka kohë që s'e ka veshur. Nga tavolina e punës kërcet diçka sa herë ikin dhe vijnë dritat. Është kompjuteri. Te kryet, pranë poltronit, ngjitur në mur, kalendari françeskan. Nesër është 2 gusht, është Ndjesa e Shën Françeskut.

Ndjesë për çfarë pater?

Ai është paraardhësi ynë. Si ai, ne besojmë që edhe mbas vdekjes kemi jetë. Kështu besojmë ne. Kështu kanë besuar dhe ata që kanë bërë piramidat. Po ne besojmë që pjesa më e madhe e mëkateve që bëhen në këtë tokë mund të shlyhen në jetën tjetër. I pari ynë, Shën Fraçesku, ishte duke u lutur në atë kishën e vogël që kish ndërtuar vetë kur iu duk Shën Mëria, ishte me Krishtin. E pyeti çfarë kërkon. Ai i tha që unë kërkoj ata që sillen rrotull kësaj kisha t'u shlyhen mëkatet në atë botë. Tash kanë filluar njerëzit t'i harrojnë punët e fesë.

Bota është më plakë, a mundet lutja të shlyejë detin e mëkateve të njerëzimit?

Sigurisht që do të jetë më e vështirë, por tash për tash na duhet me mendu me mendimin e kohës. Çdo kohë ka etapën e vet, besimin dhe filozofinë e vet. Ne s'mundemi me i fajësu njerëzit. Është gabim me i fajësu njerëzit. Ne fajësojmë politikanët, po jo njerëzit. Njerëzit do të bëjnë gabime se s'bën. Po ku është feja në hapin dhe filozofinë e kohës? Ju thatë se nuk është më si dikur kjo punë. Nuk mendoj që feja ka nevojë të reformohet, ka nevojë të kultivohet. Ju keni investuar në njerëzit tuaj për këto ditë. Kam njerëz tek të cilët kam investuar, por u mungon fati dhe guximi. Dy sende u dashkan në jetë: fat dhe guxim. Ju na keni folur qartë për guximin pater, guximin jo si rrahjegjoksi.

Ky besoni quhet dhe fat i juaj?

Të them të drejtën guximin e kam pasur dhe në burg. Nuk më kanë dënuar për së dyti.

Dhe ky është fati?

Fati pater? Mos mendo se ai libër s'është shkruar kot (Rrno vetëm për me tregue). Më kanë lidhur, më kanë rrahur, më kanë izoluar, dhe unë prapë mundja të flas me oficerët e Sigurimit. Operativi ishte shumë i keq, shumë i vështirë, sidomos në Ballsh. Edhe kur më kanë lidhur, kur më kanë rrahur, kur më kanë izoluar, ata kishin respekt për mua.

Një vizitor hyn në derë.

At Zef Pllumi na kujtoi kampin e Ballshit, fort i vështirë. Ja një skenë mes operativash që rrëfen tek vëllimi i tretë "Rrno vetëm për me tregue":

Atëhere ai mori prangat të cilat i kishte lanë mbi tavolinë, m'i suell duert mbrapa shpine, m'i shtini hekurat në kyçe dhe shtërngoi vidën me sa fuqi kishte. – Ja, - tha, - le të vijë Zoti e Krishti e të shpëtojnë nga duart tona. A beson gjithnjë?

- Po.

- Nuk di ta bësh mirë atë punë, - ndërhyri prapë Jorgoja, - ma ler mua ta përfundoj.

– Dhe ndërkaq mori një palë pinca elektricisi për të vazhdue shtërngimin e vidës me atë fuqi që kishte ai trupmadh. Me hekura ndër duer kishem jetue që në rininë 20 vjeçare, por kurrë nuk kisha provue dhimbje si kjo. - Beson tani? – më pyeti operativi. - Po, besoj.

- Le të shohim në se vjen ai Zoti e Krishti yt të të shpëtojë. A vazhdon të besosh përsëri?

Smjestivši se u poluopustošene krajeve u okolini Zadra, oni su svojom marljivošću obnovili to područje. U usporedbi s okolnim stanovništvom koje je dobrim dijelom pristiglo u isto vrijeme kad i Arbanasi, ovi potonji bili su znatno vrijedniji, pa su ubrzo postali jedno od najrazvijenijih i najbogatijih sela zadarskog kraja. Oni su dva i pol stoljeća bili glavni opskrbljivači zadarske tržnice svježim voćem i povrćem, a mesarski i zidarski obrt grada dobrim je dijelom bio u njihovim rukama.

Već spomenuti svećenici i učitelji iz Arbanasa obnašali su svoju službu u cijelom zadarskom kraju. Što je u to doba bio u zaostalim selima Dalmacije svećenik i učitelj danas se teško može predočiti. Bili su jedine pismene osobe u selu i preko njih su uvedene sve novine u poljoprivredi i načinu života u zaostalo dalmatinsko selo XIX.st. Njihov

udio u hrvatskom nacionalnom buđenju u Dalmaciji već je toliko istaknut da je postao temom doktorskih disertacija.

Na svim područjima života od gospodarstva i politike, do kulture i znanosti Arbanasi su u ova dva i pol stoljeća dali niz zapaženih pojedinaca.*

Tako je ovo mjesto dalo tri značajna političara i to u tri različita režima. Doktor Ivo Perović, nekadašnji pravaš, bio je u staroj Jugoslaviji, za vrijeme Aleksandrove šestojanuarske diktature, ban Primorske Banovine, a kasnije, nakon ubojstva kralja Aleksandra, namjesnik mladog kralja Petra. Josip Đerđa spada u one koji su dolaskom Talijana u Zadar napustili rodni grad. U bivšoj Jugoslaviji obnašao je diplomatsku službu, bio pomoćnik ministra vanjskih poslova, zatim zastupnik, a od 1970. i dopredsjednik Savezne skupštine Jugoslavije. Godine 1972. podnio je ostavku solidarizirajući se s nacionalnim opredjeljenjem osuđenog hrvatskog partijskog vrha. Treći je najbolji zadarski gradonačelnik od nastanka slobodne Hrvatske, Božidar Kalmeta, za čijeg se desetljetnog mandata grad preporodio. Sada je ministar mora, turizma i razvitka u Vladi Republike Hrvatske.

Od onih iz Arbanasa koji su danas nazočni u životu grada spomenut ćemo samo dvojicu: dipl. ing. Danijela Kotlara, za vrijeme rata istaknutog vojnika s činom brigadira Hrvatske vojske, a nakon rata načelnika visoke vojne škole u Zagrebu. Danas je dožupan Zadarske županije. Svojim novinskim člancima, kao kroničar zadarske svakodnevnice, već više od jednog desetljeća nazočan je Ivica Matešić-Jeremija, književnik i kroničar zadarskih ratnih zbivanja. Danas je vojni izaslanik RH u Italiji.

* Na podacima o pojedinim osobama srdačno zahvaljujem prijatelju i zaljubljeniku u Arbanase Bernardu Kotlaru

Već poslovična odanost Arbanasa Crkvi iznjedrila je među brojnim svećenicima i neke vrlo značajne. Odmah po dolasku to je već spomenuti don Ivan Petani, nesuđeni šibenski biskup kojemu mletačke vlasti nisu htjele potvrditi papin izbor, pa je završio kao rektor ilirskog zavoda u Loretu. U međuratnom razdoblju izvan rodnog kraja djelovao je fra Bonifacije Perović, katolički sociolog, filozof i pisac. Stekao je dva doktorata (jedan na pariškoj Sorboni). Bio je jedan od osnivača prvog studija sociologije u Zagrebu i nositelj katoličkog socijalnog pokreta u Hrvatskoj između dva svjetska rata. Među onima koji su nakon rata napustili rodno mjesto i otišli u Italiju je i spomenuti msgn. Šime Duka, jedno vrijeme tajnik Vatikanskog arhiva i zadarski dobrotvor koji nije zaboravio Arbanase, te je u izgradnju i obnovu mnogih sakralnih objekata u Zadru uložio cijelo bogatstvo. Najistaknutiji svećenik arbanaškog podrijetla je Ivan Prenda iz Zemunika, pripadnik onog dijela Arbanasa koji su ostali živjeti na svojim imanjima izvan mjesta. On je prvi od arbanaškog roda dostigao najveći crkveni naslov, primio je mitru i postao zadarski nadbiskup.

U pisanoj riječi Arbanasi su nazočni u albanskoj i u hrvatskoj književnosti. Josip Vladović Relja autor je „Nite“, romana na arbanaškom jeziku s temom o doseljenju Arbanasa u Zadar koji već spada u klasike albanske književnosti. S druge strane književnik Augustin Jaki Stipčević, jedini je Arbanas koji je ušao u antologiju hrvatske književnosti i koji je u svojim djelima dao romansiranu povijest rodnog mjesta, prodrijevši u dušu arbanaškog čovjeka.

Oštrina misli i uma Arbanasa posebno je došla do izražaja u znanosti kod onih darovitih mladića koji su nastavili školovanje.

Navest ćemo samo najznačajnije. Kruno Krstić, erudita, filozof, psiholog i lingvist, za kojeg je rečeno da je bio najpametniji Hrvat XX. st. Tvorac je prvog razlikovnog riječnika između Srpskog i Hrvatskog

jezika (1943.), te Hrvatskog pravopisa; autor je prve suvremene rasprave o naciji i nacionalizmu u nas; prvog nacrtu povijesti filozofije u Hrvata; te pisca koji je za radnog vijeka u Leksikografskom zavodu napisao oko jedan i pol tom enciklopedijskih članaka, ali ih zbog političke nepodobnosti nije smio potpisati. Za svoje rodno mjesto sastavio je jedinstveni Rječnik arbanaškog govora i opisao doseljenje Arbanasa u okolicu Zadra. Povjesničar Aleksandar Šandri Stipčević je znanstvenik širokih zanimanja koji je, kako je već spomenuto, znatan dio svog bogatog znanstvenog opusa posvetio proučavanju Ilira kao prastanovnika ovih krajeva i arbanaških predaka. On je vodeći hrvatski albanolog, ali isto tako i najznačajniji bibliotekarski stručnjak i pisac temeljnih djela iz povijesti knjige u svijetu i u Hrvata. U medicini se istakao liječnik-pedijatar i sveučilišni profesor, doktor Slavko Perović, po kome je čak jedna dječija mast dobila ime (*Perovićeva mast*). Sveučilišni profesor dr. Ratimir Kalmeta, zemljopisac, autor udžbenika i konstruktor stručnih pomagala iz zemljopisa, bio je veliki borac za hrvatsko zemljopisno nazivlje. U pravnim poslovima istakao se odvjetnik, doktor Milan Vladović koji je za svoje zasluge imenovan doživotnim počasnim predsjednikom Udruženja Hrvatskih pravnika.

Mogu se spomenuti i neka imena znanstvenika iz mlade generacije koji su već dostigli zavidan ugled. Izdvojit ćemo samo dvojicu. To su: kardiolog doktor Albino Jović poznat u Hrvatskoj i šire; te Hrvoje Mazija stručnjak za peradarstvo međunarodna ugleda, predsjednik Hrvatskog ogranka svjetske organizacije veterinarara peradara, koji je početkom devedesetih godina obnašao funkciju prodekana Veterinarskog fakulteta.

Arbanasi su u cijelom kraju poznati kao posebno glazbeno obdareni ljudi. Biti Arbanas u Zadru znači: znati dobro pjevati. Zato nije čudo da je iz ovog mjesta ponikao velik broj poznatih glazbenika. Obitelj

pokojnog maestra Šime Dešpalja dala je najznačajnija imena hrvatske glazbene scene: violinisticu Maju i violončelistu Valtera, te svjetski proslavljenog dirigenta Pavla Dešpalja, sada dopredsjednika Hrvatske akademije znanosti i umjetnosti. Oni su slavu hrvatskog muziciranja pronijeli širom svijeta. U Arbanasima su rođeni i Božidar (Daro) Kalmeta i Berto Matešić, također poznata pjevačka imena u hrvatskom glazbenom svijetu.

Već desetljećima u samom vrhu hrvatske estrade stoji ime Đanija Maršana. Da ništa nije napravio, osim pjesme *Bože čuvaj Hrvatsku* koja nam je u prošlom ratu dala toliko nade i očuvala vjeru, ostao bi zauvijek zapamćen. A poziv Europi s pjesma *Stop the war* Tomislava Ivčića da se zaustavi rat u Hrvatskoj, bio je prvi glas probuđenog domoljublja među našim pjevačima. Pijevni dalmatinski melos i raskošni glasovi Bepa Matešića, Mladena Grdovića, Zorana Jelenkovića, te mnogih drugih čine poseban prilog ovoj glazbi.

Značajnu ulogu u glazbenom životu mjesta ima župni zbor „Vicko Zmajević“, koji je još za vrijeme komunizma uspio snimiti gramofonsku ploču s duhovnim pjesmama.

Arbanasi su ljudi impulzivne prirode i bujna temperamenta, te pobjedničkog mentaliteta. Stoga su ovome gradu dali cijelu plejadu športaša i športašica pa se zadarski šport bez Arbanasa ne može ni zamisliti.

Spomenut ćemo samo one najbolje, vrhunske športaše, koji su pridonijeli i pronošnju slave hrvatskog športa.

Zadar je kolijevka hrvatske košarke, a njegova košarkaška legenda je Giuseppe Pino Giergia, osoba nemjerljivo najzaslužnija za razvoj ovog športa u Zadru, vrhunski igrač i trener, koji je sa "Zadrom" osvojio šest naslova državnih prvaka, a s veteranima i naslov prvaka Europe. Za reprezentaciju je igrao 128 puta i nositelj je više medalja s prvenstava

svijeta i prvenstava Europe. Dva puta je nastupio za selekciju Europe i bio njezin kapetan, proglašavan je najboljim športšem Hrvatske i košarkašem Jugoslavije. Nositelj je najvećeg priznanja hrvatskog športa, državne Nagrade Franjo Bučar.

9. U veslačkom športu posebice su zaslužni braća Josip i Romano Bajlo višestruki državni prvaci i sudionici dviju Olimpijada, te mladi Danijel Bajlo.

Arbanasi su nositelji biciklizma u Zadru. U tom je športu najuspješniji četverostruki prvak Jugoslavije Šime Bajlo-Šojin, te nekoliko prvaka Hrvatske među kojima legendarni Josip Bajlo-Bumba i Leonora Stipčević, te njezin brat Nevio Stipčević, koji je prvi zadarski biciklist prvak Neovisne Države Hrvatske.

Arbanasi se mogu podičiti i da je njihov nogometni klub "Zmaj", koji je dobio ime po nadbiskupu Zmajeviću, utemeljen 1910. godine, najstariji zadarski i jedan od najstarijih nogometnih klubova u Dalmaciji i Hrvatskoj.

Literatura:

John Armstrong, *Nations before natinalism*, 1982

Marjan Diklić, *Pravaštvo u zadarskim Arbanasima*, Zadar 1992.

Thomas Hilland Eriksen, *Etnicitet i nacionalizam*, Beograd 2004.

Kruno Krstić, *Doseljenje Arbanasa u Zadar*, Zadar 1988.

Philippe Poutignat, Jocelyne Streiff-Fenart, *Teorije o etnicitetu*, Beograd 1997.

Šime Peričić, *Pregled gospodarstva Arbanasa u prošlosti*, Zadar 1993.

Anthony D. Smith, *The Ethnic Origins of Nations*, Oxford 1998.

Anthony D. Smith, *Nacionalizam i modernizam*, Zagreb 2003.

Aleksandar Stipčević, *Zadarski Arbanasi i stvaranje albanske države*, *Informatori* br. 5-7, 11-14/1993.

VETËSHPREHJE POETIKE

Analizë nga libri me poezi të Elife Luzha-Dedajt

Mr Ismail Syla

Duke lexuar librin e Elife Luzha-Dedajt "Vdekja e ditelindjes" më hyri në shërbim një thënie e semiologut dhe njërës nga mendjet me erudite të bashkëkohësisë sonë, Umberto Eko: "Barra e leximeve" sipas tij është edhe një kusht më shumë për njohjen më të plotë të prodhimit intelektual të njerëzimit.

Paravënia e fjalëve

Mbi këtë parim lexova secilin varg të librit, dhe nga "Vdekja e ditelindjes" vecova gjithqka që më jep arsye të flas për vlerën e poezisë së autores Luzha. Së pari desha të vecoj mikrostrukturë vargut, dhe së dyti, brenda përmbajtjes së librit të përzgjedh "antologjinë". Është interesante se nga leximi me nënvizime, lapsi u ndala në tetë mikrostruktura, që do të lexohen më poshtë. Po ashtu, brenda librit u krijua **minantologjia** prej tetë poezive, që sipas mendimit dhe shije sime meritojnë një lexim eseistik.

Aftësia e gjuhës artistike qendron në faktin e pranvënies së fjalëve që krijojnë dhe arrijne domethënie lirike, estetike. Një dokument i nxjerrë nga zyra shërbimit civil do të ishte i përkryer nga aspekti formal, (certifikatë lindjeje, kurorzimi, vdekjeje, pasaportë, qoftë edhe e

UNMIK-ut) nëse me saktësi aty ku shkruan emri shkruhet drejt emri i njeriut, pastaj mbiemri, ditëlindja he një vule zyrtare. Por, në saktësinë dhe perkryerjen poetike kemi tjera rregulla, tjera kritere. Libri që po promovohet na bind se krijimi letrar është fushë ku fërkimi i fjalëve krijon shkëndija lirike, dhe aftësia shprehëse e gjuhës shqipe nuk do të shteret asnjëherë. Për ata që kanë dije të specializuar për mikrostrukturën e tekstit, për bukurinë stilistike të fjaleve shqipe shqipe, për aftësinë shprehëse të sintagmave, tetë shembujt e mëposhtëm janë si gurë të cmuar, margaritarë poetikë.

“Pabesia mpreh dhembet” (Dans korbash)

“Më lejo ta heqi mallin / Si shaminë ime ëmë” (Në krah engjujsh)

“Hija e zhgënjimit më ndjek” (Lutje)

“Ne lajthitje ëndërrat / Bimojnë dhimbje” (Te pagjeturit)

“Majat e maleve / Me parzmën time i kam mprehur” (Jeta)

“Si gazele dashuria ime / Në fushën e pikëllimit shtrirë (Larg teje)

“Vetmia më dogji / Duke kërkuar njeriun” (Fjala e papagallit)

Miniantologjia

Janë gjithashtu tekstet e tetë poezive që shquhen me koherencën kuptimore dhe ndertim artistik të baraspeshuar me sensin e mases, dhe nuk ka mundësi t'i kalosh me inferencë estetike, as me përgjumje

inelektuale, sepse ato të zgjojnë. Ajo që është bërë rregull i marketingut në botën e konsumit të gjerë, për ta reklamuar qoftë edhe një detergjent si më të zgjuar, më ekonomik dhe më aktiv, nuk po ndodh në botën e artit nga mendimi poetik, të disa vargjeve apo edhe një poezie të vetme, e cila zbulon një trajtë të përmasës së shpirtit njerëzor, një ide, vuajtje, imazh ose një përjetim të botës nëpër membranën e ndjeshme të botës shpirtërore.

Nuk do të lë pa vecuar secilën prej tyre me bazën kuptimore që ia ofron lexuesit të kujdesshem dhe sidomos atij profesional.

Poezia, e cila si titull mbështjell edhe përmbledhjen me titull tronditës, tragjik, dramatik dhe fatal "Vdekja e ditëlindjes", qendron me vete si njësi poetike duke dhënë idenë e të priturës së mjegullt, të paqartë. Në këtë pritje përtej gërryerjes fizike të njeriut është një plagë e jetës shpirtërore që "Thepon zemrën" e njeriut. Kur në botë mungon hapësira e lumturisë, ajo e dhembjes e rrethon atë, sipas ligjit të njohur të shkencave fizike se në këtë botë asgjë nuk shtohet, asgjë nuk humbet, ecse shëndrrohet (transformohet)

"Nëna ime" është poezi e toneve të ngrohta, me nota refleksive, shprehje e një dashurie dhe respekti pa patetikë, por me konfirmime të plota për dashurinë universale ndaj nënës, me vecantinë autoriale të dashurisë ndaj nënës së "Takimeve të mallta", duke përmbyllur idenë se nëna është sinonim i shqetësimit dhe flijimit për krijesat e veta.

"Këngë me nota dielli" ta kujton poezinë "Motive me diell" të Ismail Kadaresë. Derisa ai e udhëzon piktorin që të përjetësojë në pëlhurë motive me diell, para rënies së territ (supozojme para se të vdes) autorja Luzha midis botës së kontrasteve të fuqishme (qyqes, korbit, gjarpërit) ka intencë estetike këngën si "Komponim dashurie me nota dielli".

Poezia "Ik" e ruan mirë gradacionin e rrefimit lirik. Përgjithësisht më mirë se kudo është shpërndarë edhe leksiku poetik i saj. Fjalët dhe togëfjalëshat: kujtim, rrenje zemre, ëndërra, dhembje, pasqyrë dielli, mëngjes, vesë, fole e thurrur etj. Janë qarku semantik i autorës, që në tërë librin vecsa përpunohet dhe nuancohet me nënvariate të ndryshme për t'i dhënë trajtë vuajtjes shpirtore dhe vetëshpjegimit poetik.

Poezia "Historia" është një kredo e autores për atë që aq me bujë e ka proklamuar njohja teorike si raport midis individuale dhe universale midis relacionit njeriu dhe atdheu. Është krenaria romantike dhe nostalgjia ndaj atdheut, ndaj së kaluarës sonë krenare (paradoksalisht ndonjëhere edhe boshe). Ciltërsia e autorës si idealiste dhe veprimtare e hershme e lëvizjes kombëtare karshi atdheut, është më e fuqishme se embrana artistike me të cilën mëton ta ravijëzojë.

Poezia "Kali i Trojës" ka arritur që ta jap bukur idenë se më e rëndë se dhuna është vetëmashtrimi. Nëse "Laokonti" i Kadaresë kulmon me idenë se më tragjike është indiferenca ndaj krimit e sa vetë krimi, autorja sublimon tragjikën e trojanëve:

Në logun e betejës

Nuk vdiqën

Me kalin e vdekur

I vranë

Poezia "Dëshirat" ruan shtrirjen spontane, të pashpifur si ndjenjë dhe mendim për ëndërrat jetësore të autores. Aty del në pah dashuria ndaj atdheut e qartë dhe intime, pa stërhollime stilistike.

Dhe poezia e tetë "Krahasim", e ndërtuar mbi antinominë, më shumë se realizim artistik, arrin të sfidojë dy krahasime midis lotit dhe detit, me të parin autorja peshon mallin, me të dytin zgjeron zemren. Pa dyshim një figurë e mirë më shumë meditative se sa e arrirë artistikisht.

Në vend të përmbylljes

Artur Shopenhaueri thotë "Gjenitë janë të trishtuar. Nuk është fjala për kuptimin strikt të gjeniut, por është fjala për atë komunitet njerëzish të botës shpirtërore, që jetën e përjetojnë me vuajtje dhe gërryerje të thella psikologjike.

Në këtë komunitet padyshim vendin e ka autorja Elife Luzha. Autores i them se të jesh idealiste në tërë shekullin e jetës është ushtrimi më i rëndë i të mbeturit i njëjtë. Jeta jonë është si Prometeu i mitologjisë antike, që ndër sy t'i ndërron mijëra pamje, mijëra fytyra. Prandaj është krejt e natyrshme që në librin tuaj ka aq ankth, aq shqetësim.

Ata qe kanë prirje për ta përjetuar shumë shpirtërisht realitetin, boten në të cilën ka kaq kufizime, padrejtësi mosmirkuptim dhe barbari, natyrisht se nuk mund të mos jenë të trishtë dhe sentimentalë. Barbaria moderne është forma më shtypëse e njeriut. Prandaj do të vazhdosh të jesh të jeshë e vetmuar, ashtu sic shkruan në poezinë tënde "Te digjesh, duke kërkuar njeriun".

NJË VEPËR E PANJOHUR PËR SHPIRTIN SHQIPTAR

Zbulime albanologjike në veri të Danubit

(C.C. Constante: "Spre Albania" (Drejt Shqipërisë), Bukuresht, 1905)

Baki YMERI, Bukuresht

Është një nga veprat e shumta bukureshtare që mbron interesat e kombit shqiptar. "Le të përmendet me këtë rast fakti, se flas për Shqipërinë e Veriut, që përfshin krejt vilajetin e Kosovës dhe një pjesë të vilajetit të Manastirit, dhe i cili dallohet për tepër nga Shqipëria e Jugut, e formuar nga dy vilajete tjera: Janina dhe Shkodra, të shtrira përgjatë brigjeve të Adriatikut". Fati i shqiptarëve dhe rumunëve, autorit i duket identik: dy popuj të kërcënuar me gëlltitje, "nga barbaria turke", dhe "nga uragani sllav". Kur vjen fjala për Kosovën, "po qe se Shqiptarët janë popullata autokotone, ndërsa Sllavët kanë vërshuar përmbi ta, atëherë Serbët duhet ta kuptojnë se pretendimet e tyre, janë jo vetëm të ekzagjeruara, por edhe absurde". Edhe pse e shkruar para një shekulli, në një gjuhë të huaj, kjo vepër paraqet interes të veçantë për studjuesit e albanologjisë. Pothuajse në çdo faqe të saj, defilon dashuria ndaj Shqipërisë dhe shpirtit shqiptar.

Nuk mund ta trasosh ardhmërinë, pa e njohur të shkuarën

Një ndër librat e vjetër dhe të rrallë, që ta mundëson një njohje të këtillë, është edhe vepra monumentale e autorit bukureshtar, Constantin Sterie Constante: "Spre Albania" (Drejt Shqipërisë). Fjala

është për një spektër subjektesh, të sitematizuara shkencërisht në një monografi prej 211 faqesh, me një ballinë që ta përkujton shqiptarin e kohës së Rexhep Vokës (1905). U botua në Bukuresht para 100 vitesh, dhe u ribotua dy vjet më vonë, me të njëjtën përmbajtje, në një shtypshkronjë të re, dhe me një ballinë të re (1907). Origjinali i saj ruhet në Bibliotekën e Akademisë Rumune ndërsa një fotokopje ia kemi dhënë Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës falë përkushtimeve madhore të drejtorit të saj për begatimin e këtij institucioni të shenjtë, zotit Sali Bashota. Autori ishte shkrimtar rumun me prejardhje vllahe nga Maqedonia. U lind në Ohër, më 1877, dhe vdiq në Bukuresht, më 1964. Nuk e dimë në e dinë ndërkombëtarët se komunistët maqedonë, si produkt i pansllavizmit sovjetik, për ta justifikuar sintagmën "*makedonsko ime nema da zagine*", i fshinë nga faqja e dheut, varrezat vllahe në qendër të Ohrit. Deri para disa vitesh jetonte në Bukuresht vajza e autorit: Lena Konstante, e cila në moshën 95 vjeçare kishte një kujtesë të kthjelltë për babain e saj dhe respektin e tij ndaj kombit shqiptar. Pas librit mbi Shqipërinë, autori Konstante ka botuar edhe një serë librash të tjerë mbi rumunët e Timokut (1907, 1929, 1943), kujtime nga Maqedonia (1939), një fjalor turqisht-bullgarisht-rumanisht, si dhe një monografi mbi Selanikun. Paralelisht me veprat e Nikolla Jorgës, Teodor Kapedanit dhe Xhelku Maksutit, libri *Drejt Shqipërisë* është një nga veprat e shumta bukureshtare, që mbron interesat e kombit shqiptar.

Edhe pse e shkruar para një shekulli në një gjuhë të huaj, kjo vepër paraqet interes të veçantë për studjuesit e albanologjisë. Pothuajse në çdo faqe të saj, defilon dashuria ndaj Shqipërisë dhe shpirtit shqiptar. Qysh në kuadrin e parathënies, "*Epoka e re*", autori thekson faktin se "*kauzat inependente*", ishin ato që e shtynë t'i reket rrugëtimit për në jug të Danubit. Pas kthimit në atdhe, "*vendosa t'i botoj përshtypjet që*

m'i sugjeroi studimi i propagandave të ndryshme që e preknin terrenin e Shqipërisë Lindore, ku qesh angazhuar të themeloj një shkollë rumune në Prizren, dhe të afirmoj, traditat dhe doket shqiptare, pothuajse të panjohura për popullin rumun, dhe publikun lexues. Dhe meqë fati i popullit rumun është i ngjashëm me atë të popullit shqiptar, mendoj se bëj një shërbim të shenjtë, duke ia bërë të njohur vendit tim, dhe sidomos njerëzve tanë politikë, me shpresë se ndoshta kështusoj, do të arrij ta zgjoj interesin, për një popull që meriton vëmendjen tonë të sinqertë". Admirimin e autorit ndaj kauzës shqiptare, e konfirmojnë edhe letrat e tij, ende të pabotuara, që ia dërgonte Nikolla Naços nga Shkupi, përgjatë vitit 1900.

*Vepra e Konstantin Konstantes mbi Shqipërinë Lindore (Kosova në jug dhe veri të Sharrit), ndahet në katër kaptina. Në të parën bëhet fjalë për impresione, zakone dhe tradita, për konsiderata historike dhe gjeografike, për njerëz dhe fakte, për luftërat ndërmjet helenizmit dhe sllavizmit, për bullgarët e serbët, për propagandën serbe, për qëndrimin e rumunëve ndaj grekëve dhe bullgarëve. Kaptina e dytë trajton do subjekte mbi Fushën e Kosovës, moralin dhe logjikën shqiptare, mbi Prizrenin dhe lëvizjen shqiptare, mbi "Serbinë e Vjetër" dhe propagandat austriake. Në kaptinën e tretë lexuesi kënaq shpirtin duke lexuar subjektet: *Shqipëria dhe Shqiptarët, Shqiptarët dhe islamizmi, Martesa, lindja dhe vdekja, Psikologjia e Shqiptarëve, Besabesë*. Kaptina e fundit përfshin konkluzionet: *Ndjenja kombëtare e Shqiptarëve, Themelimi i shoqërive të para kulturore, Lëvizja kulturore dhe qeveria Osmane, Autonomia e Shqipërisë, Prenk-Bib-Doda, Shqiptarët grekomanë, Alfabeti shqiptar, Vëllezërit Frashëri, Shqiptarët dhe propaganda rumune në Maqedoni, Procesi i asimilimit ndërmjet rumunëve dhe shqiptarëve, Një manifest shqiptar, Superioriteti i**

Shqiptarëve dhe Rumunëve ndaj të gjitha nacionaliteteve të tjera, Një shtet Albano-Rumun.

Ligjet e perandorisë nuk kanë kurrfarë vlere në Shqipëri

Si e konsideron autori në fjalë, vendlindjen e Kolë Bojaxhiut? *"Para se të vazhdoj rrugën për në Prizren të Shqipërisë Lindore, u ndala disa ditë në Shkup. Qëndrimi im i këtushëm arsyetohej me faktin se duhej ta rishoh familjen time, e vendosur këtu nga komuna e Krushovës, që nga viti 1870. Në anën tjetër, kisha nevojë për t'u armatosur me rekomandimet e nevojshme për misionin tim, për autoritetet e Prizrenit,...dhe sidomos për prijsit Shqiptarë, fjala e të cilëve është vendimtare në çështjet administrative apo gjyqësore, ngase, siç do të shohim më poshtë (kur do të merremi me jetën dhe zakonet e Shqiptarëve), ligjet e perandorisë nuk kanë kurrfarë vlere në Shqipëri, ku çdo gjë bëhet sipas zakoneve të konsakruara në praktikë, që nga kohët e pambajtura mend"*(9). Në vazhdim autori e përshkruan Shkupin ku ka kaluar pjesën më të madhe të fëmijërisë. *"Shkupi paraqet një rëndësi të veçantë përmes fakti se është qendra tregtare e Shqipërisë Veriore, dhe në të njëjtën kohë, qendra e pikëpjekjes së propagandave që i kanë drejtuar shikimet kah porti i Selanikut, dhe qytetet e brigjeve të Adriatikut"* (11).

Duke u ndodhur në një kryqëzim rrugësh mes Lindjes dhe Perëndimit, Veriut dhe Jugut, Shkupi përgjatë historisë u bë vatër shkollash, kishash e diplomacishë. Të gjithë rendnin pas tij për ta përvetsuar, sidomos Serbia, Bullgaria dhe Austria. Autori e përshkruan Sharrin si *"një kështjellë vargmalesh"*, si dhe Vardarin si *"pikëndarja e Shqipërisë Lindore nga Maqedonia, ...që buron në fshatin Vrut (ar. "i*

dashur”), rrëzë malit Vllajnicë, si një pjesë e Sharrit, e dominuar nga platoja magjepse e Bunecit (rum. “i mirë”). “Ku fshihet misteri?” – pyet autori bukureshtar. Përmes cilave rrethana mbetën këto emra?” (13). Pasi e ndërlihdh Shkupin me periudhën ilire të Justinianit, pasi deshifron mbishkrimet romake të do pllakave antike, Konstante thekson se “Shqipëria Lindore ishte e kolonizuar dikurë, nga stërgjyshërit tanë” (19).

Mos vallë nga kjo periudhë, e “stërgjyshërve” romakë, kanë mbetur edhe do toponime tjera si: Gajre (nga “gara”), Vica (nga “vita”), Llumnica (nga “lumina”)? Pasojnë fragmente mbi pushtimin osman, mbi mërgimin drejt Rumanisë si pasojë e varfërisë, mbi manipulimet e pansllavizmit në Ballkan, mbi serbët dhe bullgarët e përkrahur nga Rusia, mbi serbizimin e bullgarëve të Maqedonisë, mbi influencat e helenizmit, mbi propagandat serbe ndaj Kosovës. “Përmes publikimeve të ndryshme kontinuitive, Bullgarët përpiqen tani të dëshmojnë sa historikisht po aq edhe filologjikisht, bullgaritetin e sllavëve të Maqedonisë, sidomos atë pjesë të vilajetit të Kosovës, të cilën serbët e quajnë “Serbia e Vjetër” (45). Autori synon të njohë jetën e arumunëve të Krushovës, dhe militon për hapjen e një shkolle rumune në Shkup, bën fjalë për shkombëtarizimin e shqiptarëve dhe arumunëve nga ana e grekëve dhe bullgarëve, dhe më në fund, niset për në Kosovë. E gjithë kjo ndodh përgjatë vitit 1905.

Rruga për në Kosovë

Në kaptinën e dytë, “Drejt Fushës së Kosovës”, përshkruan nisjen për në Ferizaj, në gjirin e një treni të vjetër. “Linja hekurudhore që shkon nga Shkupi në Mitrovicë, qarkullon vetëm dy herë në javë. Një vagon i vetëm

i kl.të dytë, dhe disa vagonë të kl. të III-të, të përngjitura për trungun e një treni mallrash, janë të denja për administratën e hekurudhës orientale, dhe sidomos për udhëtarët që i shfrytëzojnë. Të gjitha vagonat e dalë nga përdorimi në këtë linjë, shfrytëzohen për transportimin e bujqve Arnautë” (65). Treni asokohe qarkullonte dy herë në javë, dhe mu kjo ndikonte që të ketë një tollovi të madhe udhëtarësh... “Për ndryshe, përveç Arnautëve, që formojnë pothuajse krejt klientelën e rregullt të kësaj linje, janë edhe Serbët, që gjenden të shpërndarë, duke bashkëjetuar me Shqiptarët, në krejt Shqipërinë e Veriut (vis i okupuar dikurë, edhe nga Knjazët serbë, gjë për të cilën, edhe sot vazhdojnë ta konsiderojnë si Serbi e Vjetër)” (66). Si e përshkruan autori bukureshtar, sallën e pritjes në stacionin hekurudhor? Porsi në film: një film dokumentar i fillmshekullit XX:

“Poshtë, të hedhur në parregullsi të madhe, gjendej një grumbull i madh hejbashë të lëkurës, përndryshe, të punuara me njëfarë shije artistike orientale. Në të djathtë e në të mëngjër, një grumbull thasësh me gjithfarë mallërash. Mënjatë grumbuj batash (këpucë prej gome), tejmatanë dengje tërkuzash, gjithfarë mallërash të tjera që i kishin marrë me vete, me shpresë se nuk do të vërehen nga kontrollorët, që të shpëtojnë kësisoj nga taksat e bagazheve, e gjithë kjo ta jepte panoramën e një pazari osman, dhe assesi të një sallë pritjeje, të një stacion hekurudhor. Udhëtarët, të mbështetur mbi thasë, me cigare në gojë, shpërndajnë valë tymi, duke e mbushur sallën, deri në gulçitje. Pjesa dërmuese e tyre janë Arnautë, të veshur në kostume e tyre kombëtare; qytetarët mbajnë do shallvare të gjera prej pëlhure të kaltërt apo të kuqe, një mintan në formë sakoje, i qëndisur me fije mëndafshi, njëfarë “ibrishini” me do pulla të mëdha. Në kokë mbajnë një fes të kuq e të gjerë, ndërsa nga maja e kokës, dmth. e fesit, lëshohet deri mbi supe, një fjongo e madhe, që peshon përmbi një kgr”. Fshatarët

shqiptarë, sipas autorit, *“janë disi më të thjeshtë në veshje, dhe mbajnë do shallvare të ngushta prej shajaku të bardhë apo të zi, të qëndisur nga xhepat e deri poshtë, me do fije gajtani; një mintan prej leshi, dhe përmbi të një lurkë të shkurtë, e zezë, me njëfarë jake, e cila kur bie shi, mbërthehet në dy skaje, dhe shndërrohet në kësulë”* (67).

Në këtë turmë udhëtarësh që ishin nisur me tren, autori takohet me një plakush gjakovar (Qerim Aga). *“Pasi i la hejbetë nën kanape, dhe do dengje tjera me mall, u ul këmbëkryq në një qosh, dhe pastaj, duke u drejtuar kah ne, na uroi tradicionalisht “Udhaembarë!”, të cilës ne, me modesti të veçantë iu përgjigjëm “Tungjatjeta!”*. Nuk kaloi asnjë minutë dhe plaku, e hapi një pungë të madhe, që e mbante në brez, brez i qëndisur me fije ari, i thurri tre cigare të mëdha sa gishti i madh, dhe pasi e vu njërenë në llullë, e ndezi, dhe pastaj na ofroi edhe neve nga një”. Edhe pse s’i duronte shtjegullat e tymit, autori duke i njohur traditat shqiptare, e merr cigaren pa kurrfarë refuzimi. *“Refuzimi te Shqiptarët konsiderohet si ofendim, dhe këtë e dija nga Shqiptarët e Shkupit, që numerikisht janë të shumtë”* (69). E përshkruan sinqeritetin, pamjen, trimërinë dhe Besën shqiptare. *“Pothuajse krejt Shqiptarët e Shqipërisë Veriore, janë përnga shtati më të lartë se të tjerët, me do krahë të gjerë që reflektojnë trimëri, me gjoksin e mbuluar me lesh të dendur, të hapur ndaj diellit dhe ngricës, me do sy të mëdhenj e të shndritshëm, të inkuadruar nga do qerpikë të dendur, me fytyrën e djegur nga dielli; thuajse para teje ke një gjigand i gatshëm të të qesë përtoke me duart e tij, dhe kjo frikë shtohet kur duke e takuar në rrugë, je i detyruar ta shikosh drejt e në sy, dhe t’i përgjigjesh përshëndetjes së tij tradicionale “Tungjatjeta!”* (84).

Në Shqipëri, sipas autorit, çështjet kryesore që komentohen përgjatë ditës, janë *“hakmarrja, ndonjë krim, ndonjë vjedhje e rëndësishme, apo rrëmbimi i ndonjë tregtari të pasur”*. Sipas tij, *“të*

gjithë, madje edhe Shqiptarët e krishterë, vuajnë nga Shqiptarët myslimanë. Këta të fundit, që nuk janë myslimanë, veçse me emrin dhe përmes faktit të synetllëkut, përmes konvertimit të tyre në islamizëm, e kanë rruajtur tërë pavarësinë e tyre, ashtu siç e kanë trashëguar nga gjysh-stërgjyshërit. Përmes një fakti të këtillë, ata i terrorizojnë ata të cilët krishtërimi ua ka ngritur të drejtën për të mbajtur armë" (70-71). Duke deshifruar letërkembimin elektronik, konstatojmë se edhe pas një shekulli, kemi "sivëllezër" të atillë, që edhe në kohë të paqës, keqpërdorin armët dhe uniformat ushtarake shqiptare, duke e njollosur dinjitetin e shqiptarit, përmes hakmarrjes politike, hajdutllëkut, dhunës, dhe kriminalitetit. "Kur kalojmë para varreve të dëshmorëve që dhanë jetën për liri, stërkuqemi nga turpi që na ka kapluar, si pasojë e kopilave të kombit", thekson në letrën e tij, njëri nga luftëtarët e lirisë. Se ç'janë duke bërë shqiptarët dhe ndërkombëtarët, për identifikimin dhe shpartallimin e tyre, këtë vetëm ata e dinë.

shqiptari s'e duron shkeljen e fjalës

Autorin e impresionojnë shqiptarët katolikë të Mirditës, dhe e shqetson fakti se "gruaja dhe fëmijët te Shqiptarët, konsiderohen si do skllëvër të mirë vetëm për punë". Në kuadrin e kaptinës "Moraliteti dhe logjika te Shqiptarët" (75-91), përshkruhet sinqeriteti dhe ndershmëria ndër shqiptarë. "Shkelja e fjalës së dhënë, konsiderohet si një çnderim i atillë, që ia jep secilit të drejtën, ta përmirësojë përmes armës". Pse? "Ngase te Shqiptarët, derisa drejtësia bazohet te fuqia e më të fuqishmit, padrejtësia dhe imoraliteti dënohen vetëm nga ata që janë viktimë e tyre, ndërsa shkelja e fjalës së dhënë, është një thesar i shenjtë,

dhe ajo ndëshkohet nga pushteti publik: pra nga krejt fisi në të cilin bën pjesë individi” (80). Nga Ferizaji deri në Prizren, rruga me karrocë zgjat 12 orë. Mahnitet nga hijeshitë e natyrës, dhe këtë e vëren edhe karocieri shqiptar: “Po, Shqipëria ime është e bukur”, ia kthen ai, “i përgëzuar nga komplimentet, ngase asnjë vend tjetër nuk mund të jetë më i bukur, por është e varfër dhe nuk na jep bereqet të mjaftueshëm”. “-Nuk jua jep kafshatën për të cilën keni nevojë”, ia kthen autori, “ngase nuk dëshironi ta punoni dheun e saj të plleshëm; ngase nuk dini t’i shfrytëzoni pasuritë e saj të brendshme; ngase nuk dini të shfrytëzoni pyjet saj shekullorë, të cilat sot u shërbejnë si strehë, vetëm kafshëve të egra dhe hajdutëve. Por, ditën kur pllugu do ta lëvrojë këtë truall të virgjërë, (...) atëherë do të kini bereqet të mjaftueshëm, turmat do të shumëzohen, ndërsa paqja dhe qetësia do ta zëvendësojnë terrorin dhe përçarjen, atëherë populli shqiptar, populli trim shqiptar, do të ringjallet nga vdekshmëria” (89).

Shqiptarët, sipas këtij autori bukureshtar, janë të mençur përnga natyra, por kanë mbetur pa kulturë. Ata nuk i kuptojnë ata që flasin me të madhe për pavarësinë e Shqipërisë, “ngase, faktikisht ata janë të pavarur, duke mos patur kurrfarë lidhjesh me perandorinë osmane, nga e cila vetëm politikisht varen, ngase Sulltani zotëron kahmos”. “Le të përmendet me këtë rast fakti se flas për Shqipërinë e Veriut, që përfshin krejt vilajetin e Kosovës dhe një pjesë të vilajetit të Manastirit, dhe i cili dallohet për tepër nga Shqipëria e Jugut, e formuar nga dy vilajete: Janina dhe Shkodra, të shtrira përgjatë brigjeve të Adriatikut” (90). E përshkruan ndjenjën kombëtare në Labëri dhe te Toskët, që ka filluar të zgjohet, dhe shpreh keqardhje për faktin se, si pasojë e sundimit osman, në Shqipëri të Veriut kjo ndjenjë, “me vështirësi zë rrënjë”. Sipas tij, shqiptarët e krishterë, ortodoksë dhe katolikë, e kanë për detyrë “ta shtrijnë flakën e atdhedashurisë, edhe mbi shqiptarët

myslimanë". Këtu del në shesh "armiqësia që përdor qeveria kundër të gjitha rivendikimeve kulturore e kombëtare të Shqiptarëve ortodoksë të Korçës, dhe të Shqiptarëve të Prizrenit, të cilët me vështirësi të mëdha, kanë mundur të themelojnë nga një shkollë kombëtare, përkundër pengesave të panumërta që u vihen nga ana e autoritetve" (91).

Me të arrirë në kryeqendrën rilindase të Shqipërisë (Prizren), i lodhur nga rruga, dhe i mahnitur nga bukuritë e natyrës, nga majat e Sharrit dhe Drini i Bardhë, përshkruan në detaje, çdo gjë që sheh. Në njërën nga kafenetë e qytetit, zatet me një vllah të shpërngulur nga kryeqendra arumune e Krushovës. "Popullata e Prizrenit përbëhet nga Shqiptarët: *myslimanë dhe katolikë, Serbë dhe Rumunë*". Shqiptarët sipas tij, jetojnë "në kushte shumë më inferiore, se sa popuj të shumtë të Afrikës dhe Oqeanisë" (88). Qëllimi i autorit është të hapë një shkollë rumune, për gogallarët e Prizrenit, por plani i tij dështon, si pasojë e një grekomani, që e spiunon te autoritetet turke. Gogallarët sipas tij, përbënin një komunitet prej 820 shpirtërash, dhe ata frekuentonin një shkollë greke. Pos vllahëve që e braktisën Voskopojën e djegur nga bandat e Ali pashës, e u vendosën kahmos, nëpër Shqipëri, Maqedoni, e gjetiu, "në Shqipërinë e Veriut nuk gjendet asnjë gjurmë Rumunësh" (108). Sipas autorit, ekzistojnë dy hipoteza mbi prezencën e rumunëve në Prizren, edhe pse "këto hipoteza mbeten trillime të thjeshta, ngase, siç thash edhe më parë, nuk rruhet kurrfarë tradite lidhur me vendosjen e Rumunëve në Prizren" (po aty-108).....

Fati i shqiptarëve dhe rumunëve, autorit i duket identik: dy popuj të kërcënuar me gëlltitje, "nga barbaria turke" dhe "nga uragani sllav". Në atë kohë, kishte lindur ideja e krijimit të një shteti të përbashkët shqiptaro-vllah. Autori ëndërron ditën kur elementi shqiptar, duke arritur në të njëjtën shkallë të intelektualitetit, me atë të nacionaliteteve të tjera, do t'ia shtrijë dorën rumunëve "për të formuar

(nga katër vilajetet, në të cilat Rumunët dhe Shqiptarët formojnë mazhorancën e madhe mbi të gjitha nacionalitetet e tjera), dhe me miratimin e Fuqive, të krijojnë një shtet i cili do ta qetësonte, sa ekspansionin e Sllavëve, po aq edhe atë të Gjermanëve ndaj jugut, drejt detit Egje, dhe nga veriu, drejt detit Adriatik”(97). Rumunët nuk e duronin dot, perandorinë osmane dhe atë austro-hungareze. Shqipëria katolike, megjithatë, mbante lidhje të fuqishme me Austrinë dhe Gjermaninë. Konstantini ka krijuar përshtypjen se “Austria ëndërron të peshkojë përjetë, në ujëra të turbullta”.

kisha katolike dhe lëvizja kombëtare shqiptare

Nuk e dimë në e kanë ngritur shqiptarët Katedralen e Kombit në zemër të Dardanisë për ta bindur Europën dhe botën se Kosova është mrekullia e shtatë e botës, e cila nuk i është nënshtruar as pushtimit osman as kolonializmit serb, por i dimë mendimet fisnike të këtij autori rumun me prejarrdhje arumune: “Merreni me mend se si do të dukeshin dymilionë Shqiptarë, të arsimuar në gjuhën e tyre amtare, me një ndërgjegje kombëtare të zhvilluar, duke krijuar, sëbashku me Rumunët, një shtet të vogël, por të fuqishëm, në jug të Austrisë!”. Sintagëm rumunë, autori e përdor për arumunët. Në anën tjetër, sipas tij, as Italia nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj shqiptarëve, me të cilët ka interesa politike dhe ekonomike. Në këtë rrëmujë ëndrrash e aspiratash, herë për një Shqipëri reale nën protektoratin e Austro-Hungarisë, herë në atë të Italisë, e herë në atë të një shteti të përbashkët Shqiptaro-Vllah, në kohën kur vilajetet shqiptare ende ndodheshin nën pushtetin osman, autori njihet me drejtorin e shkollës shqiptare të Prizrenit, **Matej Logoreci**, “një patriot i ndezur shqiptar, me

prejardhje nga Durrësi. Zotëria e tij nuk dinte si ta manifestojë entuziazmin që ndjeu, kur pat dëgjuar se në Prizren do të themelohet një shkollë rumune. Shumë të paktë janë patriotët rumunë dhe ata shqiptarë, që do ta kuptonin rëndësinë e një bashkëveprimi të këtillë, të këtyre dy popujve. Edhe unë pata kënaqësinë e veçantë, të konstatoj se ky atdhetar i dëshmuar shqiptar, ishte njëri ndër ata raste të rralla, që kishte arritur ta kuptojë rëndësinë e bashkëveprimit të Shqiptarëve me Rumunët.”(104).

Në vazhdim, pasi i përshkruan peripetit nëpër të cilat kishte kaluar, derisa e kishte themeluar, të vetmen shkollë shqiptare që funksiononte asokohe në vilajetin e Kosovës, Matej Logoreci, e fton autorin ta vizitojë shkollën. “Në një shtëpi me një kat, e përbërë nga tri dhoma të mbushura me mbi 90 nxënës dhe nxënëse, ja e vetmja shkollë shqipe. Krejt mobilieri i kësaj shkolle, përbëhej nga bangat, nga një dërrasë e zezë dhe shkumsi. Aq dhe asgjë më shumë: as libra, as harta, asgjë që i nevojitej një shkolle dhe profesorëve, apo nxënësve. Të vetmet libra që i mësonin nxënësit, ishin do katekizme. Dëshmoj se rrallëherë kam parë ndonjë njeri, me një përkushtim kaq të lartë, ndaj atdhedashurisë së tij. Ky njeri, që kishte një pozitë të favorshme në qytetin e lindjes, ka ardhur në Prizren, vetëm e vetëm nga malli, për t’ua themeluar bashkatdhetarëve të vet, një shkollë kombëtare”(105).

Pasojnë pasazhe ku autori spjegon vështirësitë nëpër të cilat pat kaluar drejtori, për të përfituar autorizimin, për hapjen e një shkolle të këtillë, për dyshimin e autoriteteve turke që kishin ndaj arsimimit të shqiptarëve. Atyre s’u konvenonte që shqiptarët ta kuptojnë të vërtetën, se të parët e tyre kanë qenë të krishterë, ngase komuniteti i vetëm i shtetit turk, “ishte feja”. Matej Logoreci, sipas tij, dëshmonte një mençuri të rrallë, duke ua mësuar shqiptarëve lutjet katolike. Pse?

Ngase *“autoritetet turke, nuk kishin frikë më të madhe, se sa frikën ndaj Papës”* (po aty-105).

Në kuadrin e kaptinës Lëvizja shqiptare, autori e përshkruan Prizrenin, i cili asokohe kishte 12 mijë banorë, nga të cilët dymijë ishin shqiptarë të konfesionit katolik, ndër ta duke bërë pjesë, edhe prindërit e Nënë Terezës. *“Në Prizren banon edhe episkopi katolik Monseniori Troksi, edhepse rezidenca e tij gjendet në Shkup. (...) Porsi në të gjitha kishat katolike, mesha mbahet në gjuhën latine, por lutjet në gjuhën lokale. Mu për këtë shkak, krejt kleri katolik i Shqipërisë, është me prejardhje shqiptare”*(106). Autoritetet kishtarë sipas këtij autori bukureshtar, kanë përkrahjen e Austrisë, paguhen nga Vjena, dhe e kanë për detyrë *“të veprojnë për afirmimin e interesave shqiptarë”* (106). At Troksi, sipas autorit, duke u bashkuar edhe me patriotë të tjerë shqiptarë, *“filloi një lëvizje serioze në kuptimin kombëtar shqiptar, sa pranë fiseve katolike të Mirditës, po atë edhe pranë atyre të shqiptarëve muhamedanë”* (po aty-106). Meqë konsullit austriak nuk i konvenonte qëndrimi patriotik i Troksit, e spiunoi në Vjenë.

Qeveria e Vjenës, duke i besuar konzullit, ndikoi që ky i fundit të thirret në Vatikan. *“Popullata shqiptare e Prizrenit duke parë ndërkaq padrejtësinë që i beheshin episkopit për shkak të ndjenjave të tij kombëtare, në shenjë proteste, e mbyll kishën katolike, dhe për ta hapur, kërkoi nga qeveria e Vjenës, jo vetëm zëvendësimin e konzullit, por edhe diç më shumë: rehabilitimin e episkopit Troksi”*(107). Kështu, më në fund, Troksi kthehet në vendin e tij. *“Aktin e parë të tij, që e bëri pas kthimit nga Roma, ishte themelimi i një shkolle shqipe në Shkup, si dhe vënia e gurit themeltar, për ngritjen e një katedrale (katolike shqiptare-B.Y.), që u ngrit me shpenzimet e perandorisë së Franz Josefit”* (107). Ky manifestim i ri kombëtar i episkopit, kaloi pa kurrfarë incidenti, duke patur parasysh qëndrimin tolerant, të autoriteteve turke në atë kohë.

Më në fund, autori kthehet me të njëjtën karrocë postare, në Ferizaj, dhe prej atje, merr trenin për në Shkup.

Kosova, pretendimet absurde serbe, dhe autoktonia antike shqiptare

Në kuadrin e kaptinës mbi Kosovën (113-119), të cilën serbët e konsiderojnë si "Serbi e Vjetër", autori rumun, duke s shfrytëzuar argumentin historik, parashton pyetjen: "A ka qenë vallë "Serbia e Vjetër" e banuar që nga antikiteti nga sllavët, ndërsa popullata shqiptare, që gjendet e përzjerë me këtë element sllav, në Veri-Lindje deri tejmatanë Kumanovës, në Veri deri Vranjë dhe Nish, dhe nga Veri-Perëndimi deri në kufinj të Bosnjës dhe të Malit të Zi – po qe se këto popullata paskan ardhur nga Shqipëria e Jugut, nga Janina dhe Shkodra, apo përkundrazi, elementi sllav ka ardhur përmbi elementin shqiptar?". Në rastin e parë, autori thekson faktin se "pretendimet e serbëve ndaj këtij territori, justifikohen vetëm përmes faktit se e kanë zotëruar (përmes okupimit) një kohë të gjatë", dhe kjo mund të jetë "një e drejtë e tyre historike e patjetërsueshme", megjithatë, "po qe se Shqiptarët janë popullata autokotone, ndërsa Sllavët kanë vërshuar përmbi ta, atëherë Serbët duhet ta kuptojnë se këto pretendime janë jo vetëm të ekzagjeruara, por edhe absurde" (114). Duke u mbështetur në statistikat e misionarëve katolikë, të vitit 1900, Konstantin Konstante konstaton se nga 900.000 banorët e vilajetit të Kosovës, vetëm 300.000 janë Sllavë, nga të cilët po qe se i nxjerrim 100.000 bullgarë, "Serbëve nga krejt "Serbia e Vjetër" nuk u mbeten veçse 200.000 Serbë, ndaj 500.000 Shqiptarëve të kulluar". Sa janë të sakta këto shifra, nuk dihet, duke patur parasysh faktin, se autori bukureshtar, e citon me një rast autorin serb, A. Bogosavleviç, dhe librin e tij "O Arnautima", Nish, 1897. Edhe në kuadrin e kësaj kaptine, lexuesi përfiton përshtypjen reale, se

Shqipëria Lindore përkufizohet me Vardarin, përmes linjës Manastir-Veles-Kumanovë. Në këtë kontekst, numri i arumunëve në Maqedoni, sipas statistikave turke, sillet rreth 4.000 banorë, pjesa dërmuese e tyre, megjithë 300 arumunët e Tetovës, ndodhet në fillim të sllavizmit. Pokështu, sipas kësaj vepre, ngjet edhe me 820 gogallarët e Prizrenit (118).

Pason një kaptinë e re "Propaganda austriake". "Përveç konsullatës së Shkupit, Austria e ka një konsullatë edhe në Prizren, në zemër të Shqipërisë së Veriut"(123). Misioni i saj, me fjalë të tjera, ishte ndjekja e aktiviteteve serbe, dhe përkrahja e shqiptarëve, duke patur parasysh, përkatësinë e tyre katolike. *"Kleri katolik, sipas autorit, me një frymë propaganduese e denjë për ta theksuar, ka ditur ta përfitojë besimin jo vetëm të fiseve shqiptare të ritit katolik, por edhe atë të Shqiptarëve myslimanë, shefat e të cilëve, pothuajse të gjithë janë në shërbim të qeverisë austriake".* Qëllimi i Austrisë, sipas tij, ishte *"ta përforcojë frymën kryengritëse të Shqiptarëve kundër Sllavëve, për ta mbajtur rendin e gjërave, përjetë të turbullt"* (123). Pason fragmente ku prshkruhen shefat e fiseve shqiptare, duke filluar nga Mustafa Lita i Lumës, e deri te Riza bej Gjakova, Bajram Curri, Mulla Zeka, etj.

Shqipëria dhe Shqiptarët (Albania si Albanezii)

Para kaptinës së fundit (Konkluzionet), në kaptinën e tretë, që meriton një vëmendje të veçantë, autori nxjerr në pah, shtrirjen territoriale të shqiptarëve, natyrën shqiptare, prejardhjen e shqiptarëve, fiset shqiptare dhe karakterin e tyre, etj. Po e japim atë që duhet ta dinë edhe ndërkombëtarët, dhe pse jo, edhe fqinjët tanë, të dehur me një mitologji të atillë ballkanike, e cila u jep të drejtën, që edhe në ato vise

ku ka tre serbë apo tre grekë, ta konsiderojnë si Serbi, apo Greqi: "Pjesa Perëndimore e Turqisë Europiane, e kufizuar në Veri me Serbinë dhe Austrinë – përmes Bosnjës në Jug me Tesalinë greke, në perëndim me Detin Adriatik dhe në Lindje duke patur për kufi qytetet Shkupi (vil.Kosovës), Manastiri, Korça dhe Ohri (vil. Manastirit), është e njohur nën emërtimin Arnautllëk, dmth. vendi i banuar nga Arnautët, Albania. Kjo krahinë kolosale, që ka një shtrirje prej përmbi 40.000 km.k. dhe një popullatë prej rreth 2.20.000 shpirtërash, ndahet në dy regjione: Shqipëria e Jugut, që përfshin Epirin dhe një pjesë nga regjioni i brigjeve të Adriatikut, e quajtur Myzyeqe, dhe Shqipërinë e Veriut, që përfshin tërë viset e tjera të bregdetit Adriatik, dhe shtrihet drejt Veriut, deri te qytetet që sot janë të përfshira në mbretërinë e Serbisë – Vranja dhe Nishi" (129). (Ka dhe më).

NARODNA IN UNIVERZITETNA KNJIŽNICA

403 668/2007



920075084,3

COBISS 0

